

E drejta për një proces të drejtë

- MANUAL -

Titulli i librit: Manual "E drejta për një proces të drejtë"

Përgatiti për botim: Ledi BIANKU

Arti Grafik: Dritan LLESHI

Print:

International Standard Book Number (ISBN)

Ky botim u përgatit nga Fondacioni Qendra Europiane në kuadër të projektit "Procesi i rregullt ligjor si kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara" në kuadër të projektit ".

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Qendra Europiane dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, dhe Save the Children.

©

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, rrjete ueb apo sisteme të tjerë pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Fondacioni Qendra Europiane

Rr. Vaso Pasha,

P. 20, Ap. 57, 1019

Tiranë, Shqipëri

www.euro-centre.eu



E DREJTA PËR NJË PROCES TË DREJTË

- MANUAL -



Hyrje

E drejta për një proces të drejtë përbën një nga të drejtat themelore të njeriut. Ajo ka qenë ndër të parat të drejta subjektive në favor të individëve. Këtë e dëshmon fakti që elementë të saj i gjejmë të përmendur në dokumente ligjore të antikitetit¹ dhe të mesjetës². Nën ndikimin e filozofisë së *Lumiere* kjo e drejtë filloi të gjente vend parësor në aktet themelore të regjimeve ose të shteteve të reja perëndimore³. E kodifikuar në katalogun ndërkombëtar të të drejtave të njeriut pas Luftës së Dytë Botërore, ajo njihet sot nga pjesa dërrmuese e dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e

¹ *Lex Duodecim Tabularum*, 12 tabelat e famshme legjislative të Romës antike, parashikojnë që në vitin 455 para erës sonë të drejtat procedurale në fazën paraprake të gjykimit (Tabela I), procedurat gjatë gjykimit (Tabela II) duke specifikuar të drejtën e pranisë në gjykim (Tabela II, § 1), parimin e ekzekutimit të vendimeve (Tabela III), parimin e barazisë të qytetarëve romakë (Tabela 9, § 1) dhe ndalimin e korrupsionit të gjyqtarëve (Tabela 9, § 3) apo të drejtën për të mos u dënuar me vdekje përveçse në bazë të një vendimi gjyqësor (Tabela 9, § 6), etj. Shih në https://droitromain.univ-grenoble-alpes.fr/Anglica/twelve_Johnson.html

² Shih Magna Carta, 15.06.1215, seksioni 39 i së cilës parashikonte që: “Asnjë njeri i lirë nuk arrestohet, burgoset, shpronësohet, nxjerrë jashtë ligjit, dëbohet ose ndëshkohet në ndonjë mënyrë tjetër, dhe as nuk procedohet ose ndiqet, përveçse në bazë të një gjykimi të ligjshëm nga të barabartët e tij ose sipas ligjit të vendit ... Ne nuk i shesim askujt, dhe as i mohojmë ose vonojmë, as të drejtën dhe as drejtësinë.”

Në <http://www.britannia.com/history/docs/magna2.html>. Shih gjithashtu McKechnie, William Sharp, “Magna Carta: A Commentary On The Great Charter Of King John”, James Maclehose and Sons 1914, dhe “Magna Carta and the right to trial by Jury”, Thomas J McSweeney, William & Mary Law School publications, 2014.

³ Shih nenet 6 deri 9 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, të miratuar nga Asambleja Kombëtare Franceze më 1789. Shih gjithashtu Amendamentin e 6 të Kushtetutës së Sh.B.A, i cili u miratua më 1791.

njeriut⁴, përfshirë edhe ato specifike⁵. Ajo përbën sot një nga të drejtat pa të cilën vetë logjika e mbrojtjes së të drejtave individuale qoftë në nivel kombëtar qoftë në nivel ndërkombëtar nuk do kishte kuptim dhe nuk do mund të realizohej. Për këtë arsye mund të thuhet se e drejta për një proces të rregullt paraqet dy karakteristika interesante në kuadrin e sistemeve të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Nga njëra anë ajo është një e drejtë subjektive më vete, por nga ana tjetër ajo përbën një instrument procedural themelor për respektimin e të gjitha të drejtave të tjera.

Ky komentari do të analizojë të drejtën për një proces të rregullt apo të drejtë, nën këndvështrimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (tani e tutje KEDNJ ose Konventa). Kjo Konventë e parashikon të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor në nenin 6 të saj. Statusi i tij si një nga nenet më themelore të Konventës del në pah nga vetë fakti se pjesa më e madhe e vendimeve të Gjykatës që kanë konstatuar shkelje të Konventës kanë të bëjnë pikërisht me shkelje të nenit 6 të saj. Duhet theksuar që garancitë e parashikuara nga ky nen janë më të mëdha në lidhje me proceset penale sesa në lidhje me ato civile⁶. Kjo del fare qartë në pah nga fakti se e drejta e përgjithshme për një gjykim të drejtë, e parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 6, për çështjet me karakter penal përforcohet edhe me garanci të posaçme të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni⁷. Jurisprudenca e vazhdueshme e Gjykatës Evropiane ka kontribuar veçanërisht për thellimin dhe pasurimin e të drejtave jo vetëm gjatë gjykimit,

⁴ Shih nenin 18 të Deklaratës Amerikane të të Drejtave dhe të Detyrimeve të Njeriut, të majit 1948, nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të dhjetorit 1948, nenin 6 të Konventës Evropiane të të drejtave të Njeriut, të cilin do e komentojmë në detaje, nenin 14 të Paktit ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike të vitit 1966, neni 8 i Konventës Amerikane të të drejtave të Njeriut, të vitit 1969 dhe nenin 7 të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve.

⁵ Shih për shembull nenet 3, 12 dhe 40 të Konventës së O.K.B.-së mbi të drejtat e Fëmijës, nenin 2 të Konventës së O.K.B.-së mbi Eliminimin e të gjithave Formave të Diskriminimit Racial, të vitit 1979, Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e O.K.B. më 1985, etj.

⁶ Shih më poshtë në Pjesën III që iu dedikohet pikërisht garancive në procesin penal.

⁷ Duhet të theksohet gjithashtu që garanci shtesë përbëjnë edhe dispozitat e Nenet 7 të Konventës si dhe të nenit 2 të Protokollit 7 të saj. Gjithashtu duhet kujtuar edhe neni 13 i Konventës i cili ka të bëjë me të drejtën për një mjet efektiv ankimor.

por edhe gjatë fazave të mëhershme të procedurës penale. Gjykata shpesh kujton se të drejtat e të akuzuarve nuk janë absolute, duke pranuar përjashtime të caktuara, duke përfshirë mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Si rregull, Gjykata merr një qasje dogmatike dhe të papërkulur, duke privilegjuar një shqyrtim rast pas rasti për respektimin e të drejtave të mbrojtjes, duke mbajtur gjithmonë parasysh ekuivalencën e gjykimit në tërësi.

Për më tepër, shumë nga garancitë e përpunuara në kuadrin e nenit 6 të Konventës kanë pasur dhe kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në analizën e aspekteve procedurale edhe të neneve të tjera të Konventës, sidomos të atyre dispozitave që kanë një natyrë shumë më substanciale sesa dispozita e nenit 6⁸. Kjo vjen për shkak se neni 6 i Konventës mishëron parimin e sundimit të ligjit dhe synon të sigurojë funksionimin e duhur të sistemit të administrimit të drejtësisë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij parimi themelor në një shoqëri demokratike, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (tani e tutje GJEDNJ ose Gjykata) ka theksuar që në vitet e hershme të aktivitetit të saj se interpretimi kufizues i nenit 6 nuk do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitës, ose madje as edhe me vetë Konventën⁹. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të drejtë vesh një rëndësi parësore në një shoqëri demokratike¹⁰.

Duhet theksuar gjithashtu që koncepti i “procesit të drejtë” ka të bëjë më së shumti me kuadrin ligjor, me atë institucional dhe me procedurën e funksionimit të sistemit gjyqësor, dhe jo me themelin e çështjeve të shqyrtuara nga gjykatat vendase. Në të vërtetë, Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se ajo nuk përbën një “shkallë e katërt”. Kjo do të thotë se, në parim, Gjykata

⁸ Shih për shembull *Pulfer k. Shqipërisë*, nr. 31959/13, 20.11.2018 dhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë dhe prokurori për mbrojtjen e të drejtave të garantuara nga neni 3 i Konventës. Shih sidomos paragrafët 79 deri 84 në lidhje me parimet e përgjithshme.

⁹ Shih *Delcourt k. Belgjikës*, 17.01.1970, nr. 2689/65, § 25.

¹⁰ Shih vendimet *Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit k. Gjermanisë*, [DH.M.], nr. 42527/98, § 45, GJEDNJ, 2001-8, apo *Andrejeva k. Letonisë*, [DH.M.], nr. 55707/00, § 98, GJEDNJ, 2009.

nuk kontrolojnë gabimet e mundshme të gjykatave kombëtare, vlerësimin e fakteve ose interpretimin e ligjit të brendshëm prej tyre. Gjykata e Strasburgut kontrolojnë vetëm nëse qëndrime të tilla nga autoritetet e brendshme shkelin apo jo garancitë e nenit 6 të KEDNJ duke prekur karakterin e drejtë të gjykimit¹¹. Megjithatë, duke pasur parasysh që ky komentari i kushtohet kryesisht gjyqtarëve të gjykatave shqiptare, duhet theksuar se ata duhet t'i interpretojnë parimet e jurisprudence s së Gjykatës së Strasburgut jo duke u kufizuar në rolin subsidiar të kësaj të fundit. Në zbatimin e jurisprudence s së Strasburgut, gjyqtarët shqiptarë, duke qenë edhe gjyqtarë të themelit, kanë kompetenca më të gjera sesa gjyqtarët e Strasburgut për t'i vënë në zbatim parimet e jurisprudence s së kësaj të fundit. Kjo është sidomos e vërtetë po të analizohet struktura e ndryshme legjislative e dispozitës së nenit 6 të Konventës në raport me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si norma sipërore që garanton këtë të drejtë në sistemin normativ shqiptar. Megjithatë atyre iu takon që ta ndjekin dhe ta zbatojnë në mirëbesim jurisprudence n e Gjykatës së Strasburgut si detyrimi minimal ligjor ndërkombëtar dhe kushtetues¹².

¹¹ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 01.1999 në lidhje me çështjen *Garcia Ruiz k. Spanjës*, nr. 30544/96, § 28, atë të 16 dhjetorit 1997 në lidhje me çështjen *Tejedor Garcia k. Spanjës*, nr. 25420/94, § 31, atë të 3.04.2012, në lidhje me çështjen *Nicoleta Gheorghe k. Rumanisë*, nr. 23470/05, § 34 dhe atë të 4.02.2014, në lidhje me çështjen *Mottola dhe të tjerë k. Italisë*, nr. 29932/07, § 29.

¹² Shih nenin 17 § 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PJESA I

KARAKTERISTIKAT THEMELORE Të nenit 6

I. Struktura

Paragrafi i parë i nenit 6 përcakton fushën e zbatimit të së drejtës për një gjykim të drejtë, duke përmbajtur një seri garancish të zbatimit të përgjithshëm. Thënë ndryshe garancitë në fjalë kanë të bëjnë me të gjitha procedurat që përfshihen në zbatimin e kësaj dispozite. Megjithatë, paragrafët 2 dhe 3 kanë të bëjnë me procedurat penale dhe mbrojtjen e disa të drejtave themelore të të akuzuarve në proceset penale. Struktura e nenit 6 dëshmon rëndësinë e veçantë që hartuesit e Konventës i kanë kushtuar mbrojtjes të të akuzuarve në proceset penale për shkak të pozitës së tyre parimisht më të brishtë. Megjithatë, të drejtat e të akuzuarit në proceset penale përfaqësojnë aspekte të veçanta të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me paragrafin 1 dhe duhet të interpretohet dhe zbatohet në dritën e këtij të fundit¹³, i cili përbën themelet e të gjithë dispozitës, dhe të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Struktura e këtij komentari të shkurtër do të ndjekë gjithashtu këtë linjë strukturore të nenit 6. Pjesa e parë e komentarit do të trajtojë garancitë e përgjithshme të procesit të drejtë, të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 6, kurse pjesa e dytë e komentarit do të fokusohet kryesisht në garancitë më specifike të të akuzuarve në procese penale, garanci që përmbledhen në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 6.

¹³ Shih dy vendime të Dhomës së Madhe, atë të 15 dhjetorit 2011, në lidhje me çështjen *Al-Khawaja dhe Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 26766/05 dhe 22228/06, § 118 dhe atë të 15 dhjetorit 2015, në lidhje me çështjen *Schatschaschwili k. Gjermanisë*, nr. 9154/10, § 100.

II. Mënyrat e interpretimit të nenit 6

A. interpretimi kontekstual, teleologjik dhe sistematik i nocionit procesit të drejtë

Që në vendimin e saj *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*¹⁴, të cilit do i referohemi përsëri në vijim, Gjykata ka sugjeruar se nocioni i gjykimit të drejtë është kompleks, i përbërë nga një tërësi elementesh, dhe se përfundimi nëse ka pasur apo jo respektim të kësaj të drejte kërkon sipas Gjykatës një vlerësim tërësor të procesit. Kjo do të thotë që identifikimi i një problemi ose një mangësi në një nga fazat e procedurës nuk çon automatikisht në konstatim të shkeljes. Gjykata ka mbajtur këtë qëndrim me argumentin se një mangësi në një fazë të procedurës mund të kompensohet në një fazë të mëvonshme të saj¹⁵, ose se ajo ka qenë e një natyre jo mjaft të rëndësishme për të ndikuar në drejtësinë dhe barazinë e procedurave në tërësi¹⁶. Prandaj teknika e interpretimit të Gjykatës në lidhje me nenin 6 ka qenë gjithmonë ajo e analizës tërësore dhe kontekstuale të procedurave, të marra në tërësi, dhe jo e elementëve të veçantë të saj¹⁷. Megjithëse një pjesë e konsiderueshme e doktrinës mendon se Gjykata ka filluar të bëjë gjithnjë e më tepër përjashtime nga kjo përjasje, duke u fokusuar në aspekte të veçanta të procedurës, për mendimin tim kjo është vetëm një shprehje e qëndrimit të përgjithshëm të saj, ku edhe pse mund të fokusohet me vëmendje të veçantë në një mangësi në lidhje me një aspekt të veçantë të procedurës, gjithsesi përfundimin ajo e arrin pasi analizon ndikimin që ka pasur, qoftë edhe një mangësi e vetme, në drejtësinë dhe rregullsinë e të gjithë procedurës¹⁸. Këtë Gjykata e ka konfirmuar së fundmi

¹⁴ Vendim i 21.02.1975, Seria A, nr. 18; 1 European Human Rights Reports 524. Shih edhe në L. Bianku, O.Kumbaro, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", Qendra Evropiane, 2017.

¹⁵ Shih *Monnell dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 55-70, *Dallos k. Hungarisë*, §§ 47-53.

¹⁶ Shih *Verdu Verdu k. Spanjës*, 15.02. 2007, nr. 43432/02, §§ 23-29.

¹⁷ Shih *Ocalan k. Turqisë*, Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", Qendra Evropiane, 2017.

¹⁸ Shih *Salduz k. Turqisë* [D.H.M.], §§56-62; *Imbrioscia k. Zvicrës*, §§39-44? *Panovits k. Qipros*, §§ 66-77; *Dayanan k. Turqisë*, §§ 31-43; *Pishchalnikov k. Russia*, §§ 72-91

me vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*¹⁹. Kjo analizë e drejtësisë dhe rregullsisë së procesit civil ose penal në çdo rast specifik, frymëzohet nga kriteri i interpretimit teleologjik të dispozitës së nenit 6²⁰. Qëllimi i këtij neni është që të garantojë nëse procesi në tërësi ka qenë i drejtë dhe i rregullt dhe jo të gjejë artificialisht nëse aspekte të veçanta kanë shfaqur mangësi. Megjithatë kjo nuk do të thotë se Gjykata nuk mban parasysh ndikimin edhe të një mangësie të vetme, sidomos kur nuk është korrigjuar më vonë, në tërësinë e procedurës për të arritur në përfundimin se kjo e fundit ka qenë e parregullt dhe shkelte nenin 6²¹. Të tilla janë për shembull mangësitë në fazën hetimore të cilat ndikojnë në të gjithë procedurën vijuese²². Nga analiza tërësore e procedurës, duhet pranuar se, për shkak të natyrës së tij, parimi i prezumimit të pafajësisë, i garantuar nga neni 6 § 2, ka përfituar nga një analizë më e pavarur duke çuar në shkelje edhe kur të gjithë elementët e tjerë të një procesi kanë qenë respektuar në përputhje me nenin 6 të marrë në tërësi²³. Me këtë aspekt do merremi specifikisht në vijim.

Gjykata, sidomos vitet e fundit, është përpjekur të identifikojë dhe sistematizojë elementët që luajnë peshë themelore në analizën e barazisë apo jo të një procesi të marrë në tërësinë e tij. Ajo ka ofruar elementë të tillë sidomos për çështjet penale²⁴,

¹⁹ *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DHM], nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08, § 274, 13.09.2016.

²⁰ Shih debatin e zhvilluar mes përfaqësuesve të Qeverisë Britanike nga njëra anë dhe Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Strasburgut nga ana tjetër, në çështjen *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, sidomos duke iu referuar kritereve të interpretimit të një traktati ndërkombëtar sipas Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1961. Shih edhe analizën e detajuar të gjyqtarit Fitzmaurice në vendimin e tij individual në këtë vendim.

²¹ *Ibid.* § 40 *in fine*. Kjo mund të thuhet për shembull për situata që kanë të bëjnë me qasjen në gjykatë ose me mos-ekzekutimin e vendimeve përfundimtare administrative ose gjyqësore.

²² Shih *Salduz k. Turqisë*, §§ 56-62, dhe *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, të përmendura më lart.

²³ Shih *Daktaras*

²⁴ Shih sidomos § 274 të vendimit të lartpërmendur *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, që do të analizohet edhe në vijim në lidhje me marrjen e provave.

por edhe për ato civile²⁵. Gjithsesi këta elementë të përpunuar nga Gjykata nuk janë shterues dhe mund të ndryshojnë edhe në varësi të rrethanave specifike të çështjes.

B. interpretimi i zgjeruar i garancive të nenit 6

Logjika interpretuese e Gjykatës në lidhje me rregullsinë e procesit të marrë si të tërë dhe në përputhje me qëllimin e dispozitës së nenit 6 të Konventës ka sjellë si pasojë edhe kritere të tjera interpretuese me rëndësi në lidhje me këtë nen të Konventës.

Kriteri i parë është ai që ka të bëjë me garantimin praktik dhe efektiv të së drejtës për një proces të rregullt dhe të drejtë. Ky interpretim ka bërë që mbrojtja e nenit 6 të përfshijë edhe etapa të procedurës që në lexim të parë të dispozitës së nenit 6 mendohet se nuk përfitojnë nga kjo mbrojtje. Kështu për shembull mund të përmenden nocioni i qasjes në një gjykatë²⁶, ose ai i ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, administrative ose gjyqësore²⁷. Në këtë mënyrë objekti i mbrojtjes së nenit 6 është zgjeruar, për t'i dhënë kuptim vetë nocionit që ky nen mbron, procesit të drejtë. Siç do ta themi edhe në vijim kur të flasim në mënyrë më specifike mbi qasjen në gjykata dhe mbi ekzekutimin e vendimeve, rregullsia e procesit si e tërë dhe të gjitha kriteret, qoftë institucionale qoftë procedurale, që neni 6 parashikon shprehimisht nuk do të kishin asnjë kuptim nëse individit i mohohet qasja në gjykatë ose vendimi që ka përfituar në përfundim të këtyre procedurave nuk ekzekutohet.

²⁵ Në lidhje me çështjet civile elementë të tillë si, rëndësia e objektit të mosmarrëveshjes për kërkuesin, ndërhyrja e ekzekutivit në procedurat gjyqësore, etj., janë faktorë domethënës për vlerësimin e Gjykatës. Shih më poshtë në lidhje me çështjet *Rafineritë Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, nr. 13427/87, si dhe *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10613/16, 11.01.2018

²⁶ Shih *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur.

²⁷ Shih *sidomos Hornsby k. Greqisë*, nr. 18357/91, §§ 40-45, 19.03.1997

C. interpretimi autonom i nocioneve të nenit 6

Organet e Strasburgut²⁸ dhe në veçanti Gjykata ka vënë në dukje se termat që përcaktojnë fushën e veprimit të nenit 6 janë autonomë dhe duhen interpretuar si të tillë²⁹. Me fjalë të tjera, këto terma duhet të interpretohen në dritën e kushteve të jetesës në shoqëritë e sotme dhe jo vetëm duke iu referuar ligjit të brendshëm të Shtetit palë në procedurat përpara organeve të Konventës. Gjykata vazhdimisht dhe në mënyrë konsistente i interpreton dhe i zbaton dy konceptet themelore të zbatueshmërisë në nenit 6, atë të mosmarrëveshjeve mbi të drejtat dhe detyrimet civile dhe atë të akuzës penale vazhdimisht, në përputhje me kriteret e veta të interpretimit, e sidomos atë të interpretimit autonom të nocioneve. Madje mund të thuhet që neni 6 i Konventës dhe nevoja për një mbrojtje praktike dhe efektive e garancive të parashikuara prej tij, kanë përbërë që në fillimet e zhvillimeve jurisprudenciale dhe vazhdon të përbëjë edhe sot një nga fushat më pjellore në lidhje me kriterin e interpretimit autonom të nocioneve të KEDNJ³⁰. Prandaj sot, në gamën e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut mbi nenin 6 mund të hasen edhe çështje përtej atyre që tradicionalisht konsiderohen civile dhe penale në kuptimin strikt të termit, duke përfshirë kështu edhe disa kategori juridike që formalisht bien brenda sferës të së drejtës publike. Me këtë kriter interpretimi do merremi në vijim specifikisht, si në lidhje me aspektet civile³¹ ashtu edhe me ato penale³².

²⁸ Kur bëhet referencë tek ‘organet e Strasburgut’ ose organet e Konventës, bëhet fjalë për strukturën që ekzistonte që nga hyrja në fuqi e Konventës, 3 shtator 1953 e që përfshinte Komisionin Europian për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e deri me hyrjen në fuqi të Protokollit 11, më 1 nëntor 1998, ku Komisioni u shpërbë dhe ngeli në fuqi vetëm Gjykata.

²⁹ Shih vendimin e Gjykatës të 8.06.1976, në lidhje me çështjen *Engel dhe të tjerët k. Holandës*, nr. 5100/71, 5101/71, 5102/71, 5354/72 dhe 5370/72, § 81, vendimin e 28.06.1978, në lidhje me çështjen *König k. R.F.Gj.*, nr. 6232/73, § 88, vendimin e 29.05.1997, *Georgiadis k. Greqisë*, nr. 21522/93, § 34, vendimin e Dhomës së Madhe të 12.07.2001, në lidhje me çështjen *Ferrazzini k. Italisë*, nr. 44759/98, §§ 24 dhe 30, vendimin e 18.05.2010, në lidhje me çështjen *Czekierl k. Polonisë*, nr. 25168/05, § 31. Shih gjithashtu në doktrinën F. Sudre, Përdorimi i nocioneve autonome në F. Sudre, Interpretimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njeriut, 1998, Nemessis & Bruylant, fq. 93 s.

³⁰ Shih Engel dhe të tjerët, Aksoy, Baka, Eskelinen, *Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 34-40

³¹ Shih më poshtë: A. “Mbi mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile”.

³² Shih më poshtë: B “Mbi akuzat penale”.

III. Fusha e zbatimit

Pas këtyre sqarimeve të shkurtra në lidhje me strukturën dhe mënyrën e interpretimit të nenit 6 të Konventës, problemi vijues që duhet të jetë i qartë që në fillim është ai i fushës së tij të veprimit. Pra problemi është nëse neni 6 i Konventës gjen apo jo zbatim në çështje ku ky dyshim ngrihet. Kjo varet.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu si neni 14 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, nuk zbatohet në të gjitha procedurat gjyqësore, por vetëm në lidhje me ato që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet civile ose që bazohen në një akuzë penale kundër një personi. Nga kjo pikëpamje neni 6 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut ndryshon nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili, pavarësisht se nuk mund të konsiderohet si dispozitë autonome pasi i referohet të drejtave të garantuara në Kushtetutë, ka fushë veprimi më të madhe sesa neni 6 i KEDNJ përderisa iu referohet të gjitha të drejtave të garantuara nga Kushtetuta dhe jo vetëm atyre civile dhe penale³³. Sidoqoftë Gjykata e ka interpretuar të drejtën për një proces të rregullt në një kuptim të gjerë³⁴. Ky lloj interpretimi i dispozitës së nenit 6 të KEDNJ ka mbyllur një pjesë të rëndësishme të hendekut të krijuar nga kjo teknikë legislative e akteve të lartpërmendura. Për më tepër, analiza e gjerë juridike e masave mbrojtëse në kuadrin e paragrafit 1 e ka përforcuar në mënyrë të veçantë fushëveprimin e

³³ Neni 42 i Kushtetutës parashikon:

³¹ *Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*

² *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*
Mjafton të theksohet për shembull që ndërsa parimit i procesit të rregullt gjen zbatim sipas nenit 42 të Kushtetutës edhe në raport me çështjet e dëbimit ose të azilit sipas neneve 39 dhe 40 të Kushtetutës, neni 6 i GJEDNJ, nuk gjen zbatim në lidhje me çështje të tilla.

³⁴ Në vendimin e saj të vitit 1988 në lidhje me çështjen *Barbera, Messegue dhe Jabardo k. Spanjës*, Seria A, nr. 146 Shih shih në 11 European Human Rights Reports 360) Gjykata identifikoi një numër karakteristikash të gjykimit të çështjes së kërkuesve të cilat, të marra së bashku, përbënin një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë.

garancive të njohura nga neni 6 dhe për pasojë edhe mbrojtjen që ato ofrojnë. Duhet thënë që si pasojë e jurisprudencës së Gjykatës përjashtimet e veprimit të nenit 6 të Konventës kanë ardhur duke u kufizuar në vazhdimësi. Në vijim po sqarojmë disa nga elementët themelorë të analizës që duhet bërë për të arritur në përfundimin nëse neni 6 gjen apo jo zbatim në një situatë të caktuar.

A. Mbi mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile

Në vendimin e saj *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerë kundër Rumanisë*³⁵, Dhoma e Madhe e Gjykatës rikujtoi edhe një herë kriteret për zbatueshmërinë e paragrafit 1 të nenit 6 në fushën civile. Ajo theksoi se për këtë qëllim duhet të ketë një “mosmarrëveshje” në lidhje me një të drejtë e cila mund të pretendohet, të paktën në mënyrë të arsyeshme, se njihet nga e drejta e brendshme, pavarësisht nëse kjo e drejtë njihet apo jo nga Konventa. Gjykata kujton se kjo mosmarrëveshje duhet të jetë reale dhe serioze dhe mund të ketë të bëjë jo vetëm me ekzistencën apo jo të një të drejte por edhe me qëllimin dhe mënyrën e ekzekutimit të saj, dhe se rezultati i procedurave gjyqësore në lidhje me këtë mosmarrëveshje duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë.

a. ekzistenca e një mosmarrëveshjeje

Me qëllim që të gjejë zbatim neni 6 kushti i parë lidhet me ekzistencën e një mosmarrëveshjeje midis individëve ose ndërmjet kërkuesit dhe shtetit. Mosmarrëveshja mund të ketë të bëjë qoftë me faktet qoftë me interpretimin e ligjit³⁶. Në këtë këndvështrim të fundit mund të lidhet ose me ekzistencën e së drejtës në fjalë, qoftë në fushëveprimin

³⁵ Vendim i Dhomës së Madhe të 29 nëntorit 2016, nr. 76943/11, § 71. Shih gjithashtu *Micallef k. Maltës* [DH.M.], nr. 17056/06, § 74, GJEDNJ, 2009; dhe *Boulois k. Luksemburgut* [DH.M.], nr. 37575/04, § 90, GJEDNJ, 2012, dhe *Bochan k. Ukrainës (nr. 2)* [DH.M.], nr. 22251/08, § 42, GJEDNJ, 2015.

³⁶ Shih vendimin e Gjykatës të 10.02.1983, në lidhje me çështjen *Albert Le Compte dhe të tjerë k. Belgjikës*, nr. 7299/75 dhe 7496/76, § 27 dhe atë të 26.06.1986, *Van Marle dhe të tjerë k. Holandës*, nr. 8543/79, 8674/79, 8675/79 dhe 8685/79, § 32.

e saj apo në mënyrat e realizimit të saj³⁷. Mosmarrëveshja duhet të jetë e vërtetë dhe serioze³⁸. Rastet që ngrenë pyetje ose çështje thjesht hipotetike janë, në parim, të përjashtuara nga fushëveprimi i nenit 6, siç janë rastet që kanë të bëjnë me efektet e një projekt ligji të pamiratur ose me një premtim elektoral ose edhe normativ³⁹. Përveç kësaj, duhet të kërkesi të ketë një interes të drejtpërdrejtë ligjor në raport me mosmarrëveshjen dhe zgjidhjen e saj, në mënyrë që mosmarrëveshja të konsiderohet se ka karakter real dhe serioz që të mund të bjerë në fushën e zbatimit të nenit 6.⁴⁰ Gjithashtu duhet të mosmarrëveshja të ketë karakter juridik dhe ti nënshtrohet zgjidhjes juridiksionale, pra që ajo të mund të zgjidhet nga gjykatat në bazë të së dispozitave ligjore përkatëse.⁴¹

Gjithashtu, duhet theksuar se që në çështjen *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*⁴², Gjykata vendosi se, në mënyrë që neni 6 të gjejë zbatim, duhet që procedurat përkatëse të jenë “në mënyrë të drejtpërdrejtë përcaktuese” në lidhje me pretendimet në kuadrin e mosmarrëveshjes në fjalë. Kjo do të thotë se vendimi përkatës i autoritetit shtetëror duhet të jetë drejtpërsëdrejti vendimtar dhe përcaktues për të drejtat dhe detyrimet e kërkuarit⁴³. Në këtë kuadër

³⁷ *Shih Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, nr. s 6878/75 dhe 7238/75, i lartpërmendur, § 49 GJEDNJ, 23.06.1981, *Regner k. Republikës Çeke*, [DH.M.] nr. 35289/11, § 99, GJEDNJ, 19.09.2017. Shih në mënyrë të veçantë një mori vendimesh kundër Shqipërisë, duke filluar nga *Qufaj Sh.p.k*, 4.11.2004, që lidhen me mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të brendshme që kanë haptazi karakter civil.

³⁸ *Shih Benthem k. Hollandës*, nr. 8848/80, § 32., GJEDNJ, 23.10.1985, *Shapovatov k. Ukrainës*, nr. 45835/05, § 42, GJEDNJ, 31.07.2012, *Kravchenko k. Rusisë*, nr. 34615/02, § 39, GJEDNJ, 2.04.2009.

³⁹ Shih vendimin mbi papranueshmërinë në çështjen *Ali Telhai k. Shqipërisë*, nr. 58915/08, 17.07.2009, ku kërkesi ngrinte pretendimin për kthimin ose kompensimin e pasurisë së luajshme të marrë nga regjimi komunist. Gjykata konstatoi në atë kohë se sipas nenit 5 të ligjit nr. 9235 të 29.07.2004, për kthimin dhe kompensimin e Pronave, parashikohet se kthimi dhe kompensimi i pasurive të luajshme do të rregullohet me ligj të veçantë. Përderisa deri në atë kohë nuk ishte miratuar një ligj i tillë, kërkesa e Z. Telhai u deklarua e papranueshme, në kuadër të nenit 1 të Protokollit 1. E njëjta përgjigje do ishte e vlefshme edhe për një ankesë eventuale në bazë të nenit 6 të Konventës.

⁴⁰ *Shih Kienast k. Austrisë*, 23.01.2003, nr. 23379194, § 33 e vijues.

⁴¹ *Shih Van Marle dhe të tjerët k. Holandës*, § 36 vendimi mbi pranueshmërinë GJEDNJ, 26.06.1986, *Le Bihan k. Francës*, nr. 63054/00, GJEDNJ, 1.06.2004, *Nowicky k. Austrisë*, nr. 34983102, § 34, GJEDNJ, 24.02.2005

⁴² Vendim i Gjykatës i vitit 1981, seria A, nr. 43, § 49.

⁴³ *Shih Van de Hurk k. Holandës*, nr. 16034/90, § 45, [1994], GJEDNJ, 14, 19.04.1994. Shih gjithashtu *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DH.M.], nr. 27644/95, § 46 e vijues, 6.04.2000.

vlen të theksohet se Gjykatës i është dashur të trajtojë në Dhomë të Madhe një nga aspektet e këtij problemi, pikërisht atë në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 ndaj procedurave që kanë të bëjnë me masat e ndërmjetme. Ndërkohë që në mënyrë konstante deri në vitin 2009 ajo kishte mbajtur qëndrimin se procedurat që lidheshin me vendimet e ndërmjetme nuk konsideroheshin vendimtare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile, me vendimin *Micallef kundër Maltës*⁴⁴, Gjykata mori parasysh kohëzgjatjen e procedurës kryesore por edhe vetë natyrën e mosmarrëveshjes, për të arritur në përfundimin se procedurat dhe vendimet e ndërmjetme mund të kenë karakter vendimtar dhe përcaktues në lidhje me të drejtat dhe detyrimet në fjalë. Rrjedhimisht, procedura në lidhje me masat e ndërmjetme nuk mund të përjashtohen automatikisht nga zbatimi i nenit 6⁴⁵. I njëjti debat është zhvilluar për shembull edhe në lidhje me kërkesat për rihapjen e një procesi ose për rishikimin e një vendimi gjyqësor të bërë ndërkaq përfundimtar. Pavarësisht se procedura të tilla konsiderohet se nuk bien në fushën e veprimit të nenit 6⁴⁶, Gjykata ka pranuar se veçoritë e procedurave në fjalë, sidomos natyra dhe shtrirja e tyre mund të justifikojnë zbatimin e nenit 6 edhe në lidhje me to, sidomos nëse del qartë sipas së drejtës së brendshme që një kërkesë për rihapjen e procedurës përbën një mjet efektiv, ose nëse anulimi i vendimit përfundimtar përbën mënyrën e vetme që një Shtet të ndreqë situatën në kontekstin e sistemit të tij ligjor dhe procedura e rihapjes ose e rishikimit paraqesin karakter vendimtar për të drejtat dhe detyrimet civile të kërkuarit.⁴⁷

⁴⁴ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 15 nëntorit 2009, në lidhje me çështjen *Micallef k. Maltës*, nr. 17056/06, § 79 e vijues.

⁴⁵ Ky ka qenë argumenti themelor i Gjykatës në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 edhe në çështjen *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, në vendimin e 11.01.2018. Gjykata vlerësoi se nuk kishte dyshim që vendimi i ndërmjetëm i Gjykatës Administrative të Vlorës i 7 nëntorit 2013 kishte karakter përcaktues dhe vendimtar për të gjithë procedurën në lidhje me ligjshmërinë ose jo të ndërtimit që në Shqipëri njihet me emrin Kompleksi Jon. Prishja e godinës në mosrespektim të vendimit të ndërmjetëm e bënte të pakuptimtë çdo procedurë gjyqësore me objekt gëzimin e të drejtës së pronësisë së banorëve.

⁴⁶ Shih sidomos *Jussy k. Francës*, nr. 42277/98, § 18, GJEDNJ, 8.04.2003, *Korda k. Sllovenisë*, nr. 25195/02, § 36-37, GJEDNJ, 30.11.2006.

⁴⁷ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 5.02.2015, në lidhje me çështjen *Bochan (nr. 2) k. Ukrainës*, nr. 22251/08, § 50, vendimin e 30 nëntorit 2000, në lidhje me çështjen *Nikula k. Finlandës*, nr. 31611/96, vendimin e 22.07.2010, në lidhje me çështjen *Melis k. Greqisë*, nr.

b. Nocioni i të drejtave dhe detyrimeve

Mosmarrëveshjet e përshkruara më lart mes subjekteve të së drejtës duhet të kenë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile të cilat mund të pretendohet se ekzistojnë në bazë të së drejtës së brendshme. Pra duhet që të drejtat dhe detyrimet e karakterit civil të cilave iu referohet neni 6, të jenë “të rregulluara” nga e drejta e brendshme. Kjo sepse ky nen iu referohet të drejtave dhe detyrimeve që janë të njohura, të paktën në mënyrë të argumentueshme, nga e drejta e brendshme⁴⁸. Neni 6 nuk garanton ndonjë kuptim të veçantë në lidhje me përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve civile në bazë të së drejtës së brendshme të Shteteve Palë⁴⁹. Në këtë kuadër është e rëndësishme të theksohet se neni 6 nuk ka për qëllim të kontrollojë përmbajtjen e ligjit kombëtar, por përbën një garanci procedurale në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga rendi i brendshëm ligjor. Në vendimin e dhënë në lidhje me çështjen *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata e sqaroi këtë qëndrim të sajën duke u shprehur se:

“Fakti nëse një person ka një pretendim mbi bazën e të cilit mund të bëjë një padi përpara një gjykate mund të varet jo vetëm nga përmbajtja e themelit ... të së drejtës civile siç përcaktohet në bazë të së drejtës së brendshme por gjithashtu edhe në bazë të ekzistencës së hapësirave procedurale⁵⁰ që lejojnë ose pengojnë mundësitë e paraqitjes së pretendimeve në gjykata.”

Megjithatë duhet pasur parasysh se karakterizimi i ligjit që rregullon të drejtën ose detyrimin që gjendet në themel të mosmarrëveshjes pra, si civile, tregtare, administrative, etj., si dhe

30604/07, § 19 dhe 20 dhe vendimin mbi pranueshmërinë të 9 nëntorit 2013, në lidhje me çështjen *Nistler k. Austrri*, nr. 24912/08, § 24.

⁴⁸ *Shih sidomos Roche k. Mbretërisë së Bashkuar*, [D.H.M.], §§116-126, 19.05.2005, por edhe *Bentham k. Hollandës*, §§32-36, 20.10.1985,) H. k. Belgjikës, nr. 8950/80, § 40, 30.11.1987.

⁴⁹ *Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 30 nëntorit 1987 në lidhje me çështjen H k. Belgjikës*, Seria A, nr. 127 - B; shih në 10 European Human Rights Reports 339, si dhe vendimin e saj të 27.08.1997 në lidhje me çështjen *Anne-Marie Andersson k. Suedisë*.

⁵⁰ Qëndrimi i Gjykatës në lidhje me hapësirat procedurale do të sqarohet në vijim, në seksionin mbi mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.

autoriteti kompetent për ta zgjidhur mosmarrëveshjen përkatëse nuk janë përcaktuese për përgjigjen nëse neni 6 gjen zbatim apo jo. Gjithashtu zbatueshmëria e nenit 6, nuk varet nga mungesa e sanksioneve ose nga toleranca e treguar në mënyrë të veçantë ose të vazhdueshme nga autoritetet shtetërore⁵¹. Mund të jetë me vlerë të theksohet se me ligj të brendshëm mund të kuptohet gjithashtu, për shkak të karakteristikave të saj të veçanta, edhe e drejta e Bashkimit Evropian kur është bërë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor⁵².

c. karakteri civil i të drejtave dhe detyrimeve

Siç e thamë edhe më lart, Konventa nuk garanton të drejtën për një gjykim të drejtë në lidhje me të gjitha llojet e të drejtave dhe të detyrimeve që mund të ekzistojnë në sistemin ligjor të secilit prej vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Megjithatë, në mënyrë që Konventa, me anë të nenit 6 § 1 të arrijë t'i mbrojë këto të drejta dhe detyrime, duhet që këto të fundit të jenë të një karakteri "civil". Kjo ndarje mes të drejtave dhe detyrimeve me karakter civil dhe të atyre me karakter publik është bërë qëllimisht në momentet e hartimit të Konventës, dhe kjo sidomos me insistimin e përfaqësuesve francezë në grupin hartues, pasi një ndarje e tillë në sistemin juridik francez është e skalitur tradicionalisht qartë. Punimet përgatitore të Konventës dhe jurisprudenca e hershme e Gjykatës⁵³ e dëshmojnë qartë këtë gjë.

Megjithatë Gjykatës i është dashur që ta trajtojë në një sërë çështjesh që ka marrë në shqyrtim problemin se çfarë është dhe çfarë nuk është një e drejtë ose detyrim me karakter civil. Problemi është që nuk është e mundur të ofrohen rregulla të prera dhe të qarta në

⁵¹ Shih vendimi mbi pranueshmërinë të 17.09.2013, në lidhje me çështjen *De Bruin k. Holandës*, nr. 9765/09.

⁵² Shih vendimin mbi pranueshmërinë të 11.01.1995, në lidhje me çështjen *Papoutakos k. Greqisë*, nr. 24960/94.

⁵³ Shih për shembull vendimin e 16.07.1971, në lidhje me çështjen *Ringelsen k. Austrisë*, nr. 2614/65, § 94, vendimin e 28.06.1978, në lidhje me çështjen *Konig k. R.F.G.J.*, nr. 6232173, § 95, *Pellegrin k. Francës*.

lidhje me këtë çështje, përderisa vetë Gjykata nuk ka mbajtur ende një qëndrim të qartë dhe të qëndrueshëm në lidhje me kufirin ndarës mes atyre që janë dhe atyre që nuk janë të drejta dhe detyrime me karakter civil dhe ky nocion mund të thuhet se është në një evolucion të vazhdueshëm. Çka është më e rëndësishme, është përpjekja e mëposhtme për të ofruar disa çelësa analitikë për identifikimin e situatave ku mosmarrëveshja mund të konsiderohet se ka të bëjë me të drejta ose detyrime “civile” për qëllimet e zbatimit të nenit 6. Në fund të kësaj analize ju ofrohet një listë treguese dhe jo shteruese që bën një ndarje të tillë në bazë të jurisprudence së deritanishme të Gjykatës duke u përpjekur të evidencojmë edhe disa nga kriteret përcaktuese në zbatueshmërinë ose jo të nenit 6. Megjithatë duhet theksuar edhe një herë që këta çelësa analitikë dhe kjo listë treguese ka vetëm një vlerë të kufizuar për juristët dhe gjyqtarët shqiptarë kur zbatojnë parimet e një procesi të rregullt në procedurat e brendshme. Kjo për shkak se, siç e thamë më lart, struktura normative e nenit 42 të Kushtetutës është e ndryshme nga ajo e nenit 6 të Konventës. Kështu që përpara gjykatave shqiptare parimet që rrjedhin nga jurisprudenca e nenit 6 mund të zbatohen më gjerë, edhe në lidhje me çështje që nuk kanë të bëjnë me të drejta dhe detyrime me karakter civil apo me akuza penale. Gjithsesi zbatueshmëria e nenit 6 duhet mbajtur mirë parasysh në rastin e një ankese në Strasburg.

Nga jurisprudenca e Gjykatës duket se një nga kriteret që vesh rëndësi themelore në përcaktimin se një mosmarrëveshje ka karakter civil apo jo është ai që lidhet me natyrën ekonomike të mosmarrëveshjes. Madje, Gjykata ka thënë se ky kriter mund të jetë vendimtar për cilësimin ligjor të të drejtave dhe detyrimeve në fjalë dhe ajo pranon që aty ku ky kriter ekziston atëherë mosmarrëveshja, në parim, bie në fushën e veprimt të nenit 6 të Konventës⁵⁴. Kjo është edhe arsyeja përse ajo ka pohuar për shembull se të drejtat dhe detyrimet e “personave privatë” në marrëdhëniet ndërmjet tyre në bazë të

⁵⁴ Shih vendimin e 26.03.1992 në lidhje me çështjen *Editions Periscope k. Francës*, nr. 11760/85, § 40, vendimin e 8 dhjetorit 1994, në lidhje me çështjen *Rafineritë Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, nr. 13427/87, § 40, dhe atë të 12 nëntorit 2013, në lidhje me çështjen *Galina Kostova k. Bullgarisë*, nr. 36181/05, § 53.

së drejtës së punës, të pronësisë⁵⁵ dhe të së drejtës tregtare⁵⁶ janë gjithmonë të një karakteri “civil”. Kështu, për shembull, ajo është shprehur se neni 6 gjen zbatim në lidhje me parimet e përgjithshme të së drejtës civile dhe të së drejtës së detyrimeve⁵⁷, përfshirë të drejtat reale⁵⁸, në lidhje me të drejtën tregtare⁵⁹ në lidhje me elementë të së drejtës familjare⁶⁰, përfshirë të drejtën e trashëgimisë⁶¹, etj.

Elementi ekonomik luan një rol thuajse vendimtar edhe kur palët në mosmarrëveshje janë individit dhe shteti. Kështu për shembull është e qartë se neni 6 është i zbatueshëm kur ngrihen probleme në lidhje me të drejtën e pronësisë e cila ka *par excellence* karakter ekonomik. Prandaj, veprimi i autoriteteve shtetërore, i cili është vendimtar për të drejta reale ose forma të tjera të të drejtave pronësore, nuk ka sesi të mos përfshihet në nocionin e të drejtave dhe detyrimeve me karakter “civil” sipas nenit 6⁶². Kjo është veçanërisht e vërtetë për shpronësimet, për proceset e kthimit dhe të kompensimit të pronës⁶³, dhe në përgjithësi për format e ndryshme të privimit nga gëzimi i pronësisë ose të rregullimit të përdorimit të pronës në lidhje me të cilat Gjykata ka thënë se zbatueshmëria e aspektit civil të nenit 6 është e vetëkuptueshme.⁶⁴

⁵⁵ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të vitit 1983 në lidhje me çështjen *Pretto k. Italisë*, (Seria A, nr. 71) çështje që kishte të bënte me shitje trualli. Shih në 6 European Human Rights Reports, 182.

⁵⁶ Shih vendimin e Gjykatës të 19.02.1998 në lidhje me çështjen *Edificaciones March Gallego S. A. k. Spanjës*. Shih në European Human Rights Law Review [1998] fq. 266.

⁵⁷ Shih vendimin e 29.01.2013, në lidhje me çështjen *Zolotas k. Greqisë* [nr. 2], nr. 66610/09.

⁵⁸ Shih vendimin e 8 dhjetorit 1983, *Pretto* dhe të tjerët k. Italisë, nr. 7984/77.

⁵⁹ Shih vendimin e 25.03.1985, *Barthold k. R.F.GJ.*, nr. 8734/79.

⁶⁰ Shih vendimin e 8.02.2004, *Kosmopoulou k. Greqisë*, nr. 60457/00.

⁶¹ Shih vendimin e 3.05.2011, *Negrepontis-Giannisis k. Greqisë*, nr 56759/08.

⁶² Shih për shembull vendimin e 24 nëntorit 2005, në lidhje me çështjen *Capital Bank AD k. Bullgarisë*, nr. 49429/99, § 86, dhe vendimin e 11 dhjetorit 2003, në lidhje me çështjen *Bassani k. Italisë*, nr. 47778/99, §§ 13 dhe 14, që ka të bëjë me falimentimin. Shih vendimin e 26.02.1998, në lidhje me çështjen *Pafitis* dhe të tjerët k. Greqisë, nr. 1631199617821983, § 87, që ka të bëjë me të drejtat e aksionerëve.

⁶³ Shih *Sâmbata Bihor Greek Catholic Parish k. Romania* (nr. 48107/99, § 65, 12.01.2010, *Sfântul Vasile Polonă Greek Catholic Parish k. Romania* (nr. 65965/01, §§ 67 dhe 76, 7.04.2009, *Bogdan Voăă Greek Catholic Parish k. Romania* (nr. 26270/04, § 41, 19 November 2013, dhe *Siseşti Greek Catholic Parish k. Romania* (nr. 32419/04, § 27, 3 November 2015).

⁶⁴ Kjo ishte krejt e qartë për shembull edhe në çështjen *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë* ku megjithëse procedurat e brendshme konsideroheshin si administrative, zbatueshmëria e nenit 6 nuk u vu aspak në dyshim. Shih paragrafët 70-80 të vendimit. Shih gjithashtu për një jurisprudencë të hershme në këtë pikë vendimin e 29.03.2006 në lidhje me çështjen *Scordino k. Italisë* (Nr. 1), [DH.M.] nr. 36813/97, § 126 dh e vijues, *Papachelas k. Greqisë*, nr. 31423/96, § 32 e vijues.

Kriteri ekonomik luan një rol përcaktues në zbatimin e garancive të së drejtës, një gjykimi të drejtë edhe në rastet që lidhen me ushtrimin e aktiviteteve tregtare⁶⁵ ose ekonomike⁶⁶ ose të aktiviteteve të tjera profesionale,⁶⁷ duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me dhënien e një licence për ushtrimin e një aktiviteti tregtar ose profesional.⁶⁸ Kështu për shembull Gjykata është shprehur se neni 6 § 1 nën aspektin civil gjen zbatim në lidhje me të drejtën për të marrë një leje ndërtimi⁶⁹, në lidhje me pronësinë e një patente⁷⁰, të drejtën për të përfutuar nga shërbimet për të cilat paguan taksa⁷¹, ose të drejtën për përfitimin nga sigurimet shoqërore⁷².

Në lidhje me këtë aspekt të fundit, sigurimet shoqërore, në çështjen *Feldbrugge kundër Holandës*⁷³ Gjykata vendosi që përfitimet në rast sëmundje në bazë të sistemit holandez të sigurimeve shoqërore përbënin një të drejtë me karakter civil. Ajo mbajti qëndrimin që karakteristikat e së drejtës private në këtë rast i kalonin së tepërmi ato të së drejtës publike. Gjykata gjatë analizës së saj nxori në pah karakteristika të tilla të së drejtës private si kontrata e punësimit

⁶⁵ Shih ndërmjet të tjerash vendimin e 28.05.2002, në lidhje me çështjen *Kingsley k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35605/97, § 32.

⁶⁶ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1987 në lidhje me çështjen *Pudas k. Suedisë*, Seria A, nr. 125; shih në 10 European Human Rights Reports 380.

⁶⁷ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1987 në lidhje me çështjen *H. k. Belgjikës*, Seria A, nr. 127; shih në 10 European Human Rights Reports 339 dhe sidomos vendimin e 1.03.1997, në lidhje me çështjen *Hornsby k. Greqisë*, i lartpërmendur, § 39 e vijues.

⁶⁸ Shih *Benthem k. Hollandës*, nr. 8848/80, 34 dhe 36, GJEDNJ, 23.10.1985, *Allan Jacobsson k. Suedisë* [nr 1], nr. 8/1997/792/1993, § 72 dhe 73, GJEDNJ, 25.10.1989, *Kraska k. Zvicrës*, nr. 13942/88, § 25 e vijues, GJEDNJ, 19.04.1993, *De Moor k. Belgjikës*, nr. 16997/90, § 42 e vijues, GJEDNJ, 23.06.1994, *Nowicky k. Austrisë*, nr. 34983/02, § 37 e vijues, GJEDNJ, 24.02.2005, mosrinovimi ose revokimi i një leje të tillë për një klinikë. Shih, GJEDNJ, 28.06.1978, *Konig k. R.F.G.*, nr. 6232/73, i lartpërmendur, § 86 e vijues.

⁶⁹ Shih vendimin e Gjykatës të 22 nëntorit 1995 në lidhje me çështjen *Bryan k. Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, Nr. 335 - A; shih në 21 European Human Rights Reports 342.

⁷⁰ Megjithatë duhet theksuar se Gjykata bëri dallimin me moszbatimin e nenit 6 aspekti civil në lidhje me formalitetet për të marrë një patentë. Shih vendimin e Gjykatës të 20 nëntorit 1995 në lidhje me çështjen *British American Tobacco k. Hollandës*, Seria A, nr. 331; 21 European Human Rights Reports 409. Megjithatë shih qëndrimin e Gjykatës në çështjen *X. K. Austrisë*, të cituar më poshtë.

⁷¹ Shih vendimin e Gjykatës të 23.10.1997 në lidhje me çështjen *National & Provincial Building Society dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*; shih në 25 European Human Rights Reports 127.

⁷² Shih vendimin e Gjykatës të 24.06.1993 në lidhje me çështjen *Schuler-Zraggen k. Zvicrës*, Seria A, nr. 263; shih në 6 European Human Rights Reports 405.

⁷³ Vendim i Gjykatës i 8.07.1986, Seria A, nr. 102; shih në 8 European Human Rights Reports 329. Shih sidomos paragrafin 36 e vijues.

dhe ngjashmëria e saj me marrëdhënien e sigurimit shoqëror në bazë të së drejtës së zbatueshme, si dhe faktin që kërkuesja merret pjesë në financimin e sistemit të sigurimeve shoqërore me anë të reduktimit nga pagesa e saj pikërisht për këtë qëllim. Në disa raste të mëpasshme, Gjykata ka vendosur që rregulli i përgjithshëm është që neni 6 gjen zbatim në fushën e sigurimeve shoqërore si dhe në atë të sigurimeve dhe ndihmës shëndetësore⁷⁴. Në të gjitha këto raste duket se kriteri ekonomik dhe natyra kontraktuale dhe kontributive e marrëdhënies ndikon në zbatueshmërinë e nenit 6 të Konventës, duke bërë që ky nen të gjejë zbatim në çështje që veshin një natyrë të theksuar të mbrojtjes sociale⁷⁵.

Një kriter tjetër që mund të haset në jurisprudencën e Gjykatës është ai që ka të bëjë me ndikimin e procedurave në të drejtat që lidhen me të drejtën për një jetë private të individëve⁷⁶. Në lidhje me këtë kriter mund të thuhet se jurisprudenca ka shënuar një evolucion domethënës. Kështu për shembull Gjykata është shprehur se neni 6, në aspektin civil gjen zbatim në lidhje me lirinë e tubimit⁷⁷ të drejtën për liri⁷⁸, të drejtën e jetës dhe të shëndetit⁷⁹,

⁷⁴ Shih vendimet e Gjykatës, të parin të 24.06.1993 në lidhje me çështjen *Schuler-Zraggen k. Zvicrës*, Seria A, nr. 263 dhe në vijim atë të 26.02.1993 në lidhje me çështjen *Salesi k. Italisë*, Seria A, nr. 257 - E.

⁷⁵ Shih gjithashtu vendimet, GJEDNJ, 29.05.1986, *Deumeland k. FRG*, nr. 9384/81, jo. § 70 e vijues-V 6gal., GJEDNJ, 24.06.1993, 16.09.1996, *Sussmann k. Gjermanisë*, nr. 20024/92, § 42, e drejta për t'u dhënë në natyrë, të tilla si akomodimi për familje të pastreha Shih, GJEDNJ, 20.10.2015, *Fazia Ali k. Mbretëria e Bashkuar*, nr. 40378/10, § 58 e vijues, ose me atë të mbledhjes Shih, GJEDNJ, 14.11.2006, *Tsfayo k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 60860/00, § a0 e vijues.

⁷⁶ Kështu për shembull në vendimin e 20.11.2012, në lidhje me çështjen *Alexandre k. Portugalisë*, nr. 33197/09, Gjykata e ka pranuar shprehimisht zbatimin e nenit 6 § 1 në raste kur të drejtat e pretenduara, megjithëse nuk janë të një karakteri tradicionalisht civil, kanë ndikim "të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm" ndaj një të drejte të karakterit të jetës private të kërkuesit. Shih sidomos § 51 të këtij vendimi. Shih gjithashtu vendimet *Mennitto k. Italisë* [DH.M.], nr. 33804/96, § 23, GJEDNJ, 2000-X; *Micallef k. Maltës* [DH.M.], nr. 17056/06, § 74, GJEDNJ, 2009; dhe *al contrario Boulois k. Luxembourg* [DH.M.], nr. 37575/04, § 90, GJEDNJ, 2012, ku Gjykata e ka parë të nevojshme të thellohet mbi këtë problem.

⁷⁷ Shih vendimin e 5.10.2000, në lidhje me çështjen *APEH Uldozotteinek Szovetsège dhe të tjerë k. Hungarisë*, nr. 32367/96, § 34.

⁷⁸ Shih vendimin e 7.01.2003, në lidhje me çështjen *Laidin k. Francës* [nr. 2], nr. 39282/98, § 76

⁷⁹ Shih vendimin e 12.06.2005, në lidhje me çështjen *Okayay dhe të tjerët k. Turqisë*, nr. 36220/97, § 64.

lirinë e shprehjes⁸⁰, etj. Gjykata është shprehur se mbrojtja e nenit 6 shtrihet edhe mbi vendime në lidhje me fëmijët, si për shembull ato që kanë të bëjnë me atësinë, kujdestarinë dhe kontaktet me ta⁸¹.

Ajo është shprehur gjithashtu që aspekti civil i nenit 6 gjen zbatim edhe në kontekstin e sistemit të burgjeve, kur kufizime të caktuara në të drejtat e të burgosurve mund të kenë ndikime mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre me karakter civil. Ky ka qenë një debat që ka gjetur vend në jurisprudencën e Gjykatës që në çështjen e njohur *Golder kundër Britanisë së Madhe*⁸² ku Gjykata nuk e vuri në dyshim zbatimin e nenit 6 në një situatë ku një të burgosuri nuk i lejohej të komunikonte lirshëm me avokatin e tij për qëllimet e bërjes së një ankimi ndaj autoriteteve të burgut.⁸³ Në këtë çështje Gjykata gjeti se aspekti civil i nenit 6 gjen zbatim edhe në kushtet e burgut në lidhje me të drejtën individuale për një reputacion të mirë. Po ashtu neni 6 gjen zbatim edhe në lidhje me kufizimet ndaj kontakteve të të burgosurve me familjarët e tyre ose me të burgosur të tjerë.⁸⁴ Së fundmi, Gjykata e shtriu këtë interpretim edhe në lidhje me zbatimin e një mase të posaçme mbikëqyrje e cila përfshin detyrimin për të mos u larguar nga zona e banimit e kërkuesit, për të mos marrë pjesë në takime publike, për të mos përdorur telefon celular, etj., duke arritur në përfundimin se edhe këto të drejta ishin të një natyre civile dhe ndaj tyre zbatohet neni 6 § 1⁸⁵.

⁸⁰ Shih vendimin e 9.02.2017, në lidhje me çështjen *Selmani dhe të tjerë k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 67259/14, § 27.

⁸¹ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 24.03.1988 në lidhje me çështjen *Olsson k. Suedisë*, Seria A, nr. 130; shih në 11 European Human Rights Reports 259. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 26.05.1994 në lidhje me çështjen *Keegan k. Irlandës*, Seria A, nr. 290; shih në 18 European Human Rights Reports 342.

⁸² Shih vendimin *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur.

⁸³ Shih mendimin më vete të Gjyqtarit Sir Gerald Fitzmaurice, në lidhje me këtë çështje, sidomos paragrafët 18-22.

⁸⁴ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 17.09.2009 në lidhje me çështjen *Enea k. Italisë*, nr. 74912/01, § 107 si dhe vendimet *Ganci k. Italisë*, nr. 41576/98, §§ 20-26, GJEDNJ, 2003-XI, *Musumeci k. Italisë*, nr. 33695/96, § 36, 11.01.2005, *Stegarescu dhe Bahrin k. Portugalisë*, nr. 46194/06, sidomos § 37-38, 6.04.2010.

⁸⁵ Vendim i Dhomës së Madhe i 23.02.2017, në çështjen *de Tommaso k. Italisë*, nr. 43395/09, sidomos paragrafi 147 e vijues.

Nga zbatimi i aspektit civil të nenit 6 arrijnë të përfitojnë gjithashtu, sipas jurisprudencës së Gjykatës edhe pretendimet e palëve civile në kontekstin e një procesi penal⁸⁶, madje edhe kur pretendimet e tyre për dëmshpërblim kanë vlerë thjesht simbolike, pra nuk kanë kriter të qartë ekonomik⁸⁷. Kjo është në fakt mënyra e vetme që Gjykata, nëpërmjet kriterit të interpretimit efektiv dhe praktik të dispozitave të Konventës, ofron një mbrojtje ndaj palëve civile në një proces penal, ndaj të cilave garancitë ‘penale’ të nenit 6 nuk gjejnë zbatim.

Megjithatë nga këto kritere që përmendëm më lart për qëllimet e zbatimit të nenit 6, përfshirë edhe atë ekonomik, ka edhe përjashtime. Për shembull, nuk mund të thuhet me po të njëjtën lehtësi që, përderisa paraqesin karakter ekonomik, edhe çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe individëve në fushën e taksave, të sigurimeve shoqërore dhe në atë të punësimit në sektorin publik, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 6. Madje si rregull i përgjithshëm, vendimet që kanë pasur të bëjnë me përgjegjësinë e personave për të paguar taksat ose në lidhje me mundësinë e tyre për të përfituar nga mospagimi ose nga reduktimi i taksave janë konsideruar nga Gjykata si çështje me karakter publik dhe jo me karakter “civil” për qëllimet e nenit 6 të Konventës⁸⁸. Ajo është shprehur se çështja e taksave në thelb bënte pjesë në prerogativat e autoriteteve publike, ku karakteri publik i marrëdhënies midis tatimpaguesit dhe komunitetit mbetet mbizotërues. Prandaj, ajo konsideroi se mosmarrëveshjet fiskale janë jashtë fushës së veprimit të të drejtave dhe detyrimeve civile, pavarësisht nga efektet që ato qartazi kanë në lidhje me situatën e tatimpaguesve⁸⁹. Si të tilla, në parim, ato përjashtohen nga fusha e veprimit të nenit 6. Megjithatë,

⁸⁶ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 12.02.2004, në lidhje me çështjen *Perez k. Francës*, nr. 47287/99, paragrafi 57 e vijues.

⁸⁷ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 20.03.2009, në lidhje me çështjen *Gorou k. Greqisë [nr 2]*, nr. 12686/03, § 24.

⁸⁸ Megjithatë duhet pasur kujdes në këtë pikë në lidhje me mundësinë e zbatimit të nenit 6 të, GJEDNJ, nën aspektin penal në fushën e tatim/taksave dhe të sanksioneve përkatëse që mund të veshin karakter penal në thelb. Shih më poshtë *Jussila k. Finlandës*.

⁸⁹ Shih 12.06.2001, *Ferrazzini k. Italisë*, [DH.M.] nr. 44759/98, § 25 dhe 29, 23.06.2002, *Taxi VAsberga Aktiebolag dhe Vulic k. Suedisë*, nr. 36985/97, § 75, vendimin mbi pranueshmërinë të 13.01.2005, *Emesa Sugar NV k. Holandës*, nr. 62023/00, etj.

në çështjen *Editions Periscope kundër Francës*⁹⁰, Gjykata konstatoi se një pretendim për një kompensim për humbjet materiale, të cilat kishin ardhur si pasojë e një refuzimi të paligjshëm për t'i akorduar shoqërisë, që në këtë rast ishte kërkuesi përpara Gjykatës, një përjashtim nga pagimi i taksave, ishte brenda fushës së veprimit të nenit 6.

Gjykata ka pranuar se situatat që përfshihen në atë që quhet *de jure imperii* – pra që është në thelb shprehje e ushtrimit të sovranitetit të Shtetit, nuk përfshihen në fushën e zbatimit të aspektit civil të nenit 6 të Konventës. Përveç mosmarrëveshjeve në lidhje me tatimet dhe taksat të analizuara më sipër në këtë kategori hyjnë edhe mosmarrëveshje të tilla si ato që kanë të bëjnë me imunitetet juridiksionale. Ky është një debat tepër interesant që ka qenë pjesë edhe e dialogëve në distancë por jo vetëm, mes juridiksioneve supreme të shteteve anëtare dhe Gjykatës së Strasburgut⁹¹.

Përveç kësaj kategorie nga garancitë e nenit 6 nën aspektin civil nuk përfitojnë as kategori të tjera mosmarrëveshjesh, si për shembull ato që kanë të bëjnë me të drejtën e të huajve për të migruar⁹² ose qëndruar në një Shtet, për të përfituar azil⁹³ ose për të marrë shtetësinë e atij shteti⁹⁴. Përrjashtohen gjithashtu rastet që kanë të bëjnë me të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur⁹⁵, ose mosmarrëveshjet në lidhje me kriteret e ushtrimit të një mandati parlamentar⁹⁶. Të tjera kategori që përjashtohen nga zbatimi i nenit

⁹⁰ Vendim i Gjykatës i vitit 1992, Seria A, nr. 234 – B.

⁹¹ Në lidhje me këtë problem shih më poshtë në Pjesën II të këtij komentari, I, A, ii, b, a.

⁹² Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1987 në lidhje me çështjen *P. k. Mbretërisë së Bashkuar*; në 54 Decisions and Reports 211.

⁹³ Shih *Maouia k. Francës*, [DH.M.], nr. 39652/98, §§ 37-41, 5.10.2000.

⁹⁴ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1988 në lidhje me çështjen *S k. Zvicrës*; në 59 Decisions and Reports 256. Shih nga ana tjetër nenet 3 dhe 4 të Protokollit 4 të Konventës si dhe nenit 1 të Protokollit 7 të saj.

⁹⁵ Shih vendimet e 21.10.1997, *Pierre-Bloch k. Francës*, nr. 120119961232t958, § 49-52, vendimin e 10.01.2012, *Hajili k. Azerbajxhanit*, nr. 6984/06, § 63, vendimin e 19.06.2012 në lidhje me çështjen *Partia Komuniste e Rusisë dhe të tjerë k. Rusisë*, nr. 29400/05, § 143 si dhe vendimin e 6.05.2014 mbi pranueshmërinë në çështjen *Fitini k. Greqisë*, nr. 30244/11.

⁹⁶ Shih vendimin mbi pranueshmërinë në lidhje me çështjen, *GJEDNJ*, 13.11.2014, *Hoon k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14832/11, § 28.

6 § 1, nën aspektin civil janë ato që kanë të bëjnë për shembull me kërkesat për të marrë patentë⁹⁷, me të drejtën për arsimim publik⁹⁸, ose me kriteret e përzgjedhjes për kryerjen e shërbimit ushtarak⁹⁹.

Gjykata e ka pranuar faktin që në sistemet juridike të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, ka një dallim themelor ndërmjet shërbimit civil dhe të punësuarve ndaj të cilëve zbatohet e drejta private. Në vijim në këtij pozicionimi ajo fillimisht pati vendosur që mosmarrëveshjet në lidhje me, *inter alia*, të drejtën për të pasur mundësi për të kandiduar për një funksion publik¹⁰⁰ apo me fillimin dhe marrjen fund të funksioneve të personave në shërbimin civil si rregull i përgjithshëm ngelen jashtë fushës së veprimit të nenit 6 të Konventës¹⁰¹. Megjithatë përjashtimet nuk mungojnë edhe ndaj këtij rregulli. Madje mund të thuhet se në këtë fushë janë shënuar, sidomos në dhjetëvjeçarën e fundit, zhvillimet më të spikatura jurisprudenciale për sa i përket zgjerimit të veprimit të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës. Kështu, për shembull, në çështjen *Lombardo kundër Italisë*¹⁰², Gjykata vendosi se një mosmarrëveshje në lidhje me pensionin që duhet të merrte një ish-gjyqtar, kishte të bënte me një të drejtë të karakterit civil. Në çështjen *Maaronichis kundër Qipros*¹⁰³, Gjykata vendosi që neni 6 gjente zbatim në lidhje me procedurat për kompensim në vijim të anulimit të një akti administrativ që e hidhte poshtë kandidaturën e kërkuarit për një vend pune në sektorin publik. Në vijim ajo jo vetëm e ka zgjeruar

⁹⁷ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1978 në lidhje me çështjen *X k. Austrisë*; në 14 Decisions and Reports 200.

⁹⁸ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1989 në lidhje me çështjen *Simpson k. Mbretërisë së Bashkuar*; në 64 Decisions and Reports 188. Shih gjithashtu nenin 2 të Protokollit 1 të Konventës në lidhje me të drejtën për t'u arsimuar.

⁹⁹ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1987 në lidhje me çështjen *Nocolussi k. Austrisë*, shih në 52 Decisions and Reports 266.

¹⁰⁰ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1989 në lidhje me çështjen *Habsburg-Lothringen k. Austrisë* në 64 Decisions and Reports 210. Por shih gjithashtu edhe nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës.

¹⁰¹ Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjen *Neigel k. Francës*, të 12.03.1997, vendimin e 9.06.1998 në lidhje me çështjen *Yves Maillard k. Francës*, dhe sidomos vendimin e Dhomës së Madhe të 8 dhjetorit 1999 në lidhje me çështjen *Pellegrin k. Francës*, nr. 28541/95 si dhe vendimin *Devlin k. Mbretërisë së Bashkuar*.

¹⁰² Vendim i Gjykatës i 26 nëntorit 1992, Seria A, nr. 249 – B.

¹⁰³ Vendim i Gjykatës i 24.04.1998. Shih gjithashtu vendimin e saj të 9.06.1998 në lidhje me çështjen *Cazenove de la Roche k. Francës*.

fushën e zbatimit të nenit 6 në lidhje me marrëdhëniet e punës në sektorin publik, por është përpjekur të përpunojë qartë edhe kriteret përcaktuese të këtij zbatimi në marrëdhëniet konkrete. Në vendimin e saj themelor në këtë fushë, *Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës*¹⁰⁴ Gjykata bëri çka mund të quhet një revolucion jurisprudencial duke pranuar prezumimin se neni 6 § 1, nën aspektin civil, gjen zbatim në lidhje me mosmarrëveshjet e punës në sektorin publik. Ato çka më parë ishin parimi, pra moszbatimi i nenit 6 § 1 në lidhje me këto mosmarrëveshje, pas vendimit Eskelinen bëhet përjashtimi dhe vetëm kur plotësohen së bashku dy kriteret specifike¹⁰⁵:

- a) kur e drejta e brendshme e përjashton në mënyrë eksplicite qasjen në gjykatë për mosmarrëveshje në lidhje me pozicionin ose kategorinë e stafit të përfshirë në mosmarrëveshjen përkatëse, dhe
- b) nëse ky përjashtim është i justifikuar për arsye objektive.

Në lidhje me një debat aktual për zhvillimet e kohëve të fundit në Shqipëri, sidomos në kuadrin e reformës në drejtësi, vlen të theksohet se Gjykata ka pranuar se prezumimi i zbatimit të aspektit civil të nenit 6 § 1 gjen zbatim edhe për të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve në lidhje zyrtarët dhe gjyqtarët, duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me emërimin, shkarkimin, trajtimin, promovimin dhe transferimin¹⁰⁶.

B. Mbi akuzat penale

a. nocioni i akuzës penale

Gjykata ka mbajtur qëndrimin se një akuzë penale është ose një “njoftim zyrtar që i jepet një individit nga ana e autoritetit kompetent

¹⁰⁴ Vendim i Dhomës së Madhe të 19.04.2007 në lidhje me çështjen *Vilho Eskelinen dhe të tjerët k. Finlandës*, nr. 63235/00.

¹⁰⁵ *Ibidem*. Shih në mënyrë të veçantë paragrafët 50 e vijues të vendimit

¹⁰⁶ Shih sidomos *Mishgijoni k. Shqipërisë, Alexander Volkov k. Ukrainës*, dhe sidomos dy vendime të Dhomës së Madhe, atë të 23.06.2016, në lidhje me çështjen *Baka k. Hungarisë*, nr. 20261/12, sidomos § 105, dhe në lidhje me çështjen *Denisov k. Ukrainës*.

në lidhje me një pretendim se ai ka kryer një vepër penale” ose në raste të tjera kur “gjendja e të dyshuarit është cenuar në mënyrë thelbësore”¹⁰⁷. Momenti në të cilin personit i bëhet një akuzë penale është i rëndësishëm për shkak se duke filluar pikërisht nga ky moment llogaritet elementi i afatit të arsyeshem dhe të gjithë elementët e tjerë me karakter kohor, në bazë të nenit 6 të Konventës. Megjithëse në pamje të parë mund të mendohet se identifikimi i karakterit “penal” të akuzës mund të jetë më i thjeshtë në raport me debatin që zhvilloam mbi “mosmarrëveshjet civile” praktika ka treguar kompleksitetin edhe në lidhje me këtë aspekt. Kjo sepse edhe në lidhje me problemet që konsiderohen të karakterit penal apo jo praktika ndryshon në vende të ndryshme anëtare të Këshillit të Evropës. Për këtë arsye gjejmë përsëri një teknikë të zhvilluar nga ana e Gjykatës për ta zgjidhur këtë çështje në mënyrë të pavarur nga praktikat shtetërore. Kjo është arsyeja që edhe në lidhje me akuzat penale është zhvilluar dhe gjen zbatim të vazhdueshëm kriteri i nocioneve autonome të Konventës. Madje duhet kujtuar se kjo teknikë interpretimi lindi në kuadrin e një çështje ku debati ishte nëse masa kishte karakter penal apo karakter administrativ, pikërisht në çështjen *Engel dhe të tjerë kundër Holandës*¹⁰⁸. Kjo çështje kishte të bënte me problemin e zbatimit të nenit 6 në procedura që sipas së drejtës së brendshme holandeze konsideroheshin disiplinore. Gjykata ngriti shqetësimin se nëse Shtetet Palë “do të kenë diskrecionin që ta cilësojnë një shkelje disiplinore dhe jo penale, ose ta ndjekin autorin e një shkelje “të përzier” në planin administrativ dhe jo në atë penal, veprimi i klauzolave themelore të neneve 6 dhe 7 do të ishin në varësi të vullnetit të tyre sovran”¹⁰⁹. Duke pasur parasysh këtë shqetësim, Gjykata përpunoi në këtë vendim nocionin e kriterëve autonome të interpretimit, dhe vazhdimisht, edhe sot

¹⁰⁷ Shih për shembull paragrafin 46 të vendimit të Gjykatës të 27.02.1980 në lidhje me çështjen *Deweert k. Belgjikës*, Seria A, nr. 35; shih në 2 European Human Rights Reports 439.

¹⁰⁸ Shih vendimin e sipërcituar të Gjykatës të 8.06.1976 në lidhje me çështjen *Engel dhe të tjerë k. Hollandës*, Seria A, nr. 22; shih në 1 European Human Rights Reports 647. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”, Qendra Evropiane, 2017.

¹⁰⁹ Ibid. paragrafi 81.

i referohet këtij vendimi kur përdor këtë teknikë, duke i quajtur madje këto “kriteret Engel”¹¹⁰. Kjo teknikë përfshin identifikimin e tre elementëve vijues për cilësimin e një situatë të veçantë si akuzë penale apo jo¹¹¹.

b. cilësimi sipas legjislacionit të brendshëm

Kriteri i parë që merret në shqyrtim për analizuar nëse një situatë thërret në veprim të dispozitave të nenit 6 është ai që ka të bëjë me cilësimin e veprës sipas legjislacionit dhe së drejtës së brendshme nacionale. Në qoftë se sistemi ligjor i brendshëm e kualifikon veprën si penale atëherë kjo konsideratë është themelore edhe pse çështja në fjalë mund të ketë një rëndësi të kufizuar. Në një rast të tillë edhe Gjykata e cilëson veprën penale pa ndonjë shqyrtim të mëtejshëm të natyrës dhe karakteristikave të saj. Por nëse nuk jemi në një situatë të tillë dhe e drejta e brendshme nuk është e qartë ose nuk e konsideron një çështje si penale por si civile ose disiplinore, ky cilësim, megjithëse i rëndësishëm nuk është përcaktues në lidhje me cilësimin e çështjes sipas Konventës. Gjykata ka sqaruar se cilësimi i veprës sipas legjislacionit të brendshëm ka vlerë vetëm formale dhe relative dhe shërben vetëm si pika e fillimit të analizës së saj¹¹². Në një rast të tillë hyjnë në lojë dy kriteret e tjera¹¹³. E ritheksojmë, duke kujtuar paragrafin 81 të çështjes së lartpërmendur Engel dhe të tjerë, se ky qëndrim është mbajtur për shkak se në qoftë se do të procedohej vetëm me cilësimin e veprës sipas së drejtës së brendshme një Shtet do të mund të shmangte detyrimet e tij në bazë të nenit 6 thjesht duke ri-kualifikuar veprën në kodin e tij penal ose administrativ.

¹¹⁰ Shih për shembull *Ezeh dhe Connors*, i lartpërmendur, § 86.

¹¹¹ Shih *Engel dhe të tjerë k. Hollandës*, 8.06.1976, Series A nr. 22, p. 35, § 82; *Lutz k. Gjermanisë*, 25.08.1987, Series A nr. 123, p. 23, § 55; *Weber k. Zvicrës*, 22.05.1990, Series A nr. 177, pp. 17-18, §§ 31-34, dhe *Demicoli k. Maltës* 27.08.1991, Series A nr. 210, pp. 15-17, §§ 30-35.

¹¹² Shih vendimin e 22.05.1990, në lidhje me çështjen *Weber k. Zvicrës*, Seria A nr. 177, § 31, dhe *Ezeh dhe Connors k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DH.M.], nr. 39665/98 dhe 40086/98, § 91, GJEDNJ, 2003-X.

¹¹³ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 21.02.1994 në lidhje me çështjen *Ravnsborn k. Suedisë*; Seria A, nr. 283 - B, sidomos §§ 31-36.

c. natyra e shkeljes

Kriteri i dytë që përdor Gjykata për të vlerësuar se është përpara një akuze penale apo jo ka të bëjë me natyrën e veprës. Në këtë kontekst, Gjykata analizon qëllimin e dispozitës së brendshme të zbatueshme dhe të masës që ajo parashikon, nëse kjo masë ka karakter ndëshkues, parandalues ose tjetër¹¹⁴. Një element tjetër që Gjykata e merr në shqyrtim në vlerësimin e këtij kriteri të dytë është ai që lidhet me zbatueshmërinë e dispozitës përkatëse. Nëse kjo dispozitë dhe masa përkatëse gjejnë zbatim vetëm në lidhje me një grup apo kategori të caktuar njerëzish, siç mund të ishte një grup profesionistësh, si avokatët, mjekët, farmacistët, ushtarakët, etj., atëherë ka shumë mundësi që Gjykata të arrijë në përfundimin se sanksioni të kishte karakter disiplinor dhe jo penal¹¹⁵. Megjithatë në qoftë se dispozita dhe masa përkatëse gjejnë zbatim të përgjithshëm atëherë ajo mund edhe të konsiderohet me karakter penal për qëllimet e nenit 6 të Konventës¹¹⁶. Kur Gjykata vlerëson se dispozita dhe masa kanë karakter “të përzier”, pra kur sanksioni mund të jetë me karakter sa administrativ por edhe penal, atëherë merr një rëndësi të veçantë kriteri i tretë, i analizuar në vijim¹¹⁷.

d. natyra dhe ashpërsia e dënimit

Në vlerësimin përfundimtar nëse një masë ka karakter penal apo jo Gjykata i kushton normalisht më tepër vëmendje ashpërsisë së dënimit që kërkuesi mund të vuajë si pasojë e shkeljes që ka kryer. Në çështjen *Bendenoun kundër Francës*¹¹⁸, Gjykata vendosi që shkeljet për të cilat parashikoheshin dënime të rënda me gjobë për shkak të shmangies nga tatimi ishin me karakter “penal” për

¹¹⁴ Vendimi *Ozturk k. R.F.GJ.*, 21.02.1984, nr. 8544/79, § 53.

¹¹⁵ Shih vendimin e 22.05.1990, në lidhje me çështjen *Weber k. Zvicrës*, nr. 11034/84.

¹¹⁶ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1984 në lidhje me çështjen *Ozturk k. Republikës Federale Gjermane*, Seria A, nr. 73; shih në 6 European Human Rights Reports 409, vendimin e Gjykatës të 2.09.1998 në lidhje me çështjen *Lauko k. Sllovakisë*, L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur, gusht 1991, *Demicoli k. Maltës*, nr. 13057/87, § 33 dhe vendimin e një Komiteti të GJEDNJ-së të 9.01.2014, në lidhje me çështjen *Tasiouli k. Greqisë*, nr. 36169/10, § 15.

¹¹⁷ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 9.10.2003 në lidhje me çështjen *Ezeh dhe Connors k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 39665/98 dhe 40086/98, § 106.

¹¹⁸ Vendim i Gjykatës i vitit 1994, Seria A, nr. 284; shih në 18 European Human Rights Reports 54.

shkak se ato parashikonin dënime të ashpra që arrinin deri në heqje lirie për mos-pagim të gjobave. Duke mbajtur parasysh llojin dhe masën e dënimit që ato parashikonin, Gjykata i ka konsideruar si me karakter “penal” disa shkelje që kishin të bënin me keq-administrimin e drejtësisë¹¹⁹, apo me privilegjet parlamentare¹²⁰. Në këtë drejtim vlen të theksohet se Dhoma e Madhe vendosi se neni 6 gjente zbatim në një rast të ndalimit të një të mituri për 30 ditë në një qendër paraburgimi me qëllim riedukimin e tij, megjithëse ky vendim ishte marrë në kuadrin e një procedure e cila nuk konsiderohej si penale sipas të drejtës së brendshme ruse.¹²¹ Nëse një dënim eventual me burg konsiderohet se përgjithësisht e sjell situatën nën veprimin e aspektit penal të nenit 6¹²², nga ky rregull mund të ketë edhe përjashtime, kur periudha është e shkurtër dhe konteksti specifik. Kështu për shembull Gjykata u shpreh se një dënim me arrest në izolim për 2 ditë i z. Engel¹²³ nuk ishte aq i ashpër sa ta përfshinte situatën nën veprimin e nenit 6, aspekti penal. Por nga ana tjetër, në çështjen *Ezeh dhe Connors*¹²⁴, Dhoma e Madhe, ashtu si edhe Dhoma u shpreh se edhe një dënim me burg prej 40 ditësh për kërkuesin e parë dhe 7 ditësh për kërkuesin e dytë ishin të mjaftueshme që masa ndaj tyre të konsiderohej se ishte me karakter penal. Duhet theksuar gjithsesi se nuk është e

¹¹⁹ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1990 në lidhje me çështjen *Weber k. Zvicrës*, Seria A, nr. 177; shih në 12 European Human Rights Reports 508. Megjithatë, shih nga ana tjetër edhe çështjen e lartpërmendur të Gjykatës të 21.02.1994 në lidhje me çështjen *Ravnosborn k. Suedisë*; Seria A, nr. 283 – B; (shih në 18 European Human Rights Reports 38) në të cilën u vendos se neni 6 nuk gjente zbatim, në lidhje me krijimin e problemeve për mbarëvajtjen e drejtësisë, pavarësisht nga dënimi që ishte një gjobë që mund edhe të kthehej në dënim me heqje lirie.

¹²⁰ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1991 në lidhje me çështjen *Demicoli k. Maltës*, Seria A, nr. 210; shih në 14 European Human Rights Reports 47.

¹²¹ Shih vendimin e Dhomës së Madhe të 23.03.2016 në lidhje me çështjen *Bloktin k. Rosisë*, nr. 47152/06, § 179 e vijues.

¹²² Në paragrafin 82 të vendimit Engel dhe të tjerë, të lartpërmendur, Gjykata u shpreh se “Në një shoqëri që respekton shtetin ligjor, heqjen e lirisë që mund të jepen si dënim i përkasin ‘sferës penale’, përveç atyre që për nga natyra, kohëzgjatja ose mënyra e ekzekutimit haptazi nuk mund të jenë të dëmshme. Serioziteti i asaj që është në rrezik, traditat e Shteteve Palë dhe rëndësia që i jep Konventa respektimit të lirisë fizike të personit, të gjitha këto e kërkojnë këtë gjë”. Shih gjithashtu vendimin e 31.07.2007, në lidhje me çështjen *Zaicevs k. Letonisë*, nr. 65022/01, §§ 31-36 ose atë të 9.03.2006, në lidhje me çështjen *Menesheva k. Rosisë*, nr. 59261/00, §§ 94-98.

¹²³ Vendimi *Engel dhe të tjerë k. Holandës*, i sipërcituar.

¹²⁴ *Ezeh dhe Connors k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DH.M.], nr. 39665/98 dhe 40086/98, § 91, GJEDNJ, 2003-X.

nevojshme që kërkuesi ta ketë kryer dënimin, natyra dhe ashpërsia e të cilit janë përcaktues për cilësimin e akuzës si penale. Mjafton që një dënim i tillë të jetë i parashikuar nga dispozita e zbatueshme në mënyrë që kjo e fundit të konsiderohet se ka karakter penal¹²⁵. Ky argument duket se pati ndikim në përfundimin e Gjykatës në çështjen *Ezeh dhe Connors*¹²⁶.

Interesante është të theksohet, sidomos për situatën shqiptare, se Gjykata ka gjetur se neni 6 gjen zbatim edhe në lidhje me procedurat e lustracionit. Në çështjen *Matyjek kundër Polonisë*¹²⁷, për shembull, Gjykata vendosi se skualifikimi për 10 vjet nga mbajtja e një posti publik, i një personi që kishte gënjer në procedurat e lustracionit, përbënte një sanksion mjaft të ashpër sa të futej në veprim aspekti penal i neni 6 § 1 të Konventës. Nga ana tjetër, dënimet e skualifikimit të kandidatit në zgjedhje dhe rikthimi i të gjitha shumave të shpenzuara nga kandidati për fushatën e tij elektorale, që ishin më tepër se shumata e parashikuara për këtë qëllim, nuk u konsideruan nga Gjykata aq të ashpra sa të konsideroheshin si dënime me karakter “penal”¹²⁸.

Duhet theksuar se, sipas Gjykatës, kriteri i dytë dhe ai i tretë Engel janë alternativë dhe jo kumulativë. Ajo sqaron se “që neni 6 të gjejë zbatim, mjafton që vepra në fjalë, për shkak të natyrës së saj, të konsiderohet “penale” nga pikëpamja e Konventës, ose që për shkak të kryerjes së kësaj vepre, personi përgjegjës të mund të dënohet me një sanksion i cili, nga natyra dhe shkalla e ashpërsisë, i përket në përgjithësi sferës ‘penale’”¹²⁹. Megjithatë, nëse në një rast të caktuar në shqyrtim, analiza e secilit prej këtyre kriterëve

¹²⁵ Shih ndër të tjera vendimin e 25.08.1987 në lidhje me çështjen *Lutz k. Gjermanisë*, Seria A nr. 123, p. 23, § 55, si dhe vendimin e 24.09.1997, në lidhje me çështjen *Garyfallou AEBE k. Greqisë*, nr. 18996/91, § 34.

¹²⁶ *Ibid.*, § 129.

¹²⁷ Vendim mbi pranueshmërinë i 30.05.2006, nr. 38184/03. Shih sidomos §§ 42-59.

¹²⁸ Shih vendimin e Gjykatës të 21.10.1997 në lidhje me çështjen *Pierre-Bloch k. Francës*; shih në 26 European Human Rights Reports 202.

¹²⁹ Shih *Öztürk k. Gjermanisë*, judgment of 21.02.1984, Series A nr. 73, p. 21, § 54, dhe *Lutz k. Gjermanisë*, judgment of 25.08.1987, Series A nr. 123, p. 23, § 55, ose *Ezeh dhe Connors*, të lartpërmendur, § 86.

më vete nuk çon në një përfundim të qartë mbi ekzistencën apo jo të një akuze penale, Gjykata mund t'i analizojë ata së bashku¹³⁰.

C. Fazat e procedurës të mbuluara nga neni 6

Megjithëse teksti i dispozitës së nenit 6 i referohet në mënyrë të posaçme seancave gjyqësore duke u shprehur që çdo person ka të drejtë që çështja e tij “të dëgjohej ... nga një gjykatë”, ai zbatohet edhe ndaj fazave të tjera të procedurës qoftë ato që i paraprijnë seancave gjyqësore, duke filluar që nga e drejta për t’iu drejtuar një gjykatë, qoftë edhe të fazave procedurale që vijnë pas mbylljes së seancave gjyqësore¹³¹, përfshirë edhe me procedurat që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve¹³². Konkretisht në lidhje me çështjet penale Gjykata ka theksuar që neni 6 gjen zbatim ndaj tërësisë të procedurave në lidhje me “bazueshmërinë e çdo akuze penale”¹³³ duke filluar që nga faza e hetimeve të kryera nga ana e policisë¹³⁴, deri tek ajo e caktimit të dënimit¹³⁵. Edhe për sa i përket çështjeve civile është e qartë tashmë që neni 6 gjen zbatim që nga faza e qasjes në gjykatë¹³⁶ dhe deri tek ekzekutimi

¹³⁰ Shih çështjet *Engel dhe të tjerët*, i lartpërmendur, § 82 e vijues, *Bendenoun k. Francës*, 24.02.1994, Series A nr. 284, fq. 20, § 47; *Benham k. Mbretërisë së Bashkuar*, 10.06.1996, *Reports of Judgments and Decisions 1996-III*, fq. 756, § 56, *Garyfallou AEBE k. Greqisë*, 24.09.1997, *Reports 1997-V*, fq. 1830, § 33; dhe *Lauko k. Sllovakisë*, 2.09.1998, *Reports 1998-VI*, pp. 2504-05, § 57, si dhe *Kasparov dhe të tjerët k. Rusisë*, 3.10.2013, nr. 21613/07, § 40.

¹³¹ Shih *Eckle k. Gjermanisë*, nr. 8130/78, 76 dhe 77, GJEDNJ, 15.07.1982, GJEDNJ, [DH.M.], 16.12.1999, T. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 24724/94, § 108., GJEDNJ, 28.11.2013, *Aleksandr Dementev k. Rusisë*, nr. 43095/05, § 23.

¹³² Shih *Ganci k. Italisë*, nr. 41576/98, §§ 20-26, 30.10.2003.

¹³³ Shih *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, 5.06.2001, nr. 41087/98, § 39. Në këtë çështje Gjykata vlerësoi se një procedurë konfiskimi ishte e ngjashme me një procedurë dënimi.

¹³⁴ Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Imbroscia k. Zvicrës*; shih në 17 European Human Rights Reports 41.

¹³⁵ Shih *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, 25.02.1997, *Reports 1997-I*, fq. 279, § 69. Shih gjithashtu *Aleksandr Dementev k. Rusisë* ku Gjykata theksoi, në paragrafin 25, se neni 6 gjente zbatim në fazën e caktimit të një dënimi global, pasi ky nuk mund të konsiderohet si një “formalitet ose një ushtrim aritmetik, përdërisa gjykatat ruse në caktimin e masës duhet të mbajnë parasysh personalitetin e të akuzuarit si dhe rrethanat lehtësuese ose rënduese në lidhje me veprën e kryer. Madje ajo ka theksuar se neni 6 shtrihet deri në fazën e caktimit të dënimit, edhe kur ky element i procedurës, në praktikën e vendeve të ndryshme, i lihet si kompetencë ekzekutive me një vendim të posaçëm gjykatë (shih edhe vendimin *T.dhe K. k.Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 106-110.

¹³⁶ Shih *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur. Shih gjithashtu në vijim në lidhje me garancitë e përgjithshme të nenit 6.

i vendimeve përfundimtare administrative ose gjyqësore¹³⁷.

Neni 6 nuk garanton një të drejtë për të bërë një apelim kundër vendimeve gjyqësore qoftë në çështjet penale qoftë në ato civile dhe nuk i detyron shtetet anëtare që të ngrenë një sistem të tillë apelimi ose ankimi, përpara ndonjë gjykate apeli, të lartë apo kushtetuese¹³⁸. Megjithatë në rastet kur një Shtet parashikon të drejtën për apelim kundër vendimeve të gjykatave të veta, procedurat përpara gjykatave më të larta pranë të cilave bëhet ky apelim duhet të përputhen me kërkesat e nenit 6 të Konventës dhe kufizimi i së drejtës për apel përpara tyre nuk mund të bëhet në mënyrë jo-proporcionale¹³⁹, ose diskriminuese¹⁴⁰, duke pasur parasysh çka kupton me këto koncepte interpretimi i nenit 6 dhe i Konventës në tërësi¹⁴¹. Për më tepër, në një sërë rastesh Gjykata ka konfirmuar që neni 6 i Konventës zbatohet edhe në lidhje me procedurat përpara gjykatave kushtetuese të Shteteve Palë, rezultati i të cilave është mënyrë të drejtpërdrejtë përcaktues për një të drejtë ose detyrim të karakterit civil¹⁴².

Nga ana tjetër Gjykata ka theksuar se neni 6 nuk është i zbatueshëm ndaj një kërkesë që synon rihapjen e procedurës penale, për shkak se pas dënimit përfundimtar nuk kemi të bëjmë më me një akuzë

¹³⁷ Shih një numër të konsiderueshëm vendimesh kundër Shqipërisë, duke filluar me vendimin e parë *Qufaj Sh.p.k. k. Shqipërisë*, 18.11.2004. . Shih më poshtë në lidhje me garancitë e përgjithshme të nenit 6.

¹³⁸ Shih *Delcourt k. Belgjikës*, [DH.M.], 17.01.1970, nr. 2689/65, § 25, *Kudla k. Polonisë* [Dh.M.], 26.10.2000, nr. 30210/96, § 122, *Hoffmann k. Gjermanisë*, 11.10.2001, nr. 34045/96, § 65. Duhet kujtuar që e drejta për apelim në lidhje me çështjet penale është parashikuar nga ana e nenit 2 të Protokollit 7.

¹³⁹ Shih për shembull *Poitrimol k. Francës*, 23.11.1993, nr. 14032/88, § 35-38 dhe *Garcia Manibardo k. Spanjës*, 15.02.2000, nr. 38695/97, §§ 44-45.

¹⁴⁰ Shih *Hoffmann k. Gjermanisë*, të lartpërmendur, në § 66.

¹⁴¹ Megjithatë neni 6 nuk do të konsiderohet se është shkelur pranë gjykatave të apelit në rast se këto nuk plotësojnë disa kërkesa si e drejta për një seancë me dyer të hapura me kusht që një gjë e tillë të jetë respektuar në gjykatat e niveleve më të ulëta. Në vendimin e dhënë në lidhje me çështjen *Brunella Gomez k. Spanjës*, (vendim i 19 dhjetorit 1997) Gjykata vendosi se rregullat e reja të procedurës mbi pranueshmërinë e kërkesave të apelit në Gjykatën e Lartë të Spanjës nuk ia kufizonin në mënyrë të gabuar kërkuiesit të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate. Shih *Marini k. Shqipërisë*.

¹⁴² Shih sidomos vendimin *Marini k. Shqipërisë*, vendimin e Gjykatës të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Kraska k. Austrisë*, Seria A, nr. 254-B; shih në 18 European Human Rights Reports 188.

penale sipas kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës¹⁴³. Megjithatë, duhet theksuar se neni 6 § 1 i Konventës gjen zbatim nëse gjykatat e brendshme e kanë pranuar rihapjen e procedurave sipas së drejtës së brendshme dhe shqyrtojnë themelin e akuzës penale¹⁴⁴.

Pas shqyrtimit të praktikës gjyqësore në lidhje me mënyrat e interpretimit të nenit 6 dhe të nocionit të procesit të drejtë është e rëndësishme të shqyrtojmë tani garancitë e përgjithshme (Pjesa II) dhe specifike (Pjesa III) që ofron kjo dispozitë për palët në procese gjyqësore civile apo penale.

¹⁴³ Vendimi mbi pranueshmërinë 6.05.2003, *Fischer* k. *Austrisë*, nr. 27569/0, GJEDNJ, 22.11.2011, *Andreyev* k. *Estonisë*, nr. 48132/07, § 76. dhe sidomos vendimin e Dhomës së Madhe, *Boulois* k. *Luksemburgut*.

¹⁴⁴ *Shih Moreira Ferrera* k. *Portugalisë* (nr. 2), [DH.M.], 11.04.2017, nr. 19867/12, § 65.

PJESA II

GARANCITË E PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË DREJTË

I. Garanci themelore konceptuale

Është disi e çuditshme të konstatohet se neni 6 i Konventës nuk parashikon shprehimisht as të drejtën për t'u ankuar në një gjykatë¹⁴⁵ dhe as të drejtën që vendimi përfundimtar i dhënë nga gjykatat të ekzekutohet. Megjithëse me një distancë kohore më shumë se 20 vjeçare nga njëra-tjetra,¹⁴⁶ Gjykata ka filluar të merret dhe ta sqarojë vendin dhe rolin e këtyre dy nocioneve në kuadrin e nenit 6, duke arritur hap pas hapi që t'i plotësojë relativisht shpejt këto dy 'mangësi' të tekstit të Konventës. Në vijim do t'i analizojmë të dy këto nocione një nga një, duke u përpjekur t'i qartësojmë shkurtimisht.

A. e drejta për t'iu drejtuar gjykatës

a. parimi

Gjykata, duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit ose thënë ndryshe të shtetit të së drejtës¹⁴⁷, e ka interpretuar nenin 6 § 1 në

¹⁴⁵ Kjo mangësi është konstatuar nga vetë Gjykata në vendimin *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar* ku ajo shprehet se "...neni 6 § nuk e parashikon shprehimisht të drejtën e qasjes në gjykata ose në tribunale. Ai shpall të drejta që janë të dallueshme, por që burojnë nga e njëjta ide bazë dhe të cilat, të marra së bashku, përbëjnë një të drejtë të vetme që nuk është përcaktuar në kuptimin e ngushtë të termit. Është detyrë e Gjykatës të konstatojë, me anë të interpretimit, nëse qasja në gjykatë përbën një faktor ose aspekt të kësaj të drejte", § 28.

¹⁴⁶ Respektivisht, *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Hornsby k. Greqisë*, të përmendur më lart.

¹⁴⁷ Shih edhe vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane (sot të Bashkimit Evropian), në çështjen 294/83, '*Të Gjellbrit'* k. *Parlamentit Evropian* (vendim i 23.04.1986 [1986] ECR 1339).

mënyrë të tillë që përfshin edhe të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate. Në mënyrë krejt domethënëse ajo shprehet se “... nuk mund të konceptohet sundimi i ligjit pa pasur mundësi për të pasur qasje në gjykatë”¹⁴⁸. Sipas kriterit të interpretimit praktik dhe efektiv të të drejtave të garantuara nga Konventa, pa të drejtën për t'u ankuar në një gjykatë asnjë nga të drejtat specifike të parashikuara nga teksti i nenit 6 nuk do të kishte aspak kuptim dhe as efekt konkret. Gjykata e thotë këtë në mënyrën më të qartë të mundshme duke u shprehur se “Karakter i drejtë, publik dhe i shpejtë i procedurave gjyqësore nuk kanë asnjë vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore”¹⁴⁹, pra nëse individët nuk kanë mundësinë efektive që t'i drejtohen gjykatave. Një interpretim i tillë është më se i logjikshëm dhe nuk mund të thuhet se ai krijon një detyrim të ri.

Për këtë arsye Gjykata ka qenë e mendimit që e drejta për një gjykim të drejtë kërkon që një person të ketë, para së gjithash, mundësi që t'i drejtohet një gjykate. Është me vlerë të citohet e plotë ajo çka Gjykata ka thënë në këtë drejtim, në përfundim të analizës së saj të cilës iu referuam më sipër, në vendimin e lartpërmendur Golder:

“Duke marrë së bashku të gjitha konsideratat e mësipërme, rrjedh se e drejta e qasjes përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi 1 (neni 6 § 1). Ky nuk është një interpretim i zgjeruar që shton detyrime të reja për Shtetet Kontraktuese: ajo bazohet në termat e fjalisë së parë të nenit 6, paragrafi 1 (neni 6 § 1) lexohet në kontekstin e tij dhe duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e Konventës, një traktat ligjvënës (shih vendimin Wemhoff të 27 qershorit 1968, Seria A, nr.7, fq.23, paragrafi 8) dhe parimet e përgjithshme të së drejtës. Prandaj, pa pasur nevojë të përdorë ‘mjete shitesë të interpretimit’ siç parashikohet në nenin 32 të Konventës së

¹⁴⁸ Shih paragrafin 34 të vendimit të saj Golder, të lartpërmendur. Në atë paragraf Gjykata vijon “Kjo përforcohet edhe nga fakti që Statuti i Këshillit të Evropës, një organizatë në të cilën është anëtar secili nga shtetet palë në Konventë (neni 66 i Konventës), i referohet në dy vende shtetit ligjor: së pari në Preambulë, ku qeveritë nënshkruese pohojnë përkushtimin e tyre ndaj këtij parimi dhe së dyti në nenin 3 i cili parashikon që “çdo anëtar i Këshillit të Evropës duhet të pranojë parimin e shtetit të së drejtës ...”

¹⁴⁹ Ibid. § 35.

Vjenës, Gjykata arrin në përfundimin se neni 6, paragrafi 1 (neni 6 § 1) i siguron të gjithëve të drejtën që çdo pretendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile t'ia paraqesin një gjykatë ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen mishëron 'të drejtën për një gjykatë', ndaj së cilës e drejta e qasjes, që është e drejta për të filluar procedime para gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt. Këtij aspekti i shtohen garancitë e parashtruara nga neni 6 paragrafi 1 (neni 6 § 1) për sa i përket organizimit dhe përbërjes së gjykatës, si dhe zhoillimit të procedurave. Si përfundim, kjo tërësi përbën të drejtën për një gjykim të drejtë."¹⁵⁰

Në fakt e drejta e një individi që një pretendim që ai ka, t'ia paraqesë për shqyrtim dhe vendim një gjyqtari, konsiderohet si një parim themelor i njohur në nivel universal, pasi ai është shprehja më e qartë dhe fillestare e parimit të së drejtës ndërkombëtare i cili ndalon mohimin e dhënies së drejtësisë. Ky konceptim ka frymëzuar edhe interpretimin teleologjik të nenit 6 nga ana e Gjykatës, pra një interpretim i orientuar nga qëllimi dhe mbrojtja efektive e të drejtave të garantuara nga ky nen.

Duke kujtuar vlerën e jashtëzakonshme që nocioni i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave ka në një shoqëri demokratike ku sundon shteti i së drejtës¹⁵¹, Gjykata e ka vënë theksin në atë që e drejta për t'iu drejtuar gjykatave duhet të jetë "konkrete dhe efektive" dhe jo "teorike dhe iluzive"¹⁵². Kjo do të thotë konkretisht se një individ që pretendon se i janë shkelur të drejtat duhet të jetë në gjendje jo vetëm të kundërshtojë aktin që pretendon se i shkel të drejtat por edhe t'i parashtojë pretendimet e tij në gjykatën kompetente në mënyrë të kënaqshme.¹⁵³

¹⁵⁰ Ibid. § 36.

¹⁵¹ Shih *Golder*, i lartpërmendur, § 34. Shih gjithashtu *Princi Hans-Adam II i Lihtenshteinit k. Gjermanisë* [DH.M.], 12.06.2001, nr. 42527/98, § 45.

¹⁵² Shih *Bellet k. Francës*, 4.12.1995, nr. 23805/94, § 36.

¹⁵³ *Multiplex k. Kroacia*, nr. 58112/00, 10.06.2003, § 44, *Kutic k. Kroacisë*, 1.03.2002, nr. 48778/99, § 25, si dhe *Philis k. Greqi*, nr. 12750/87, 13780/88 dhe 14003/88, §§ 58 e vijues.

Pra, thelbi i nocionit të së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate mund të përkufizohet shkurtimisht, së pari, si e drejta për të pasur mundësi për t'u ankuar dhe për të paraqitur përpara një gjykate pretendimet përkatëse në lidhje me çdo akt që një person mendon se i shkel të drejtat e tij¹⁵⁴. Kjo gjykatë duhet të ketë juridiksion të shqyrtojë pretendimet e ankuesit si mbi faktet ashtu edhe mbi të drejtën e zbatueshme dhe interpretimin e saj¹⁵⁵. Së dyti, gjykatat duhet të jenë në gjendje që të marrin një vendim i cili prodhon pasoja juridike konkrete, pra të japë një vendim të detyrueshëm¹⁵⁶. Pra, e drejta e qasjes së një gjykate përfshin jo vetëm të drejtën për të filluar një veprim, por edhe për të drejtën për një zgjidhje juridiksionale të mosmarrëveshjes¹⁵⁷. Në qoftë se një gjykatë ka vetëm kompetenca këshillimore dhe nuk është në gjendje që si rezultat i procedurës para saj, të ndreqë konkretisht pozitën juridike të ankuesit, pra nuk prodhon pasoja juridike konkrete, atëherë ajo mund të mos plotësojë kriteret e nenit 6, duke mos qenë mjet efektiv. Ky element i dytë megjithëse mund të duket i njëjtë në pamje të parë me atë të mos-ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare, sidomos duke pasur parasysh situatën shqiptare, përfaqëson në fakt një aspekt më të spikatur që lidhet jo me vlerën juridike të vendimeve të gjykatave në sistemin e brendshëm ligjor por, më gjerë, me strukturën institucionale dhe juridiksionale që shtetet ngrenë në mënyrë që individët të mund të mund të ankohen efektivisht dhe të mbrojnë të drejtat e tyre para një gjykate me kompetenca mirëfillta gjyqësore¹⁵⁸.

¹⁵⁴ Shih vendimi mbi pranueshmërinë në çështjen *Cañete de Goñil k. Spanjës*, 15.01.2002, nr. 55782/00, § 34.

¹⁵⁵ *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere*, i lartpërmendur §§ 54-61.

¹⁵⁶ Shih Benthem, §§ 40-43

¹⁵⁷ *Falje k. Rumanisë*, nr. 23257/04, § 22 dhe 24, GJEDNJ, 19.05.2015, *Kutic k. Kroacisë*, nr. 417778/98, § 25, GJEDNJ, 11.03.2002, *Fanullia greko-katolike Lupeni dhe të tjerë k. Rumanisë*, i lartpërmendur, § 86.

¹⁵⁸ Shembulli më i qartë në këtë drejtim është ai i vendimit *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, i lartpërmendur. Shih në veçanti paragrafët 95 dhe 96 si dhe referencat e cituara aty. Gjykata shprehet se mos respektimi në praktikë i vendimit të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata Administrative e Rrethit Vlorë, më 7.11.2013, e kishte privuar nenin 6 § 1 nga çdo efekt i dobishëm. Në fakt, në atë çështje Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë jo vetëm që nuk i respektonte, por në thelb i prishte vendimet e gjykatave administrative (të Vlorës dhe të Apelit në Tiranë), duke cenuar haptazi vlerën juridike të këtyre vendimeve dhe duke bërë të kotë që në fillim çdo ankesë. Shih në vijim analizën si në lidhje me mos-ekzekutimin e vendimeve (Pjesa II, I, B), ashtu edhe në lidhje me pavarësinë e gjykatave (Pjesa II, II, B, a).

Kur një vendim që ndikon në të drejtat me karakter civil ose mbi një akuzë penale merret nga një organ administrativ, disiplinor ose ekzekutiv, Konventa kërkon që ligji të ofrojë mundësinë për një të drejtë ankimi përpara një organi gjyqësor të paktën në një fazë të shqyrtimit gjyqësor¹⁵⁹. Shembull i qartë në këtë drejtim është vendimi *Dauti kundër Shqipërisë*¹⁶⁰, ku kërkuesi, sipas legjislacionit shqiptar, nuk kishte mundësi të ankimonte në gjykatë vendimin e Komisionit të Apelimit të Mjekësisë për Aftësitë për Punë. Meqë ky Komision nuk përbënte një gjykatë në kuptim të nenit 6 të Konventës, Gjykata gjeti një shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë për shkak të paaftësisë së kërkuesit për të kundërshtuar vendimet e organeve administrative lidhur me përfitimet nga paaftësia në punë. Ndërsa tek *Dauti* elementi problematik që çoi në shkelje kishte të bënte me mungesën e pavarësisë së anëtarëve të Komisionit të Apelimit, dhe pamundësinë vijuese për t'u ankuar në një organ të pavarur, ka edhe një tjetër element që duhet mbajtur parasysh mirë në situata të tilla. Kur një masë që prodhon pasoja juridike merret nga organe administrative ose disiplinore, duhet të individi të ketë mundësi që të ankohet ndaj saj përpara një autoriteti gjyqësor, jo vetëm të pavarur por edhe me juridiksion të plotë shqyrtimi¹⁶¹.

E drejta për t'u drejtuar gjykatave gjen zbatim si për procedurat “penale” ashtu edhe për ato “civile”¹⁶² dhe madje edhe ndaj atyre procedurave që në të drejtën e brendshme konsiderohen dhe shqyrtohen nga e juridiksionet administrative¹⁶³. Ajo gjen zbatim

¹⁵⁹ *Albert dhe Le Compte*, i lartpërmendur, §§ 25-37.

¹⁶⁰ nr. 19206/05, vendim i datës 3.02.2009.

¹⁶¹ *Shih Albert dhe Le Compte k. Belgjikës*, nr. 7299/75 dhe 7496/76, § 25-37, GJEDNJ, 10.02.1983, *Zumtobel k. Austrisë*, nr. 12235/86, § 29, GJEDNJ, 21.09.1993, *Sigma Radio Television Ltd k. Qipros*, nr. 32181/04 dhe 35122/05, GJEDNJ, 21/07/2011, *Segame SA k. Francës*, nr. 4837/06, § 55, GJEDNJ, 7.06.2012, *Saghatetyan k. Armenisë*, GJEDNJ, 20.10.2015. Megjithatë shih nuancat që pëson ky parim, në funksion të natyrës të të drejtave që janë në lojë si dhetë sistemeve të ndryshme të vendeve anëtare në *Bryan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 22.11.1995, Seria A nr. 335-A, p. 11, §§ 34-47, *Chapman k. Mbretërisë së Bashkuar*, [D.H.M.], nr. 27238/95, GJEDNJ, 18.01.2001, § 124, *Jane Smith k. Mbretërisë së Bashkuar*, [D.H.M.], nr. 25154/94, § 133, GJEDNJ, 18.01.2001.

¹⁶² *Shih vendimin Deweer*, i lartpërmendur, §§ 48-54.

¹⁶³ *Shih debatin e zhvilluar më sipër në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 në mosmarrëveshjet administrative, sidomos me vendimin Vilho Eskelinen k. Finlandës. Shih gjithashtu Julin k. Estonisë*, nr. 16563/08 18656/10 40841/08, §§ 168-169, 29.05.2012.

dhe për sa i përket qasjes në një gjykatë në lidhje me procedurat e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor¹⁶⁴. Megjithatë, duhet kujtuar që në lidhje me ankimin në një gjykatë më të lartë, e drejta e qasjes gjen zbatim vetëm në kushte të caktuara të analizuara më lart¹⁶⁵.

Megjithëse aspekti penal do trajtohet në veçanti në vijim, dhe në varësi të rrethanave të çështjes qasja e individëve në gjykatë për një çështje penale trajtohet shpesh edhe në kuadrin e aspektit procedural të neneve të tjera të Konventës¹⁶⁶, në këtë fazë të analizës mund të thuhet se, në çështjet penale, e drejta e qasjes në gjykatë nënkupton mundësinë që personi i akuzuar t'i paraqesë pretendimet që ka përpara një gjykate kompetente dhe që vendimi në lidhje me këto pretendime, të merret, i bazuar në prova dhe në ligj, nga një gjykatë që plotëson garancitë e nenit 6¹⁶⁷.

Në lidhje me çështjet civile problemi i qasjes në gjykatë shpalolet më qartë për shkak të rolit primar të individit si ankues në çështje me karakter të tillë. Në këto çështje thelbi i së drejtës së qasjes në një gjykatë përfshin paraqitjen e pretendimeve në lidhje me një mosmarrëveshje në një gjykatë kompetente për të shqyrtuar elementët faktikë dhe juridikë të mosmarrëveshjes dhe për ta zgjidhur atë në mënyrë të detyrueshme për palët¹⁶⁸. Gjykata ka lënë të kuptohet se një gjykatë që nuk mund të japë vendime të detyrueshme për palët nuk mund të konsiderohet gjykatë në kuptimin material të termit sepse nuk do kishte kuptim vetë roli i saj¹⁶⁹.

Është gjithmonë jurisprudenca e Gjykatës ajo që, me anë të analizës të çështjeve konkrete, ka sqaruar kuptimin e nocionit të qasjes duke

¹⁶⁴ Shih *Ganci k. Italisë*, i lartpërmendur, §§ 20-26.

¹⁶⁵ Shih seksionin III, C të kësaj Pjese dhe referencën në vendimin *Delcourt k. Belgjikës*.

¹⁶⁶ Shih si shembull të fundit vendimin *Pulfer k. Shqipërisë*.

¹⁶⁷ Shih *Deweer k. Belgjikës*, 27.02.1980, nr. 6903/75, § 48, *Multiplex k. Kroacisë*, 10.07.2003, nr. 58112/00, § 45, *Ganci k. Italisë*, 30.10.2003, nr. 41576/98, § 24.

¹⁶⁸ Shih *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyre k. Belgjikës*, nr. 6878/75 dhe 7235/75, § 51, 23.06.1981.

¹⁶⁹ Shih *Sramek k. Austrisë*, nr. 8790/79, § 36, 22.10.1984 dhe *Chypre k. Turqie* [GC], nr. 25781/94, § 233, CEDH 2001-IK.

vendosur rast pas rasti nëse ka pasur shkelje të kësaj të drejte dhe duke na ofruar në këtë mënyrë udhëzues për interpretimin dhe zbatimin e këtij aspekti të nenit 6 në praktikë. Gjykata ka theksuar që në fazat e hershme të veprimtarisë së vet dhe e ka përsëritur vazhdimisht se ushtrimi efektiv i së drejtës për qasje në gjykatë mund të lidhet me ndihmën juridike në një çështje të caktuar¹⁷⁰. Mundësia për t'iu drejtuar gjykatës nuk duhet penguar me anë të, për shembull, ndalimit të një të dënuari me heqje lirie që të shkëmbejë korrespondencë me avokatin e tij në kuadrin e përpjekjeve të tij për të paraqitur një padi civile¹⁷¹ ose me anë të ndalimit të mundësisë për të burgosurit që të komunikojnë lirshëm me avokatët¹⁷².

Jurisprudenca e Gjykatës ndër vite, në çështje të njëpasnjëshme, jo vetëm e ka qartësuar këtë nocion themelor të nenit 6, por vihet re se është udhëhequr nga një prirje e përgjithshme për ta zgjeruar nocionin e qasjes në gjykatë. Megjithatë ajo ka qenë e kujdesshme, dhe ka pranuar mundësinë e kufizimeve ndaj kësaj të drejte.

Përpara se të analizojmë kufizimet ndaj të drejtës së qasjes në gjykata, duhet të kujtojmë atë çka theksuam më lart se dispozita e nenit 6 të Konventës nuk i detyron shtetet që të parashikojnë dhe të ngrenë një procedurë apeli ose kasacioni në legjisllacionin e brendshëm¹⁷³. Megjithatë, Gjykata e ka thënë qartë që në rastet kur procedura të tilla ekzistojnë qasja në to nuk mund të kufizohet në një mënyrë jo-proporcionale¹⁷⁴ ose diskriminuese¹⁷⁵.

¹⁷⁰ Shih vendimin, *Airey k. Irlandës*, nr. 6289/73, § 26, 9.10.1979, *Glaser k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32346/96, § 99, 12.06.2007, *Bakan k. Turqisë*, nr. 50939/99, § 66.

¹⁷¹ Shih vendimin e Gjykatës të 25.03.1983 në lidhje me çështjen *Silver k. Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A Nr.67; shih në 13 European Human Rights Reports 582.

¹⁷² Shih vendimin *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28.06.1984, nr. 7819/77 dhe 7878/77, § 111-113.

¹⁷³ Shih *Delcourt k. Belgjikës*, nr. 2689/65, § 25, 17.01.1970, *Kudla k. Polonisë*, nr. 30210/96, § 122, 26.10.2000, *Hoffmann k. Gjermanisë*, nr. 34045/96, § 65, 11.10.2001. Por shih nga ana tjetër nenin 2 të Protokollit nr. 7 të, GJEDNJ, lidhur me të drejtën e apelit në çështjet penale.

¹⁷⁴ Shih *Poitrimol k. Francës*, nr. 14032/88, § 35-38, 23.11.1993, *Garcia Manibardo k. Spanjës*, nr. 38695 / 97, § 44-45, 15.2.2000.

¹⁷⁵ Shih paragrafin 66 të vendimit *Hoffman* të sapo përmendur më lart.

b. kufizimet ndaj qasjes në gjykatë

Duke qenë se Shtetet anëtare përfaqësojnë sisteme ligjore dhe gjyqësore me histori dhe karakteristika të ndryshme, është më se e pranueshme që atyre t'u njihet një hapësirë e madhe vlerësimi për të rregulluar funksionimin e sistemeve të tyre të administrimit të drejtësisë. Kjo sepse vetë e drejta për t'iu drejtuar një gjykate kërkon në vetvete ndërhyrjen e Shtetit, i cili duhet të marrë masat përkatëse legislative, institucionale dhe procedurale¹⁷⁶. Në vendimin e lartpërmendur *Golder*, duke pranuar qëndrimet e Komisionit dhe të Qeverisë Britanike, Gjykata ka pohuar se qasja në gjykata, pavarësisht se është një parim themelor në sistemin tërësor të Konventës dhe të shtetit të së drejtës, nuk është absolut dhe mund të kufizohet për interesa legjitime¹⁷⁷. Megjithëse neni 6 nuk parashikon në dispozitën e tij kufizime mbi qasjen, Gjykata në atë vendim pranoi teorinë e “kufizimeve të nënkuptuara” në lidhje me këtë të drejtë¹⁷⁸, duke pasur parasysh edhe faktin që Shtetet gëzojnë gjithsesi një hapësirë vlerësimi në organizimin institucional dhe procedural të pushtetit të tyre gjyqësor. Karakteri jo absolut i nocionit të qasjes në gjykatë shtrihet qoftë për sa i përket çështjeve me karakter civil, qoftë atyre me karakter penal¹⁷⁹.

Në çështjen *Golder* duket se Gjykata ngurroi të përpunonte direktiva të përgjithshme me vlerë udhërrëfyese në lidhje me interpretimin e nocionit të kufizimeve të nënkuptuara ndaj qasjes në gjykatë. Megjithatë, në vijim, ajo jo vetëm e ka ripohuar këtë doktrinë, por e ka parë të nevojshme ta qartësojë atë duke saktësuar se Shtetet në ushtrimin e hapësirës së tyre të vlerësimit, me plot të drejtë mund të vënë kufizime ndaj të drejtës së individëve për t'iu drejtuar gjykatave të tyre por me kusht që këto kufizime:

¹⁷⁶ Shih vendimin *Jones dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34356/06 dhe 40528/06, § 186, 14.01.2014.

¹⁷⁷ Shih paragrafin 38 të vendimin *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur si dhe *Stanev k. Bullgarisë* [D.H.M.], § 230.

¹⁷⁸ Shih paragrafët 37 e vijues të vendimin *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur.

¹⁷⁹ Shih *Deweere k. Belgjikës*, i lartpërmendur § 49. Shih gjithashtu në të njëjtin drejtim, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, i lartpërmendur, § 53.

- a) të kenë një qëllim të ligjshëm;
- b) të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit; dhe
- c) të mos mund të veprojnë në mënyrë të tillë që të cenojnë vetë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

Megjithatë, Gjykata ka theksuar se i takon vetë asaj që të kontrollojë në fund nëse këto kushte janë respektuar. Këto parime janë qartësuar në vendimin *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*,¹⁸⁰ dhe njihen përgjithësisht në doktrinë si parimet *Ashingdane*. Ato janë konfirmuar dhe konsoliduar nga jurisprudenca e mëvonshme në lidhje me qasjen në gjykatë¹⁸¹. Kjo jurisprudencë ka ofruar interpretime shumë më të detajuara në raste specifike, duke bërë shumë më të qartë veprimin e këtyre parimeve në rrethana specifike. Për të analizuar kufizimet që mund të bëhen ndaj qasjes në gjykatë, dhe analizës së tyre sipas parimeve *Ashingdane*, po i kategorizojmë në vijim në dy grupe, sipas kufizimeve që lidhem me cilësinë ose veprimet e ankuesve (i), dhe kufizime që lidhem me cilësinë e personave ndaj të cilëve drejtohet ankimi (ii)¹⁸².

i. Locus standi aktiv

Në këtë kategori futen ato kufizime, të natyrës procedurale, që lidhen me karakteristika të vetat ose të veprimeve të ankuesit, përfshirë edhe objektin e ankesës. Kufizime të tilla, në parim, kanë për qëllim të sigurojnë një mirë-administrim të drejtësisë. Sidomos ato që kanë të bëjnë me afatet, reflektojnë në një masë të madhe parimin e sigurisë juridike. Këtë parim e reflektojnë edhe rregullat që kanë të bëjnë me juridiksionin e gjykatave, rregulla që ndjekin

¹⁸⁰ Shih vendimin e Gjykatës *Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8225/78, § 57, 28.05.1985.

¹⁸¹ Shih gjithashtu *Fayed k. Mbretërisë së Bashkuar*, 21.09.1994, Seria A, nr. 294 – B, *Tinnelly & Sons Ltd dhe të tjerë dhe McElduff dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 72, 10.07.1998, *Khalfaoui k. Francës*, nr. 34791/97, § 35-36, 14.12.1999, *Zwiazek Nauczycielstwa Polskiego k. Polonisë*, nr. 42049/98, § 28, 21.09.2004

¹⁸² Termi ankim përdoret në një kuptim të gjerë, duke përfshirë si paditë civile apo administrative ashtu edhe kallëzimet ose paditë penale.

edhe qëllime të tjera të mirë-administrimit të drejtësisë, si qartësia dhe qëndrueshmëria e jurisprudencës apo kohëzgjatja e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Të gjithë operatorët ligjorë, në parim, duhet të jenë të interesuar që këto rregulla të zbatohen si duhet¹⁸³. Por duhet që kuadri ligjor të jetë i logjikshëm dhe i qëndrueshëm, i parashikueshëm në kushte normale dhe të sigurojë një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe të drejtës së individëve për t'iu drejtuar gjykatave¹⁸⁴. Problemet shfaqen kur zbatimi i këtyre rregullave ose bëhet në mënyrë arbitrare, ose ato janë të tilla sa prekin thelbin e së drejtës për qasje në gjykatë, duke mos pasur ose humbur qëllimin e sigurisë juridike, të mirë-administrimit të drejtësisë dhe bëhen pengesë ndaj vetë thelbit të nocionit të qasjes në gjykatë.¹⁸⁵

a. Kush?

Kufizimi më evident në lidhje me të drejtën për tu ankuar në gjykata është ai që ka të bëjë me cilësinë juridike të vetë ankuesit. Gjykata ka vendosur, në një mori situatash specifike, që e drejta për t'iu drejtuar gjykatës ka qenë shkelur, duke analizuar me kujdes pikërisht rrethanat e veçanta të këtyre rasteve dhe duke i analizuar ato në mënyrë të kujdesshme.

Kështu për shembull Gjykata ka theksuar se mohimi ose vështirësimi i së drejtës të të burgosurve për t'iu drejtuar gjykatave të brendshme për shpifje ose për plagosje në burg, përbën shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës¹⁸⁶. Ajo ka analizuar në detaje të drejtën

¹⁸³ Shih problemin e parashkrimit dhe të rihapjes së procedurës në çështjet penale vendimin *Xheraj k. Shqipërisë* ndërsa në çështjet civile *Driza k. Shqipërisë, Magomedov dhe të tjerët k. Rusisë*, nr. 33636/09 dhe 34493/09 dhe të tjerët, § 87, GJEDNJ, 28 Mar. 2017,

¹⁸⁴ *Shih De Geoufre de la Pradelle k. Francës*, nr. 12964/87, § 34, GJEDNJ, 16.12.1992 dhe *Mačirević k. Serbisë*, nr. 30671/08, § 48, GJEDNJ, 11.02.2014.

¹⁸⁵ *Shih Sharxhi dhe të tjerët k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, *Efstathiou dhe të tjerët k. Greqisë*, nr. 36998/02, § 24, GJEDNJ, 27.07.2006.

¹⁸⁶ Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar dhe Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur. Shih në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

për t'iu drejtuar gjykatave nga ana e nëpunësve publik¹⁸⁷, përfshirë këtu edhe nga vetë gjyqtarët¹⁸⁸, dhe siç e thamë më lart ka shënuar një evolucion madhor në këtë aspekt të jurisprudencës. Gjykata ka analizuar me kujdes situatën në një çështje ku babait i ishte kufizuar mundësia për t'iu drejtuar gjykatave gjermane në lidhje me të drejtën për të takuar fëmijët. Ndërsa Dhoma vendosi se kufizimi i kësaj të drejte në procedurën gjermane shkelte nenin 6 të Konventës, në Dhomën e Madhe, në mënyrë interesante, zgjodhi që ta sanksiononte këtë praktikë si shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 8 të Konventës¹⁸⁹, që kishin të bënin me kufizimin e mundësisë së një babai për t'iu drejtuar gjykatave. Gjykata ka pranuar se nuk kishte shkelje në një rast kur deputetit i ishte mohuar e drejta të kërkonte vazhdimin e procedimit penal ndaj tij për shkak se ai vazhdonte të gëzonte imunitet parlamentar, nga i cili mund të hiqte dorë¹⁹⁰. Në vijim, Gjykata ka qenë e mendimit se, përjashtimisht, e drejta për qasje në gjykatë mund të kërkojë që shteti t'i njohë të drejtën një personi të sëmurë mendërisht që të kundërshtojë vetë në gjykatë mungesën e zotësisë së tij juridike¹⁹¹. Por ajo nuk ka gjetur shkelje kur kërkohej një autorizim gjyqësor për të bërë padi në gjykatë, në rastin e një paditësi të bezdisshëm dhe problematik¹⁹². Gjykata ka gjetur shkelje në një rast kur një inxhinier nuk mund të ngrinte një padi për të marrë shpërblimin e tij sepse legjislacioni grek parashikonte që padinë me objekt të tillë duhet ta bënte organizata profesionale në emër dhe llogari

¹⁸⁷ Në lidhje me nëpunësit publikë shih vendimin e Gjykatës të 30.10.2001 në lidhje me çështjen *Devlin k. Mbretërisë së Bashkuar* që kishte të bënte me një nëpunës publik dhe evolucionin e shënuar sidomos me çështjen Pellegrin k. Francës, të lartpërmendur. Shih në kontekstin shqiptar në lidhje me këtë problem *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29.09.2009.

¹⁸⁸ Shih *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, 9.1.2013, *Mitrinovski k. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, 30.4.2015, *Baka k. Hungarisë*, [DH.M.], 23.6.2016, § 121; *Jakfovski dhe Trifimovski k. ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, 7.1.2016, *Paluda k. Sllovakisë*, 23.5.2017, § 45, dhe në kontekstin shqiptar, *Mishgjoni k. Shqipërisë*, 7.12.2010.

¹⁸⁹ Shih përkatësisht vendimet 11.10.2001 në lidhje me çështjet *Sahin k. Gjermanisë*, *Sommerfeld k. Gjermanisë* dhe *Hoffman k. Gjermanisë*, nr. 30943/96, nr. 31871/96 dhe nr. 34045/96, në Dhomë, dhe pastaj zgjidhjen që i jep Dhoma e Madhe me vendimin e 8.7.2003 në lidhje me çështjen *Sommerfeld k. Gjermanisë*, nr. 31871/96.

¹⁹⁰ Shih *Kart k. Turqisë*, nr. 8917/05, GJEDNJ, [DH.M.], 3.12.2009.

¹⁹¹ Shih *Stanev k. Bullgarisë* [DH.M.],

¹⁹² Shih *H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 11559/85, vendim i Komisionit i 2.12.1985.

të inxhinierit¹⁹³. Pamundësia e aksioneres së vetme dhe drejtores ekzekutive të një shoqërie tregtare për të kundërshtuar procedurat e likuidimit të shoqërisë së tij sepse kjo e drejtë i njihet vetëm likuidatorit¹⁹⁴. Por nga ana tjetër, kufizimi i aksionerëve individualë të një shoqërie tregtare të shtetëzuar për t'iu drejtuar gjykatave, me argumentin se ata duhet të zgjidhnin përfaqësues të të gjithë aksionarëve që të dilnin si palë me qëllim që të shmangej përsëritja e padive, është pranuar nga Gjykata si jo shkelje e të drejtës për qasje¹⁹⁵. Në lidhje me çështjet penale Gjykata ka vendosur se pamundësia për të paraqitur një rekurs në Gjykatën e Kasacionit përveçse nëse personi iu dorëzohej autoriteteve, përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës¹⁹⁶.

Zhvillime interesante ka pasur edhe në lidhje me personat juridikë. Kështu për shembull, një kishë ishte penguar të fillonte procedurat ligjore për të rifituar pronat e saj me arsyetimin se ajo konsiderohej se nuk kishte personalitet juridik¹⁹⁷. Gjithashtu, edhe një bankë që kalonte në likuidim nuk kishte të drejtë të ankohej mbi procedurat e likuidimit pasi ajo ishte çregjistruar nga regjistri tregtar¹⁹⁸. Në një situatë të ngjashme, një padi civile mund të bëhej vetëm nga një subjekt tjetër pavarësisht nga interesi i drejtpërdrejtë i kërkuesit në lidhje me këto procedura¹⁹⁹.

β. Kur?

¹⁹³ *Philis k. Greqisë*, nr. 12750/87 13780/88 14003/88, 27.08.1991. Shih në Seria A, nr. 209; shih në 13 European Human Rights Reports 741.

¹⁹⁴ *Shih Arma k. Francës*, nr. 23241/04, 08.03.2007.

¹⁹⁵ *Shih Lithgow dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*. Por shih gjithashtu *Philis*, të sapo përmendur më lart.

¹⁹⁶ *Shih Papon k. Francës*, nr. 54210/00, 25.07.2002. Shih në gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

¹⁹⁷ *Shih vendimin e Gjykatës të 16.09.1997 në lidhje me çështjen Canea Catholic Church k. Greqisë*. Shih gjithashtu vendimin në lidhje me çështjen *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerë k. Rumanisë*, të lartpërmendur.

¹⁹⁸ *Shih Capital Bank AD k. Bullgarisë*, nr. 49429/99, 24.11.2005.

¹⁹⁹ *Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1994 në lidhje me çështjen Holy Monasteries k. Greqisë*, Seria A, nr. 301 - A; shih në 20 European Human Rights Reports 1. Shih gjithashtu *Philis k. Greqisë*, i lartpërmendur.

Në këtë kategori mund të përfshihen kufizimet tipike procedurale si ato që kanë të bëjnë me afatet ligjore të parashkrimit të padisë²⁰⁰ ose të skadimit të afateve për të ushtruar të drejtën e apelit në një gjykatë më të lartë²⁰¹. Gjykata e ka thënë në mënyrë të përsëritur se Shtetet kanë të drejtë të parashikojnë kufizime të tilla dhe se ju takon autoriteteve kombëtare, dhe veçanërisht gjykatave, që të interpretojnë të drejtën e brendshme dhe se nëse nuk konstaton se ka pasur arbitraritet, Gjykata nuk e zëvendëson interpretimin e tyre me atë të vetin. Ajo ka pranuar se ky kriter gjen zbatim sidomos në lidhje me interpretimin nga gjykatat e brendshme të rregullave procedurale të tilla si afatet për bërjen e ankimeve ose paraqitjen e dokumenteve²⁰². Megjithatë këto rregulla procedurale në lidhje me të drejtën e qasjes në gjykatë duhen interpretuar në mënyrë koherente dhe me kujdes. Kështu për shembull në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë*, Gjykata konstatoi se mospranimi i ankimit kushtetues të kërkuesit me argumentin e skadimit të afatit të ankimit, nuk ishte në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe sidomos, duke hedhur poshtë si të papranueshëm ankimin *de plano*, paneli i Gjykatës Kushtetuese nuk mbajti parasysh datën se kur kërkuesi mori dijani për dënimin e tij në mungesë²⁰³. Për më tepër, në këtë çështje, Gjykata vuri re se interpretimi i panelit të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, në mungesë të ndonjë rregulli tjetër procedural në legjislacionin shqiptar, nuk ndiqte kriteret e nenit 144 § 3 të Kodit të Procedurës Penale që zbatohet në raste të tilla²⁰⁴. Kjo do të thotë që në interpretimin e një afati ankimor ose të rregullave të tjera me karakter procedural gjykatat e brendshme nuk duhet të jenë strikt, tepër formaliste dhe t'i interpretojnë

²⁰⁰ Shih *Stubbings k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22083/93 dhe 22095/93, § 51 22.10.1996, Stagno k. Belgjikës, nr. 1062/07, § 26, GJEDNJ, 7.06.2009 *Howald Moor dhe të tjerët k. Zvicrës*, nr. 52067/10 dhe 41072/11, § 72-, GJEDNJ, 11.03.2014.

²⁰¹ Shih *Vacher k. Francës*, nr. 20368/92, § 22 e vijues, 17.12.1996, *Jodko k. Lituanisë*, nr. 39350/98, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 1.09.1999. Shih gjithashtu *Kulikowski k. Poloni*, nr. 18353/03, § 60 e vijues, GJEDNJ, 19.05.2009.

²⁰² Shih *Miragall Escolano dhe të tjerët k. Spanjës*, nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, § 33, GJEDNJ, 2000-I.

²⁰³ Shih *Shkalla k. Shqipërisë*, nr. 26866/05, 10.05.2011. Shih për një situatë të ngjashme *Ivanova dhe Ivashova k. Rusisë*, nr. 797/14 dhe 67755/14, §§ 44 e vijues, GJEDNJ, 26.01.2017.

²⁰⁴ Shih paragrafët 51 dhe 52 të vendimit Shkalla.

ato në mënyrë automatike²⁰⁵. Autoritetet e brendshme duhet të mbajnë parasysh mundësinë objektive të ankuesit për të ushtruar të drejtën e ankimit. Ndryshe ka gjasa që një interpretim i tillë të përbëjë shkelje të kërkesave të nenit 6 § 1²⁰⁶.

γ. Për çfarë?

Një tjetër kufizim është ai që ka të bëjë me objektin e padive përpara gjykatave në bazë të legjislacionit të brendshëm. Natyrisht që në secilin prej juridiksioneve kombëtare ka shumë padi të cilat nuk pranohen sepse objekti i padisë nuk parashikohet nga ligji vendas. Duhet thënë qartë se neni 6 i Konventës nuk krijon të drejta substanciale specifike, si për shembull përfitimin e një dëmshpërblimi ose kthimin apo kompensimin e pronës. Për shembull, një e drejtë e pretenduar përpara një gjykate vendase duhet të ketë një bazë në legjislacionin e brendshëm dhe pala paditëse duhet të ketë interes personal nga rezultati i procedurës. Kështu për shembull, në vendimin *Al-Adsani*²⁰⁷ Gjykata është shprehur se neni 6 § 1 i Konventës nuk mund të interpretohet sikur krijon një të drejtë materiale me karakter civil që nuk ka asnjë bazë në të drejtën e brendshme²⁰⁸. Megjithatë kur një e drejtë materiale është njohur, si ajo e kthim kompensimit të pronave për shembull, por nuk është e mundur të bëhet ankim në gjykata në lidhje me pretendimet përkatëse, atëherë Gjykata ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës²⁰⁹.

²⁰⁵ Shih *Dattel k. Luksemburgut* [nr. 2], nr. 18522/06, § 36-47, GJEDNJ, 30.07.2009, *The Erabtidre A.S.B.L. Belgjikës*, nr. 49230/07, § 38 e vijues-, GJEDNJ, 24.02.2009, *Rekkos dhe Davourlis k. Greqisë*, nr. 1234/05, GJEDNJ, 15.01.2009, *Roumeliotis k. Greqisë*, nr. 53361/07, § 19-30, GJEDNJ, 15.10.2009, *Dimopoulos k. Greqisë*, nr. 34198/07, § 17-23, GJEDNJ, 7.01.2010, *Nikolaos Kopsidis k. Greqisë*, nr. 2920/08, §§ 18-27, GJEDNJ, 18.03.2010, *Reichman k. Francës*, nr. 50147/11, § 38, GJEDNJ, 12.07.2016, *Marc Brauer k. Gjermanisë*, nr. 24062/13, § 43, GJEDNJ, 1.09.2016.

²⁰⁶ *Yegilkaya k. Turqisë*, nr. 47157/10, § 39, vendimi për pranueshmërinë, GJEDNJ, 26.05.2015 ose *Sefer Yilmaz dhe Meryem Yilmaz k. Turqisë*, nr. 611/12, §§ 64 e vijues, GJEDNJ, 17.11.2015.

²⁰⁷ *Al-Adsani k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur.

²⁰⁸ Për më gjerë në lidhje me këtë aspekt shih Pjesa I, Seksioni III, A. Shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, vendimin *Ali Telhai k. Shqipërisë*, i lartpërmendur.

²⁰⁹ Shih vendimin e Gjykatës të 22.05.1998 në lidhje me çështjen *Vasilescu k. Rumanisë*; shih në Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

Kur sistemi ligjor nuk lejon kontroll gjyqësor ndaj diskrecionaritetit të pushtetit ekzekutiv në akordimin e punëve publike për arsye të sigurisë kombëtare, ky sistem përbën shkelje të nenit 6 § 1²¹⁰. Gjithashtu është gjetur shkelje kur një person nuk ka pasur mundësi për të kundërshtuar një gjobë të vënë për drejtim automjeti me shpejtësi të madhe²¹¹.

δ. Si ose në çfarë kushtesh?

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se rregullat që përcaktojnë kompetenca territoriale ose materiale të gjykatave të brendshme²¹² dhe kushtet e pranimit ose të mospranimit të padive para tyre²¹³, përcaktohen nga e drejta e brendshme.

Ajo ka konsideruar se nuk është shkelje e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës fakti që paditëseve t'u kërkohet të paguajnë në formë garancie shpenzimet e një personi që dëshiron të apelojë një vendim gjyqësor²¹⁴. Megjithatë, kur shpenzimet gjyqësore për të bërë një padi janë tepër të larta, ose në parim ose në kushtet specifike të një ankuesi, atëherë Gjykata mund të gjejë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.²¹⁵ Kështu për shembull, është gjetur shkelje në një rast

²¹⁰ Shih *Tinnelly & Sons Ltd dhe të tjerë dhe McElduff dhe të tjerë k. Royaume-Uni*, nr. 20390/92 dhe 21322/92, §§ 72-79, 10.7.1998. Shih edhe *Julin k. Estonisë*, i lartpërmendur. Shih në lidhje me të njëjtin problem vendimet dhe debatet në Gjykatën Supreme Britanike, që nga *Anisminic Ltd k. Foreign Compensation Commission - House Of Lords* 17.12.1968 deri tek *R (Privacy International) k. Investigatory Powers Tribunal* [2019] UKSC 22, 15.05.2019.

²¹¹ Vendim i 21.05.2002 në lidhje me çështjen *Peltier k. Francës*. Shih gjithashtu *L.Bianku, O.Kumbaro*, 2017, e lartpërmendur.

²¹² Shih *MPP Golub k. Ukrainës*, nr. 6778/05, Vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 18.10.2005, *Zylkoo k. Rusisë*, nr. 5613/04, § 23-29, GJEDNJ, 2011.

²¹³ *Annoni di Gussola dhe të tjerët k. Francës*, nr. 31819/96 dhe 33293/96, 48 § e vijues, GJEDNJ, 14.11.2000, *Momçilloviç k. Kroaci*, nr. 11239/11 § 45 e vijues, GJEDNJ, 26.03.2015, *Papaioannou k. Greqisë*, nr. 18880/15, § 39, GJEDNJ, 2.06.2016, - mbi pranueshmërinë apel i amparo për mungesën e demonstrimit të rëndësia e veçantë kushtetuese e kërkuar, *Arribas Anton k. Spanjës*, nr. 16563/11, GJEDNJ, 20.01.2015.

²¹⁴ Shih vendimin e Gjykatës të 13.07.1995 në lidhje me çështjen *Tolstoy Miloslavky k. Mbretërisë së Bashkuar, Seria A*, nr. 323, § 67.

²¹⁵ Vendim i 19.07.2001 në lidhje me çështjen *Kreuz k. Polonisë*, § 58 e vijues. Shih gjithashtu *L.Bianku, O.Kumbaro*, 2017, e lartpërmendur. Shih gjithashtu *Jedamski dhe Jedamska k. Poland*, nr. 73547/01, § 66, 26.07.2005, *Weissman dhe të tjerë k. Romania*, nr. 63945/00, §§ 38-40, GJEDNJ, 2006-VII (extracts); *Kniat k. Poland*, nr. 71731/01, § 46, 26.07.2005, në lidhje me ankimin në apel, *Urbanek k. Austrisë*, nr. 35123/05, § 57 e vijues, GJEDNJ, 9.12.2010, *Chatellier k. Francës*, nr. 34658/07, GJEDNJ, 31.03.2011.

kur një gruaje e cila ishte e varfër, iu refuzua ndihma ligjore për të filluar procedurat e divorcit nga i shoqi²¹⁶.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjambat, shuma jo proporcionale e të cilave mund të përbëjë shkelje e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës²¹⁷. Gjykata ka pranuar se pagimi paraprak i gjobave ose i detyrimeve tatimore mund të parashikohen si kushte për pranimin e padive që lidhen me ligjshmërinë e gjobave ose të detyrimeve përkatëse. Kjo bëhet me qëllim legjitim për të parandaluar rritjen e numrit të padive para gjykatave dhe për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë, e cila nuk është në vetvete në kundërshtim me të drejtën e qasjes së një gjykate. Megjithatë, shuma e këtyre gjobave është një faktor i rëndësishëm për t'u marrë parasysh për të vlerësuar efektivitetin e së drejtës në fjalë²¹⁸, sepse nëse shuma është tepër e lartë, duke pasur parasysh edhe karakteristikat ose të ardhurat apo pasuritë e ankuesit, padia përpara një gjykate mund të bëhet objektivisht e pamundur.

Në një çështje shumë të rëndësishme kundër Shqipërisë²¹⁹, Gjykata Kushtetuese nuk ishte në gjendje të arrinte një vendim mbi ankimin kushtetues të ankuesit, për shkak të barazisë në vota të gjyqtarëve, barazi që vinte për shkak të përjashtimit të dy prej tyre. Gjykata arriti në përfundimin se rregullimi i nenit 74 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese nuk i shërben interesave të sigurisë juridike dhe i privonte një ankuesi një të drejtë efektive që ankesa e tij kushtetuese të vendosej përfundimisht. Në këtë mënyrë ai kufizonte thelbin e

²¹⁶ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1979 në lidhje me çështjen *Airey k. Irlandës*, Seria A, nr. 32; shih në 2 European Human Rights Reports 305; Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur. Ndihma ligjore është e kërkuar që të akordohet në raste kur personi vetë nuk ka mjete monetare që ta mbrojnë çështjen e tij siç duhet, pasur parasysh që çështja ka një mundësi të mirë suksesi. Nuk është e qartë nëse mosdhënia e një ndihme ligjore për çështjet civile do të përbëjë në mënyrë të menjëhershme shkelje të nenit 6. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 9.10.1997 në lidhje me çështjen *Andronicou dhe Constantinou k. Qipros*, në 25 European Human Rights Reports 491. Në lidhje me çështjet penale shih në vijim trajtimin e nenit 6 § 3 (c) të Konventës.

²¹⁷ Shih *Schneider k. Francës*, nr. 49852/06, Vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 30.06.2009.

²¹⁸ Shih *Sace Elektrik Ticaret ve Sanayi A.S. k. Turqisë*, nr. 20577/05, § 27, GJEDNJ, 22.10.2013, Shishkov k. Rusisë, nr. 26746/05, GJEDNJ, 20.02.2014.

²¹⁹ Shih *Marini k. Shqipërisë*, nr. 3738/02, §§ 109-123, GJEDNJ, 18.12.2007.

së drejtës së kërkuesit për qasje në gjykatë. Në të njëjtën kategori mund të futet edhe një çështje ku gjykatat e brendshme ia kalonin juridiksionin mbi një padi njëra-tjetrës²²⁰, ose e transferonin në një gjykatë që haptazi nuk kishte juridiksion²²¹, duke i lënë kërkuesit në një situatë vakumi ligjor duke mos pasur ku të ankohen.

Në përfundim të kësaj analize, duhet theksuar gjithsesi se, edhe kur neni 6 është i pazbatueshëm ose nuk është shkelur, mund të hyjnë në lojë dispozita të tjera të Konventës, duke ofruar të drejta të krahasueshme me atë të qasjes në një gjykatë, të tilla si garancitë procedurale që u ofrohen viktimave të veprave penale nën kuadrin e detyrimit pozitiv të shtetit në bazë të nenit 2 për të mbrojtur jetën²²² apo për të parandaluar vdekjen²²³, në bazë të nenit 3, për të mbrojtur dhe për të hetuar keqtrajtimin²²⁴, ose për të garantuar të drejtën për një mjet efektiv, i cili mohohet në të drejtën e brendshme për një të drejtë që garantohej nga neni 8 i Konventës²²⁵.

ii. *Locus standi pasiv*

Me të njëjtën logjikë, mund të vendosen kufizime ndaj të drejtës për qasje në gjykata edhe në funksion të cilësive të palës së paditur në procedurat e brendshme. Megjithatë, duhet kujtuar se analiza edhe në këto raste kufizimesh duhet bërë nën dritën e parimeve *Ashingdane*, të përshkruara më sipër, pra që kufizimet ndaj të drejtës për qasje në gjykatë duhet të parashikohen me ligj, të ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale me qëllimin e ndjekur. Tre janë kategoritë kryesore që mund të identifikohen në këtë drejtim.

²²⁰ Shih *Bezmyannaya k. Rusicë*

²²¹ Shih *Zylkov k. Rusicë*, §§23-29

²²² Shih *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DH.M.], nr. 87/1997/871/1083, §§ 115-122, GJEDNJ, 28.10.1998. Shih edhe në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

²²³ Shih *Paul dhe Audrey Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 69-87.

²²⁴ *Z dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*.

²²⁵ *Hatton k. Mbretërisë së Bashkuar* [DH.M.], §§116-130.

a. Imunitetet juridiksionale të shteteve dhe agjentëve të tyre

Imuniteti i Shteteve nga juridiksioni penal, civil ose administrativ i gjykatave të shteteve të tjera është një arsye për të kufizuar mundësinë e padive kundër tyre. Imunitetet e shteteve janë një institucion i vjetër dhe reflektojnë parimin e barazisë sovrane të shteteve në të drejtën ndërkombëtare²²⁶. Ai synon të promovojë marrëdhëniet e mira midis shteteve nëpërmjet respektimit të sovranitetit nga një shtet tjetër²²⁷ edhe për sa i përket analizës që bën nën kuadrin e nenit 6 të Konventës, Gjykata i referohet ndarjes tradicionale që bën e drejta ndërkombëtare klasike në *acti jure imperii* dhe *acti jure gestionis*²²⁸.

Në rastin e *acti iure imperii*, pra akteve që hyjnë në tagrat e ushtrimit të pushtetit publik nga ana e shtetit, Gjykata i referohet plotësisht logjikës të së drejtës ndërkombëtare, dëshmi e një ndryshimi të madh në të drejtën ndërkombëtare dhe konsiderojnë se zbatimi i imunitetit nga juridiksioni²²⁹ dhe, *a fortiori*, imunitetin e ekzekutimit²³⁰ nuk është jo-proporcional, edhe nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me një *jus cogens* si ndalim i torturës²³¹. Në këtë rast Gjykata nuk i pranoi të ashtuquajturat teori të hierarkisë normative të përpunuara nga pakica e gjyqtarëve në atë çështje²³². Pavarësisht nga kritikrat dhe hezitimet në lidhje me këtë qëndrim, përfshirë edhe nga autori i këtij komentari, Gjykata nuk e ka parë

²²⁶ Shih "*State Immunity*", Peter-Tobias Stoll, në Max Planck Encyclopedia of Public International Law, Prill 2011.

²²⁷ Shih *Cudak k. Lituanië*, [DH.M.], nr. 15869/02, §60, GJEDNJ, 23.03.2010.

²²⁸ Për një analizë të plotë shih Matthias Kloth, "*Immunities and the right of access to court under Article 6 of the European Convention on Human Rights*", Brill - Nijhoff, 2010.

²²⁹ Shih *McElhinney k. Irlandës*, nr. 31253/96, [DH.M.] § 38, GJEDNJ, 21.11.2001, *Fogarty k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 37112/97, GJEDNJ, [DH.M.], 21.11.2000, § 34. Shih në L. Bianku, "Jurisprudencia e Gjykatës së Strasburgut", Tiranë 2005.

²³⁰ Shih *Kalogeropoulou dhe të tjerët k. Greqisë*, nr. 59021/00, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 12.12.2002.

²³¹ Shih *Al-Adsani k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DH.M.], nr. 35763/97, § 54, GJEDNJ, 21.11.2001.

²³² Shih mendimin në pakicë të gjyqtarëve Rozakis, Cafisch, Wildhaber, Costa, Cabral Barreto dhe Vajic, me tyre profesorë të shquar të së drejtës ndërkombëtare publike. Shih gjithashtu komentimin tim në lidhje me këtë vendim në L. Bianku, "Jurisprudencia e Gjykatës së Strasburgut", Tiranë 2005.

me vend deri tani të ndryshojë qëndrim mbi këtë pikë²³³. Gjithashtu, Gjykata nuk e ka parë me vend që të pranojë pretendimet për një kompetencë juridiksionale universale në rastet e torturës së ushtruar nga një ish-ministër i brendshëm tunizian²³⁴.

Nga ana tjetër, në lidhje me *acti jure gestionis*, Gjykata, ka mbajtur qëndrimin se zbatimi i imunitetit juridik në fushën e kontratave të punësimit të misioneve diplomatike me shtetas të vendit ku janë akredituar, ishte jo-proporcionale në lidhje me qëllimin e ndjekur dhe përbënte një shkelje të qasja në një gjykatë²³⁵.

β. Imunitetet e organizatave ndërkombëtare

Me të njëjtën logjikë si në lidhje me Shtetet, Gjykata ka pranuar se njohja e imuniteteve të organizatave ndërkombëtare nga juridiksioni gjyqësor përbën një mjet të domosdoshëm për funksionimin e duhur të tyre dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi. Ajo po njësoj ka njohur faktin se njohja e imunitetit nga juridiksioni për organizatat në fjalë është një praktikë afatgjatë e njohur nga e drejta ndërkombëtare, "*rëndësia e së cilës është përforcuar nga prirja për zgjerimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha fushat e shoqërisë bashkëkohore*"²³⁶. Pra, Gjykata njihë ekzistencën e një interesi legjitim në pasjen e imunitetit juridiksional nga organizatat ndërkombëtare. Megjithatë, ajo thekson se përfshirja në një organizatë ndërkombëtare

²³³ Shih *Jones dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34356/06 dhe 40528/06, § 199-215, GJEDNJ, 14.01.2014. Shih gjithashtu nenin 14 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (UNTS 1465: 85), si dhe nenin III të Rezolutës së Institutit të së Drejtës Ndërkombëtare për Imunitetin nga Juridiksioni të Shtetit dhe agjentëve të tij në rast të krimeve ndërkombëtare, seanca e Napolit, Libri Vjetor IDN, 2009.

²³⁴ Shih *Nait-Liman k. Zvicrës*, [DH.M.], nr. 51357/07, 15.03.2018. Megjithatë, për të kuptuar qartë qëndrimin e Gjykatës në këtë pikë shih edhe *Ely Ould Dah k. Francës*, nr. 13113/03, GJEDNJ, 17.03.2009, vendim mbi pranueshmërinë, i cili saktëson se kur plotësohet kriteri i së drejtës së brendshme (nenet 689-1 dhe 689-2 të Kodit të Procedurës Penale franceze, konkretisht prania në territor, atëherë ka juridiksion.

²³⁵ Shih *Cudak k. Lituaniës*, i lartpërmendur, § 60 e vijues, GJEDNJ, 23.03.2010, *Sabeh El Leil k. Francës*, [DH.M.], nr. 34869/05, § 52 e vijues, GJEDNJ, 29.06.2011, *Wallishauser k. Austri*, nr. 156/04, § 68 e vijues, GJEDNJ, 17.07.2012, *Naku k. Lituaniës dhe Suedisë*, nr. 26126/07, 88 e vijues, GJEDNJ, 08.11.2016.

²³⁶ Shih *Waite dhe Kennedy k. Gjermanisë* [DH.M.], nr. 26083/94, GJEDNJ, 18.02.1999, § 63, *Beer dhe Regan k. Gjermanisë* [DH.M.], nr. 28934/95, § 53, GJEDNJ, 18.02.1999.

nuk i zhvesh përfundimisht Shtetet nga çdo përgjegjësi nën kuadrin e Konventës, sepse kjo do ishte në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e saj²³⁷. Prandaj, zgjidhjen përfundimtare, nëse ka apo jo probleme nën këndvështrimin e nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket qasjes në gjykatë, ajo e jep pas një analize konkrete të proporcionalitetit në çdo rast, duke kontrolluar nëse pretendimet e kërkuësve të mund të shqyrtoheshin, për shembull, nga një organ i pavarur juridiksional në gjirin e organizatës ndërkombëtare përkatëse. Pra, sipas Gjykatës, duhet që të ekzistojnë rrugë të tjera të arsyeshme që kërkuësit “të mbrojnë në mënyrë efikase të drejtat e tyre të garantuara nga Konventa”²³⁸. Kështu Gjykata ka vlerësuar se Bordi i Apelit të Agjencisë Evropiane të Hapësirës²³⁹ ose Bordi i Apelit të NATO-s²⁴⁰, ofronin garanci të tilla.

Kjo logjikë e mbrojtjes së ngjashme ka shoqëruar edhe analizën e pajtueshmërisë apo jo të së drejtës së Bashkimit Evropian me sistemin e Konventës. Në këtë marrëdhënie tepër delikate dhe shumë komplekse Gjykata ka mbajtur qëndrimin se e drejta e Bashkimit Evropian prezumohet se ofron një mbrojtje të ngjashme me atë që ofron edhe Konventa në lidhje me të drejtat themelore.²⁴¹ Megjithatë ajo ka theksuar që ky prezumim është i kundërshtueshëm dhe ka preferuar të konfirmojë se, duke pasur parasysh rëndësinë e Konventës si instrument i rendit publik evropian, ajo ruan të drejtën e kontrollit rast pas rasti²⁴² të respektimit të Konventës nga Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, sidomos kur këto ushtrojnë një hapësirë vlerësimi²⁴³.

²³⁷ *Waite dhe Kennedy k. Gjermanisë*, i lartpërmendur, § 67.

²³⁸ *Ibid.*, § 68.

²³⁹ *Ibid.*, § 69. *Shih dhe Beer dhe Regan k. Gjermanisë*, i lartpërmendur § 59.

²⁴⁰ *Shih vendimet mbi pranueshmërinë në çështjet, Gasparini k. Italisë dhe Belgjikës nr. 10750/03, GJEDNJ, 12.05.2009, dhe Chapman k. Belgjikës, nr. 39619/06, 28.03.2013* i cili kishte të bënte me imunitetin juridiksional të NATO të me Bordin e Apelit të NATO-s.

²⁴¹ *Shih Bosfor Hava Yollari Turizëm ve Ticaret Anonim Sirketi k. Irlandës*, [DH.M.], nr. 45036/98, § 155, GJEDNJ, 30.06.2005, *Michaud k. Francës*, nr. 12323/11 § 103, GJEDNJ, 6.12.2012.

²⁴² *Shih Avotins k. Lettonie*, [DH.M.], nr. 17502/07, § 117 e vijues, GJEDNJ, 23.05.2016,

²⁴³ *Shih M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, [DH.M.], nr. 30696/09, § 338-340, GJEDNJ, 21.01.2011. *Shih gjithashtu Michaud k. Francës*, i lartpërmendur, § 103, dhe *Bosphorus Hava Yollari Turizëm ve Ticaret Anonim Sirketi k. Turqisë*, i lartpërmendur, § 152-158.

Megjithatë, duke zbatuar të njëjtin test në lidhje me OKB-në dhe me përfshirjen e personave të dyshuar për lidhje me terrorizmin në të ashtuquajturat “lista të zeza” të miratuara me rezoluta të Këshillit të Sigurimit në bazë të Kreut VII të Kartës së OKB-së, Gjykata ka konstatuar se personat e përfshirë në këto lista nuk kishin mundësi të ankoheshin pranë ndonjë organi të pavarur ndaj masave të sanksionuara nga këto rezoluta. Prandaj, ajo ka gjetur shkelje qoftë të nenit 6²⁴⁴, qoftë të së drejtës për mjet efektiv²⁴⁵. Megjithatë vendime të tjera nxjerrin në pah një tension të qartë në jurisprudencën e Gjykatës në këtë pikë²⁴⁶. Mund të interpretohet se këto dy linja japin mesazhin që operacionet e ruajtjes së paqes përfshihen plotësisht brenda imunitetit të OKB-së si organizatë ndërkombëtare kurse lufta kundër terrorizmit, ose listat e zeza, ndoshta edhe për shkak të një urgjence dhe mundësie kontrolli më të kujdesshëm nuk përfshihen njëjloj²⁴⁷. Gjithsesi mund të shpresohet që zhvillimet të tjera jurisprudenciale do ta sqarojnë këtë tension.

γ. Imuniteti i Kryetarit të Shtetit, imunitetet parlamentare dhe imunitetet e tjera të funksionarëve publikë

Po njësoj, edhe në lidhje me imunitetet e Kryetarëve të Shteteve apo të parlamentarëve Gjykata ka kujtuar se kufizime ndaj të drejtës për qasje në gjykatë mund të vendosen për shkak të asaj që në shtetet anëtare njihet si doktrina e imuniteteve parlamentare dhe kjo nuk përbën problem në parim²⁴⁸. Ajo ka pranuar se kemi të bëjmë me

²⁴⁴ Shih *Al-Dulimi et Montana Management Ink. k. Zvicrës*, GJEDNJ, [DH.M.], 21.06.2016, nr. 5809/08, § 126 e vijues.

²⁴⁵ Shih *Nada k. Zvicrës*, [DH.M.], nr. 10593/08, § 163 e vijues, GJEDNJ, 12.09.2012, ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 13 të marrë së bashku me nenin 8 të Konventës.

²⁴⁶ Shih *Behrami dhe Behrami k. Francës dhe Saramati k. Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë* (dek.) [GC], nos. 71412/01 dhe 78166/01, § 145, 2.05.2007, që kishte të bënte me përgjegjësinë e forcave të KFOR në Kosovë si dhe *Fondacioni Nënat e Srebrenicës dhe të tjerë k. Holandës* (vendim mbi pranueshmërinë), nr. 65542/12, 27.06.2013 që kishte të bënte me përgjegjësinë e trupave holandeze gjatë masakrës së Srebrenicës më 10.07.1995. Shih gjithashtu mendimet në pakicë të gjyqtarëve Pinto de Albuquerque, të cilit i bashkohen gjyqtarët Hajiyev, Pejchal dhe Dedov si dhe mendimin e gjyqtarës Nußberger, në vendimin e lartpërmendur *Al-Dulimi et Montana Management Ink.*

²⁴⁷ Pavarësisht se të dy kategoritë e masave janë marrë në bazë të Kreut VII të Kartës së OKB-së.

²⁴⁸ Shih *A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35373/97, §§ 75-77, GJEDNJ, 2002-X.

një qëllim legjitim në sistemet ligjore të të gjitha shteteve anëtare, që konsiston në “garantimin e shprehjes së lirë të përfaqësuesve të popullit”²⁴⁹ dhe “për të parandaluar që përndjekjet partizane të cenojnë funksionet parlamentare”²⁵⁰. Megjithatë, ajo ka theksuar se do të ishte e papajtueshme me konceptin e shtetit ligjor në një shoqëri demokratike, dhe me vetë qëllimin e nenit 6 § 1, që një Shtet të nxjerrë jashtë juridiksionit të gjykatave të brendshme mosmarrëveshje ligjore ose që t’u akordojë imunitete kategorive të ndryshme të personave pa pasur mundësi që proporcionaliteti i masave të tilla të kontrollohet nga gjykatat²⁵¹. Për të arritur në përfundimin nëse ky proporcionalitet është respektuar apo jo Gjykata shqyrton rast pas rasti nëse “aktet e kundërshtuara janë bërë në kuadrin e ushtrimit të funksioneve parlamentare *stricto sensu*”²⁵². Këtë qëndrim ajo ka mbajtur qoftë në lidhje me kryetarët e Shteteve²⁵³ qoftë në lidhje me parlamentarët apo senatorët²⁵⁴, qoftë edhe me funksionarët e tjerë publikë, të tillë si policia. Në lidhje me këtë kategori në fundit qeveria britanike u detyrua të ndryshojë sistemin e saj të të ashtuquajturit “rregullit përjashtimor”²⁵⁵ në lidhje me zbatimin e nenit 6 § 1 në lidhje me paditë për neglizhencë kundër policisë²⁵⁶.

Në të gjitha këto raste, kriteri themelor që duket se buron nga jurisprudenca e Gjykatës është ai i ndarjes në imunitet funksional dhe në imunitet absolut. Ideja themelore është që ndërsa i pari

²⁴⁹ Shih *Castells k. Spanjë*, nr. 11798/85, §§ 42-43, GJEDNJ, 23/04/1992, *Jerusalem k. Austris*, nr. 26958/95, §§ 36 dhe 40, GJEDNJ, 2001-II, *Cordova k. Italisë [nr.1]*, nr. 40877/98, § 55, GJEDNJ, 30.01.2003. Shih edhe në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

²⁵⁰ Shih *De Jorio k. Italisë*, nr. 73936/01, § 49, GJEDNJ, 3.06.2004, A. k. *Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35373/97, § 75-77, GJEDNJ, 17.12.2002, *Syngelidis k. Greqisë*, nr. 24895/07, § 42, GJEDNJ, 11.02.2010.

²⁵¹ Shih *Fayed k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 17101/90, § 65, GJEDNJ, 21.09.1994, *Cordova k. Italisë [nr.1]*, e lartpërmendur § 68, *Tsalkitzis k. Greqisë*, nr. 11801/04, § 46, GJEDNJ, 16.11.2006.

²⁵² Shih *Cordova k. Italisë [nr.1]*, e lartpërmendur § 62, *Kart k. Turqia*, nr. 8917/05, § 83, GJEDNJ, [DH.M.], 3.12.2009.

²⁵³ Shih *Urechean dhe Pavlicenco k. Moldavisë*, nr. 27756/05 dhe 41219/07, § 47 dhe 52, GJEDNJ, 2.12.2014.

²⁵⁴ Shih *Cordova k. Italisë [nr. 1]*, i lartpërmendur.

²⁵⁵ Shih *Hill k. Chief Constable of West Yorkshire* [1987] UKHL, 12, [1989] AC53.

²⁵⁶ Shih *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur. Shih gjithashtu *Armani da Silva k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5878/08, GJEDNJ, 30.03.2016.

edhe mund të justifikohet në raste të caktuara, i dyti nuk është i pajtueshëm me logjikën e Konventës. Gjithashtu, duhet që imunitete të tilla të rregullohen dhe interpretohen në mënyrë të qartë dhe kufizuese dhe të interpretohen gjithmonë në kuadrin e parimit të proporcionalitetit.

B. Ekzekutimi i vendimeve përfundimtare

Gjykata ka theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë duhet të interpretohet në dritën e preambulës së Konventës, e cila e konsideroj shtetin e së drejtës si pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Gjykata thotë, se një nga elementet themelore të shtetit të së drejtës është parimi i sigurisë juridike²⁵⁷, i cili kërkon t' u garantojë individëve garanci mbi stabilitetin e situatave ligjore dhe për nxitjen e besimit të publikut në drejtësi²⁵⁸. Gjykata ka thënë se siguria ligjore presupozon respektimin e parimit të autoritetit të gjësë së gjykuar²⁵⁹, që do të thotë karakterin përfundimtar të vendimeve gjyqësore. Ajo kujton se një sistem gjyqësor i karakterizuar nga mundësia e vënies vazhdimisht në dyshim dhe e anulimit të përsëritur të vendimeve përfundimtare shkel nenin 6 § 1 të Konventës²⁶⁰. Kjo qoftë kur këto vënie në dyshim apo anulime bëhen nga gjyqtarët²⁶¹, qoftë kur bëhen nga ekzekutivi²⁶², apo edhe nga autoritete të tjera jo-gjyqësore²⁶³. Përjashtime nga ky rregull lejohen vetëm kur kjo është e domosdoshme për arsye bindëse tepër të forta²⁶⁴ dhe është e justifikuar vetëm për të korrigjuar gabime serioze të drejtësisë²⁶⁵. Në vijim do trajtojmë dy aspekte të këtij problemi.

²⁵⁷ Shih *Brumărescu k. Romania* [GC], nr 28342/95, § 61, ECHR 1999-VII.

²⁵⁸ Shih *Nexhdet Şahin dhe Perihan Şahin k. Turqisë* [GC], nr 13279/05, § 57, 20.10.2011 dhe *Agrokompleks k. Ukraine*, nr 23465 / 03, § 144, 6.10.2011.

²⁵⁹ Shih *Brumărescu*, të cituar më lart, § 62.

²⁶⁰ Shih *Sovtransavto Holding k. Ukraine*, nr 48553/99, §§ 74, 77 dhe 82, GJEDNJ, 2002 VII.

²⁶¹ Shih *Driza k. Shqipërisë*

²⁶² Shih *Tregoubenko k. Ukraine*, nr 61333/00, § 36, 2.11.2004.

²⁶³ Shih *Agrokompleks*, cituar më lart, §§ 150 -151.

²⁶⁴ *Ryabykh k. Rusisë*, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ, 24.06.2003.

²⁶⁵ *Rogca k. Moldavisë*, i lartpërmërdur, 25 §, GJEDNJ, 22.03.2005, *Dragostea Copiiilor-Petrovski-Nagornii k. Moldavisë*, nr. 25575/08, § 26-, GJEDNJ, 13.09.2011, *Zheljyakov Ukrainës*, nr. 4994/04, § 44., GJEDNJ, 9.06.2011, *Pravednaya k. Rusisë*, nr. 69529/01, § 27 dhe 28, GJEDNJ, 18.11.2004, *Popov k. Moldavisë* [Nr. 2], nr. 19960/04, § 46, GJEDNJ, 6.12.2005.

a. mos-ekzekutimi

I njëjti interpretim si edhe me nocionin e qasjes në gjykata ka ndikuar edhe për interpretimin e dispozitës së nenit 6 për të përfshirë gjithashtu edhe çështjen e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, gjyqësore ose administrative. Siç e kam shprehur edhe në raste të tjera, kur për herë të parë fillova të lexoja një vendim të Gjykatës së Strasburgut në lidhje me këtë problem, mendova se Gjykata do ta analizonte fenomenin në kuadrin e nenit 13 të Konventës që ka të bëjë me efektivitetin e mjeteve për të gëzuar të drejtat e garantuara²⁶⁶. Në mënyrë interesante konstatova se Gjykata kishte bërë një zgjidhje që dukej edhe më e logjikshme – ajo konsideroi se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare është pjesë përbërëse e konceptit të procesit të rregullt, duke i dhënë një mbrojtje më të fortë elementit ekzekutim²⁶⁷. Gjykata i kishte dhënë shenjat e para të një përqasje të tillë që në vendimin *Van de Hurk kundër Holandës*²⁶⁸ kur ajo u shpreh se:

“Pushteti për të dhënë një vendim të detyrueshëm i cili nuk mund të ndryshohet nga një autoritet jo gjyqësor në dëm të njërit nga palët është pjesë e natyrshme e vetë nocionit të një “gjykate”, siç konfirmohet nga termi “vendos”... Kjo fuqi mund të shihet gjithashtu si një përbërës i nocionit të “pavarësisë” të kërkuar nga neni 6 § 1 (neni 6-1).”²⁶⁹

Megjithatë ishte me vendimin *Hornsby*²⁷⁰ ku, duke i dhënë përgjigje pretendimit të qeverisë greke se faza e ekzekutimit nuk përfshihet në konceptin e të drejtës për një proces të rregullt sipas Konventës, Gjykata argumenton se:

²⁶⁶ Shih artikullin “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si pjesë themelore e procesit të rregullt”, Avokati i Popullit, 2003.

²⁶⁷ Kujtojmë që dispozita e nenit 6 është *lex specialis* në raport me dispozitën e nenit 13 të Konventës.

²⁶⁸ Vendim i 19.04.1994, nr.16034/90 [1994], GJEDNJ, 14.

²⁶⁹ Ibid. 45. Shih gjithashtu *Bentham k. Holandës*, 23.10.1985, Seria A nr. 97, f. 17, § 40; *H. k. Belgjikës*, 30.11.1987, Seria A nr. 127, f. 34, § 50; dhe *Belilos k. Zvicrës*, 29.04.1988, Seria A nr. 132, f. 29, § 64.

²⁷⁰ Shih *Hornsby k. Greqisë*, i lartpërmendur.

“...kjo e drejtë nuk do të kishte kuptim nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti Kontraktues lejon që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i detyrueshëm të mbetet pa efekt në dëm të njërit palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 duhet të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve ndërgjyqëse - procedurat që janë të drejta, publike dhe të shpejta - pa mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore; ta interpretosh nenin 6 sikur ka të bëjë ekskluzivisht me qasjen në gjykatë dhe me ecurinë e procedurave do mund të çonte në situata të papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës, të cilin Shtetet Kontraktuese kanë marrë përsipër të respektojnë kur ratifikuan Konventën...”²⁷¹

Dhe pastaj përfundon në mënyrë solemne se:

“...ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllimet e nenit 6...”²⁷²

Nuk mund të mos arrihej në këtë rezultat gjithsesi. Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor jo vetëm që përbën pjesë themelore të parimeve të *res judicata* dhe të sigurisë ligjore, por duke qenë efekti i gjykimit, mos-ekzekutimi do ta zhvishte një proces ligjor nga çdo arsye për tu zhvilluar. Ekzekutimi është në fakt një element themelor i së drejtës të procesit të rregullt dhe i vetë nocionit të shtetit të së drejtës²⁷³. Ky parim kërkon, ndër të tjera, që zgjidhja që gjykatat i kanë dhënë me vendim një mosmarrëveshje të mos mund të vihet në dyshim nga asnjëra prej palëve.²⁷⁴ Kjo do të thotë që asnjë prej

²⁷¹ Ibid. § 40

²⁷² Ibid.

²⁷³ Shih § 66 të vendimit *Iatridis k. Greçisë* [DH.M.], nr. 31107/96, , GJEDNJ, 1999-II, ku Gjykata kujton se:

“...parimi i shteti i së drejtës të cilin Shtetet Kontraktuese kanë marrë përsipër të respektojnë kur kanë ratifikuar Konventën përfshin detyrimin për të siguruar që autoritetet kompetente të zbatojnë vendimet gjyqësore...”

^{Shih} gjithashtu *Pavić k. Kroacisë*, nr. 21846/08, § 38, GJEDNJ, 28.01.2010.

²⁷⁴ Shih GJEDNJ, [DH.M.] 28.10.1999, *Brumarescu k. Rumanisë*, nr. 28342/95, § 61., GJEDNJ, 22.03.2005, *Rogca dhe Moldavi*, nr. 6267/02 § 24, GJEDNJ, 12.01.2006, *Kehaya dhe të tjerët k. Bullgarisë*, nr. 47797/99 dhe 68698/01, § 61.

palëve të mos ketë fuqi të rifillojë shqyrtimin²⁷⁵ ose të shtrembërojë në thelb ekzekutimin e një vendimi përfundimtar për përfituar pasoja juridike që janë në thelb të ndryshme nga ajo që kanë vendosur gjykatat. Akoma më me forcë gjen zbatim ky parim kur njëra nga palët është organ i administratës publike²⁷⁶. Një person që ka fituar një vendim gjyqësor kundër shtetit nuk ka nevojë të fillojë një procedurë më vete për të marrë ekzekutimin e vendimit. Gjykata është shprehur se është përgjegjësi e autoriteteve shtetërore për të garantuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të marrë kundër tyre²⁷⁷. Megjithëse në raste të veçanta personat e interesuar mund të duhet të kryejnë disa hapa proceduralë në mënyrë që të lejojnë ose përshpejtojnë ekzekutimin e një vendimi, ky detyrim nuk duhet të tejkalojë atë çka është absolutisht e nevojshme dhe do të thotë që autoritetet publike nuk duhet të vihen vetë në lëvizje me qëllim respektimin e vendimit në të cilin janë palë humbëse²⁷⁸. Për më tepër, ky parim sanksionon që as ekzekutivi dhe as parlamenti nuk mund të ndërhyjnë me akte, ligjore²⁷⁹ apo administrative²⁸⁰ që ndërhyjnë ndaj efektit të një vendimi gjyqësor qoftë gjatë procedurave gjyqësore²⁸¹ qoftë edhe pas përfundimit të tyre²⁸².

Parimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore si pjesë e nenit 6 § 1 gjen zbatim si për çështjet penale ashtu edhe për ato administrative²⁸³ dhe civile. Ai gjen zbatim edhe ndaj vendimeve

²⁷⁵ *Shih Brletic k. Kroacisë*, nr. 42009/10, § 38, GJEDNJ, 16.01.2014.

²⁷⁶ *Shih Iera Moni Profitou Iliou Thiras k. Greqisë*, nr. 32259/02, § 34, GJEDNJ, 22.01.2005, *Foyers Foundation studentët e Kishës së Reformuar dhe Stanomirescu k. Rumanisë*, nr. 2699/03 dhe 43597/07, § 56, GJEDNJ, 7.01.2014, *Flores Quiros k. Spanjës*, nr. 22939/08, § 35, GJEDNJ, 19.07.2016.

²⁷⁷ *Shih Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, § 54, *Foyers Foundation studentët e Kishës së reformuar dhe Stanomirescu k. Rumanisë*, e lartpërmendur, § 58, *Nosov dhe të tjerët k. Rusisë*, nr. 9117/04 dhe 10441/04, § 46, GJEDNJ, 20.12.2014, *Bozza k. Italisë*, e lartpërmendur, § 45.

²⁷⁸ *Kosmidis dhe Kosmidou k. Greqisë*, nr. 32141/04, § 24, GJEDNJ, 8.11.2007, *Akashev k. Rusisë*, nr. 30616/05, § 22, GJEDNJ, 12.06.2008.

²⁷⁹ *Shih Scordino, Sharra k. Shqipërisë* dhe nën këtë prizëm, ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave.

²⁸⁰ *Shih Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*.

²⁸¹ *Shih Pressos Compania, Sharxhi k. Shqipërisë*.

²⁸² *Shih Scordino, Sharxhi k. Shqipërisë*.

²⁸³ *Shih Mishgjoni k. Shqipërisë* ku Gjykata thotë se neni 6 § 1 i Konventës gjen zbatim edhe në procedurën në lidhje me shkarkimin e një gjyqtareje. *Shih gjithashtu Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*.

të administratës qendrore ose vendore ndaj të cilave nuk është bërë ankim në gjykatë dhe kanë marrë formë përfundimtare²⁸⁴. Vendimi *Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, jo vetëm që gjen që neni 6 § 1 gjen zbatim edhe në raste të tilla, por ai vendos edhe shkelle të nenit 13 të Konventës në lidhje me ekzekutimin. Në këtë mënyrë ai lë të kuptohet se çdo ankim eventual në gjykatat shqiptare për tu ankuar ndaj mos-ekzekutimit të vendimeve administrative, është jo efektiv dhe prandaj i kotë të bëhet. Megjithatë, kompleksiteti i procedurave, natyra e problemit, numri i vendimeve ose barra buxhetore nuk e shkarkojnë dhe as nuk ia zbusin një Shteti detyrimin për të zbatuar vendimet e detyrueshme dhe të zbatueshme²⁸⁵. Një autoritet i një Shteti palë nuk mund të pretendojë mungesën e fondeve ose të burimeve të tjera, si për shembull troje ose mjedise strehimi, për t'iu shmangur detyrimit që rrjedh nga një vendim gjyqësor²⁸⁶. Për më tepër, kur realizimi i një *restitutio in integrum* të urdhëruar nga një gjykatë rezulton objektivisht i pamundur për shkak të pengesave faktike ose ligjore të pakapërcyeshme, Shteti duhet që vetë dhe në mirëbesim të studiojë zgjidhje të tjera, të tilla si dhënia e kompensimit monetar²⁸⁷. Sidoqoftë ky kompensim nuk duhet të jetë i përmasave të tilla sa të ndërhyjë në vetë thelbin e vendimit gjyqësor²⁸⁸. Gjykata ka thënë se “ekzekutimi duhet, gjithashtu, të jetë i plotë, perfekt dhe jo i pjesshëm”²⁸⁹.

Mos-ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është sëmundja endemike

²⁸⁴ Rasti më i spikatur në këtë drejtim është vendimi *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*.

²⁸⁵ *Shih Cingili Holding A.g. dhe Cingilliogtu k. Turqi*, nr. 31833/06, 37538/06, § 39, GJEDNJ, 21.06.2015.

²⁸⁶ *Shoqëria e Administrimit të Portit të Campoloro dhe Shoqëria e Fernës të Campoloro k. Francës*, nr. 57516/00, § 62, GJEDNJ, 26.09.2006, *Tchokontio Happi k. Francës*, nr. 65829/12, § 50, GJEDNJ, 9.04.2015.

²⁸⁷ *Shih Delvina k. Shqipërisë* §§ 56, në lidhje me mënyrën se si qeveria shqiptare e kuptonte detyrimin e saj për të ekzekutuar një vendim të Gjykatës së Lartë, dhe deri në paragrafin 62, në lidhje me përgjigjen që jep Gjykata mbi këtë pikë. *Shih gjithashtu Mullai dhe Technoprojekt k. Shqipërisë* kur qeverisë Shqiptare iu la zgjidhja që ose të bënin *restitutio ad integrum* ose ti kompensonin kërkuesit. *Shih edhe Cingilli Holding A.g dhe Cingilliogtu k. Turqisë*, i lartpërmendur, § 41.

²⁸⁸ Scordino ...

²⁸⁹ *Shih Matheus k. Francës*, nr. 62740/00, § 58, GJEDNJ, 31.03.2005, dhe *Sabin Popescu k. Rumanisë*, nr. 48102/99, GJEDNJ, §§ 68-76 2.03.2004, *Mazzeo k. Italisë*, nr. 32269/09, GJEDNJ, 05.10.2017.

e sistemit ligjor shqiptar. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë arsyeja e më shumë se 50 % të kërkesave të paraqitura kundër Republikës së Shqipërisë në Gjykatën e Strasburgut. Vendimi i parë kundër Shqipërisë²⁹⁰ ka pasur të bëjë pikërisht me këtë çështje i cili është shoqëruar me një sërë vendimesh të tjera²⁹¹ ku të gjitha rezultojnë në shkelje. Ky problem, që nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e pronave²⁹², nxjerr në pah një problem jo aq strukturor sa psikologjik dhe politik në realitetin edhe historik shqiptar²⁹³ dhe që prek vetë zemrën e nocionit të pavarësisë së gjyqësorit, të mohimit të drejtësisë dhe të shtetit ligjor në tërësi²⁹⁴.

b. ekzekutimi me vonesë

Ekzekutimi me vonesë është një aspekt tjetër që pengon prodhimin e duhur të pasojave juridike të vendimeve gjyqësore, duke e tretur në kohë logjikën e dobisë së procedurave gjyqësore dhe të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave. Kështu për shembull në çështjen e lartpërmendur *Hornsby*, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6 me arsyetimin se ishin dashur rreth pesë vjet për shtetin e paditur që të vinte në zbatim një vendim të një gjykate administrative.

Shteti ka detyrimin të organizojë një sistem i zbatimit të ndaluar

²⁹⁰ *Qufaj Sh.p.k. k. Shqipërisë*, i lartpërmendur. Shih gjithashtu *Manushaqe Puto dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 604/07, 34770/09, 43628/07, GJEDNJ, 31.07.2012.

²⁹¹ Shih *Driza k. Albania dhe Marini k. Albania, Nuri k. Albania*, nr. 12306/04, 3 February 2009 dhe *Hamzaraj k. Albania (no. 1)*, nr. 45264/04, 3 February 2009. *Delvina k. Albania*, nr. 49106/06, 8 March 2011 e deri te një sërë vendimesh që tashmë jepen nga komitetet e Gjykatës. Shih që nga *Cale k. ALBANIA*, nr. 50933/07 50933/07 GJEDNJ, 06.11.2012 e deri te *Molla k. ALBANIA*, 29680/07 29680/07, GJEDNJ, 08.12.2016.

²⁹² Shih *Sharra k. Albania*, nr. 29975/06, 6 December 2011 dhe *Uruçi k. Albania*, nr. 6491/06, 24 January 2012. Shih edhe *Mishgjoni k. Shqipërisë*, nr. 18381/05, 07.12.2010 që ka të bëjë me vonesat në ekzekutimin e një vendimi të Gjykatës së Lartë nga ana e KLD.

²⁹³ Përmendet rëndom në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare shembulli i vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 9.4.1949 në çështjen e Kanalit të Korfuzit (*Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut k. Shqipërisë*) ngeli pa u ekzekutuar nga Republika e Shqipërisë për më shumë se 40 vjet. Shih Aloysius P. Llamzon "Jurisdiction and Compliance in Recent Decisions of the International Court of Justice" në EJIL (2007), Vol. 18 nr. 5, 815–852. Për vendimet përkatëse shih në "*Affaire du Detroit de Corfou, Arrêt du 9 avril 1949* : K. I. J. Recueil, 1949, p. 4." dhe "*Affaire du Detroit de Corfou, Arrêt du 15 décembre 1949* : K. I. J. Recueil, 1949, p. 244."

²⁹⁴ Kjo i është kujtuar Republikës së Shqipërisë në veçanti, që më 18.11.2004, në vendimin e parë *Qufaj Sh.p.k. k. Shqipërisë*, i lartpërmendur e deri tek *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, § 154.

që funksionon në mënyrë efektive në praktikë²⁹⁵. Një vonesë e mundshme në këtë drejtim mundet të jetë e ligjshme për aq kohë sa ajo nuk ndikon në thelbin e së drejtës për qasje në gjykatë²⁹⁶. Për të gjykuar nëse afati kohor është i arsyeshëm apo jo, Gjykata merr parasysh kompleksitetin e procedurës, qëndrimin dhe sjellen e autoriteteve kombëtare kompetente dhe të kërkuesit, si dhe objektin e vendimit që duhet ekzekutuar²⁹⁷, duke përfshirë shumën dhe natyrën e shumës së dhënë nga gjyqtari i brendshëm²⁹⁸.

Një nga fenomenet që ka karakterizuar problemet e ekzekutimit në kohë të vendimeve të gjykatave të brendshme është ai që lidhet me të ashtuquajturat probleme strukturore. Këto probleme hasen, siç mund të jetë e pritshme, vetëm në vende ish-komuniste²⁹⁹, përfshirë edhe Shqipërinë³⁰⁰, dhe konsistojnë në një numër të madh vendimesh gjyqësore të gjykatave të brendshme që nuk janë ekzekutuar për një periudhë shumë të gjatë që në disa raste shkon edhe në 25 vjet. Këto probleme përveçse lidhen me ndryshimet politike në këto vende, burimin e vërtetë e gjejnë në standatin e ulët demokratik dhe autoritetin e cunuar të vendimeve gjyqësore në sistemet ligjore përkatëse. Kjo situatë e ka detyruar Gjykatën që të adoptojë strategjinë e të ashtuquajturave vendime pilot. Ka shumë diskutime në gjirin e Gjykatës, por edhe të doktrinës në lidhje me tiparet e vendimeve pilot. Nëse i pari është dhënë për një situatë tepër specifike³⁰¹, tipari më evident që e shtyn Gjykatën të

²⁹⁵ *Fuklev k. Ukrainës*, nr. 71186/01, § 84, GJEDNJ, 7.06.2005, *Boucke k. Malit të Zi*, nr. 26945/06, § 86, GJEDNJ, 21.02.2012.

²⁹⁶ *Burdov k. Ruisë*, nr. 59498/00, § 34-38, GJEDNJ, 7.05.2002, *Jasiuene k. Lituaniës*, nr. 41510 / 98, § 27, GJEDNJ, 6.03.2003.

²⁹⁷ *Uzkurdiend et al.* nr. 62988/00, § 31-37, GJEDNJ, 7.04.2005, *Kochalidze k. Ruisë*, nr. 44038/05, § 13, GJEDNJ, 10.04.2012, *Stojanov dhe Tabakov k. Bullgarisë*, nr. 34130/04, § 78, GJEDNJ, 26.11.2013.

²⁹⁸ *Shih Bozza k. Italisë*, nr. 17739/09, § 46, vendim mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 14.09.2017.

²⁹⁹ *Shih Burdov k. Ruisë* [nr. 2], nr. 33509/04, GJEDNJ, 15.01.2009, *Olaru dhe të tjerët k. Moldavisë*, nr. Tona 476/07, 22539/05, 17911/08 dhe të tjerë, GJEDNJ, 28.07.2009, *Yuriy Nikolayevich Ivanov dhe Ukrainës*, nr. 40450/04, GJEDNJ, 15.10.2009, *Gerasimov dhe të tjerët k. Ruisë*, nr. 29920/05, 3553/06 dhe të tjerë, GJEDNJ, 9.04.2015.

³⁰⁰ *Shih të shumë përmendurim vendimin Manushaqe Puto dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 604/07, 34770/09, 43628/07 dhe të tjerë, GJEDNJ, 31.07.2012.

³⁰¹ *Broniowski k. Polonisë*, shih në L. Bianku, O. Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

adoptojë një qëndrim të tillë është numri i kërkesave të regjistruara ose të mundshme përpara saj. Nga pikëpamja metodologjike vendimet pilot insistojnë më shumë në problemet strukturore, sistemike dhe sistematike të shteteve në lidhje me ekzekutimin dhe synojnë rregullimin e këtyre problemeve duke ftuar Shtetet që të bëjnë reforma duke marrë masa të përgjithshme për këtë qëllim. Megjithatë nga ana e Shteteve, dhe jo vetëm, vendimet pilot dhe shtyrjet e njëpasnjëshme të afateve që akordohen prej tyre për realizimin e reformave të nevojshme, janë parë si një instrument për të shtyrë në kohë ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të brendshme. Kjo strategji keqbesimi nuk ka bërë asgjë tjetër veçse ka cenuar vetë parimin e përmendur më lart të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe ka zhvilluar më tej problemet strukturore dhe sistemike në vendet përkatëse. Për këtë arsye sukseset e hasura në vitet e para të kësaj strategjie në Strasburg, janë zbehur së tepërmi vitet e fundit, duke çuar në zgjidhje tepër të kritikuar nga doktrina por edhe brenda Gjykatës³⁰².

II. Garanci institucionale

A. gjykatë e krijuar me ligj

Neni 6 § 1 i Konventës kërkon shprehimisht që *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga një gjykatë ... , e krijuar me ligj”*. Kjo kërkesë, që është themelore ka për qëllim të parandalojë organizimin e sistemit gjyqësor në një vend anëtar të Konventës mbi baza të paqëndrueshme dhe të paparashikueshme. Për këtë qëllim duhet që ngritja, organizimi dhe funksionimi i gjyqësorit

³⁰² Shih mendimin në pakicë të gjyqtarëve Yudkivska, Sajó, Bianku, Karakaş, De Gaetano, Laffranque Et Motoc në vendimin *Burmych k. Ukrainës* [DH.M.], si dhe reagimet në doktrinë si p.sh. Eline Kindt, *“Non-execution of a pilot judgment: ECtHR passes the buck to the Committee of Ministers in Burmych dhe të tjerë k. Ukraine”*, 26.10.2017. Nga e njëjta autore *“Giving up on individual justice? The effect of state non-execution of a pilot judgment on victims”* në *Netherlands Quarterly of Human Rights*, Vol 36, Issue 3, 2018, Geir Ulfstein dhe Andreas Zimmermann *“Certiorari through the Backdoor? – the judgment by the European Court of Human Rights in Burmych dhe të tjerë k. Ukraine in perspective”*, KFG Working Paper Series, No. 13, April 2018, Raffaella Kunz *“A further “constitutionalization” to the detriment of the individual? On the ECtHR’s stricter reading of the principle of subsidiarity regarding the admissibility of cases”*, etj.

të rregullohet me ligj, mundësisht me kushtetutë për sa i përket strukturës kryesore, për të shmangur që ai të funksionojë ose të pushojë së funksionuari sipas diskrecionit të ekzekutivit³⁰³. Kjo është e lidhur ngushtë me parimin e shtetit të së drejtës që qëndron në themelet e sistemit të Konventës,³⁰⁴ si edhe me parimin e ndarjes së pushteteve, sidomos mes ekzekutivit dhe gjyqësorit, i cili ka një rëndësi themelore në funksionimin e shoqërive dhe shteteve demokratike³⁰⁵. Gjykata e ka thënë qartë që kur një gjykatë që nuk është krijuar në përputhje me qëllimet e ligjvënësit, domosdoshmërisht, nuk ka legjitimitetin e kërkuar në një shoqëri demokratike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore³⁰⁶. Neni 6 § 1, megjithatë nuk përjashton mundësinë që detajet të funksionimit të gjyqësorit të specifikohen nga ekzekutivi, por jo duhet bërë vetëm kur ligji e autorizon këtë shprehimisht dhe vetëm sipas kuadrit të këtij të fundit³⁰⁷. Gjykata ka theksuar, nga ana tjetër, që organizimi dhe funksionimi i sistemit gjyqësor nuk mund të lihet as në diskrecionin e autoriteteve gjyqësore të cilave gjithsesi u njihen kompetenca të caktuara për interpretimin e legjislacionit kombëtar që rregullon funksionimin dhe kompetencat e tyre³⁰⁸. Për më tepër, neni 6 § 1 nuk e ndalon krijimin dhe funksionimin e gjykatave të posaçme, me kusht që ato të parashikohen nga ligji dhe të funksionojnë në përputhje me të.

Dy nocionet themelore të këtij koncepti, “*e krijuar me ligj*” sapo

³⁰³ Shih *Zand k. Austria*, nr. 7360/76, Raporti i Komisionit i 12.10.1978, Decisions and Reports (DR) 15, fq. 70 dhe 80, *Coëme dhe të tjerë k. Belgjikës*, nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, § 98, GJEDNJ, 22.06.2000, *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, nr. 26374/18, §§ 97 e vijues, GJEDNJ, 12.03.2019. Të nesërmen e publikimit të këtij vendimi Ministrja islandeze e Drejtësisë dha menjëherë dorëheqjen.

³⁰⁴ *Jorgic k. Germany*, nr. 74613/01, § 64, ECHR 2007-III (extracts)

³⁰⁵ Shih *Ramos Nunes de Carvalho E Sá v Portugal* [GC], nos. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, § 144, 8.11.2018.

³⁰⁶ Shih *Lavents k. Letonisë*, nr. 58442/00, § 114, 28.11.2002. Shih L. Bianku, referuar më sipër.

³⁰⁷ Shih në këtë drejtim edhe vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Luksembourg, *Strack k. Komisionit*, T-199/11 P, EU:T:2012:691, § 22, 13.12.2012.

³⁰⁸ Shih *Coëme dhe të tjerë*, i sapopërmendur, § 98, *Gurov k. Moldova*, nr. 36455/02, § 34, 11.07.2006, *Savino dhe të tjerë k. Italisë*, nr. 17214/05, 20329/05 dhe 42113/04, § 94, 28 April 2009, *Guðmundur Andri Ástráðsson, i sapopërmendur*, § 99, *Chim dhe Przywieczerski k. Polonisë*, nr. 36661/07 dhe 38433/07, 12.04.2018.

janë qartësuar edhe një herë së fundmi nga Gjykata në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*, në 12 mars 2019. Sipas Gjykatës termi “*ligj*” përfshin legjislacionin që parashikon krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore dhe çdo dispozitë tjetër të ligjin e brendshëm. Ndërsa termi “*e krijuar me ligj*” përfshin bazën ligjore për vetë ekzistencën e një gjykate³⁰⁹. Ky nocion përfshin gjithashtu procesin e emërimit të gjyqtarëve brenda sistemit gjyqësor vendas i cili, në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, duhet të kryhet në përputhje me rregullat e zbatueshme të legjislacionit vendas në fuqi në kohën përkatëse³¹⁰.

Duhet kujtuar se nocioni i gjykatës të krijuar me ligj përfshin edhe mënyrën e funksionimit të gjykatave në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm³¹¹. Kjo do të thotë se kjo garanci shkelet nëse një gjykatë kombëtare, megjithëse e krijuar me ligj, nuk respekton rregullat që parashikojnë përbërjen e saj, duke përfshirë edhe emërimin e jurive, kompetencën e saj ose aspekte të tjera të funksionimit të saj³¹². Është e qartë nga jurisprudenca e Gjykatës se edhe karakteri juridiksional i organit të pretenduar si gjyqësor luan rol në identifikimin e tij si një gjykatë e krijuar me ligj³¹³.

Gjykata ka theksuar se kriteri i krijimit me ligj të një gjykate lidhet ngushtë me kriteret e tjera të parashikuara nga neni 6 § 1 mbi pavarësinë dhe paanësinë, të dyja pjesë përbërëse e parimit të shtetit ligjor në një shoqëri demokratike, kritere që do i analizojmë

³⁰⁹ Shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, i lartpërmendur, § 98. Shih edhe referemit në DMD Group, A.S. k. *Sillovakisë*, nr 19334/03, § 59, 5.10.2010.

³¹⁰ Shih *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, nr. 33192/07 33194/07, §§ 137-145, GJEDNJ, 25.06.2013.

³¹¹ Shih *Biagioli k. San Marino*, nr. 8162/13, vendimi mbi pranueshmërinë, § 73, GJEDNJ, 08.07.2014.

³¹² Shih *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, *Buscarini k. San Marinos*, nr. 31657/96, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 4.05.2000, *Posokhov k. Rusisë*, nr. 63486/00, § 39, GJEDNJ, 4.03.2003, *Fedotova k. Rusisë*, nr. 73225/01, § 38-44, GJEDNJ, 13.04.2006, *Ana Mocanu k. Rumania*, nr. 11770/08, § 37-38, GJEDNJ, 17.12.2013, *Ezgeta k. Kroacisë*, nr. 40562/12, § 38, GJEDNJ, 7.09.2017.

³¹³ Shih *Sramek k. Austrisë*, nr. 8790/79, § 36, 22.10.1984, *Bentham k. Holandës*, 23.10.1985, § 40, série A nr. 97, *Rolf Gustafson k. Suedisë*, 1.07.1997, § 45, *Recueil 1997-IV*, Qipro k. Turqisë [DH.M.], nr. 25781/94, § 233, CEDH 2001-IV, dhe së fundmi, *Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës*, nr. 40575/10 dhe 67474/10, §§ 138-139, GJEDNJ, 2.10.2018.

në vijim. Në fakt do të ishte e palogjikshme të pretendohet pavarësi dhe paanësi nga gjyqtarë që janë nën kontrollin e ekzekutivit për sa i përket emërimit, promovimit ose edhe largimit nga detyra³¹⁴. Një situatë e tillë nuk do të krijonte besimin që gjykatat duhet t'i ofrojnë publikut³¹⁵.

Gjykata është shprehur se në qoftë se dispozitat e legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e gjykatave, përfshirë edhe emërimin e gjyqtarëve shkelen kjo do e bënte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një rasti të parregullt dhe procesin e parregullt.³¹⁶ Duhet të jetë e qartë që, siç kujton vendimi i përmendur më lart, *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*, duhet që shkelja të jetë flagrante në mënyrë që ajo të mos arrijë të përmbushë standardin e kërkuara nga neni 6 § 1³¹⁷. Interesante është që një nga elementët e shkeljes flagrante identifikohet ai i shkeljes së legjislacionit nga një prej pushteteve të tjera, sidomos, ekzekutivit³¹⁸.

Kërkesa para organit *ad hoc* të arbitrazhit të detyrueshëm, të përcaktuar në kontratë hyri në kompani dhe shumicën e aksionarëve trupi i arbitrazhit nuk kishte karakteristika të një gjykate të themeluar në mënyrë të ligjshme³¹⁹. Ndërkohë që në çështjen *Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës*, Gjykata pranoi se TAS (Tribunali Administrativ i Sportit) përbën në fakt, nën dritën e garancive dhe kompetencave, një gjykatë të krijuar me ligj për qëllimet e nenit 6 § 1 të Konventës³²⁰.

³¹⁴ Shih përfundimin që arrin Gjykata në § 126 të vendimit *Guðmundur Andri Ástráðsson*, i lartpërmendur, ku ajo gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtojë pretendimin për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme për aq kohë që kishte arritur në përfundilin se kishte shkelje të nenit 6 § 1 nën prizmin e “gjykatë e krijuar me ligj”.

³¹⁵ Shih *Morice k. Francës* [D.H.M.], nr. 29369/10, § 78, 23.04.2015.

³¹⁶ Shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, i lartpërmendur, § 98. Gjykata i referohet gjithashtu *Lavents*, të lartpërmendur, § 114, *Gorguilaðzé k. Gjeorgjisë*, nr. 4313/04, § 68, 20.10.2009, dhe *Pandjikidzé dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, nr. 30323/02, § 104, 27.10.2009.

³¹⁷ Shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, i lartpërmendur, § 100. Shih edhe *Cowme dhe të tjerët*, i lartpërmendur, § 98 *in fine*, *Lavents*, i lartpërmendur, § 114, *DMD Group, A.S.*, i lartpërmendur, § 61

³¹⁸ Shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, i lartpërmendur, §§ 112-123.

³¹⁹ Shih *Suda k. Republikës Çeke*

³²⁰ Shih *Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës*, i lartpërmendur, §§ 148-149.

B. gjykatë e pavarur dhe e paanshme

Nocioni i gjykatës së krijuar me ligj është ngushtësisht i lidhur me nocionin e pavarësisë dhe të paanësisë së saj. Siç e thamë më sipër, krijimi me ligj i gjykatave kërkohet pikërisht për të shmangur ndërhyrjet në pavarësinë dhe paanësinë e tyre³²¹. Për këtë arsye këto dy kritere, ashtu si edhe ai që sapo mbaruam së analizuari, mbi gjykatën e krijuar me ligj, janë parashikuar shprehimisht nga paragrafi 1 i nenit 6. Në fakt të tre këta elementë janë konceptualisht të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin³²². Gjykata bën paraprakisht analizën e konceptit të gjykatës së krijuar me ligji. Pastaj, pavarësisht se konceptualisht janë të ndryshëm nga njëri tjetri, ajo analizon normalisht së bashku dy kriteret, atë të pavarësisë dhe të paanësisë³²³, duke i parë si anë të së njëjtës medalje. Për qëllim lehtësimin e kuptimit të analizës ne po i ndajmë më vete në vijim.

a. pavarësia

Sipas jurisprudencës së qëndrueshme të Gjykatës, gjykatat kombëtare duhet të jenë të pavarura nga palët dhe mbi të gjitha nga pushtetet e tjera, legjislativi dhe ekzekutivi³²⁴. Kjo është veçanërisht e domosdoshme kur këto dy të fundit janë vetë palë përpara një gjykate kombëtare dhe prandaj parimi i ndarjes së pushteteve merr një rëndësi themelore në këtë kuadër. Për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet se është “i pavarur” – veçanërisht nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv dhe nga palët në proces

³²¹ Shih *Piersack k. Belgjikës*, nr. 8692/79, GJEDNJ, 1.10.1982, § 33, *Coëme dhe të tjerët k. Belgjikës*, i lartpërmendur, § 99.

³²² Shih në lidhje me lidhjet ndërmjet pavarësisë dhe paanësisë, SHIH GJEDNJ, 25.02.1997 “ *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22107/93, § 73. –, GJEDNJ, 6.05.2003, *Kleyn dhe të tjerët k. Hollandë*, nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 194 ‘-, GJEDNJ, 6.10.2011, *Agrokompleks k. Ukrainës*, nr. 23465/03, § 128. –, GJEDNJ, 1.01.2016, *Miracle Europe Kft k. Hungarisë*, nr. 57774/13, § 5-6.

³²³ Shih, GJEDNJ, 6.10.2011, *Agrokompleks k. Ukrainës*, i lartpërmendur, § 128 e vijues-, GJEDNJ, 10.01.2012, *Pohoska k. Polonisë*, nr. 33530/06, § 34 e vijues, GJEDNJ, 1.10.2008, *Moiseyev k. Rusisë*, nr. 62936/00, 175 § e vijues-, GJEDNJ, 9.01.2013, *Oleksandr Voikov k. Ukrainës*, nr. 21722/11, § 107 e vijues.

³²⁴ Shih, GJEDNJ, 28.06.1984, *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 7819/77 el 7878/77, § 78, GJEDNJ, 25.02.1997, *Findlay dhe Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur, § 73.

- Gjykata merr në shqyrtim mënyrën e emërimit të anëtarëve të tij, kohëzgjatjen e mandatit të tyre në atë funksion, ekzistencën e garancive ndaj presioneve të jashtme si dhe faktin nëse ky organ ofron pamjen e një organi të pavarur apo jo³²⁵. Për këtë arsye një gjykatë nuk është e pavarur në qoftë se ajo nuk është në gjendje që të japë një vendim të detyrueshëm³²⁶. Analiza që bëhet në lidhje me pavarësinë e gjykatave konsiston kryesisht në tiparet e tyre institucionale, organizative dhe funksionale dhe në raportet që ato kanë me dy pushtetet e tjera, legjislativin dhe ekzekutivin. Le t'i analizojmë shkurtimisht me radhë këta elementë.

Pavarësia e gjykatave vesh një element të fortë të brendshëm. Ky element i brendshëm konsiston në konceptin që çdo gjyqtar duhet të jetë i pavarur në dhënien e drejtësisë dhe duhet ti nënshtrohet vetëm ligjit. Sistemi i administrimit e drejtësisë duhet të ofrojë garanci për të siguruar që gjyqtarët nuk janë nën presion nga kolegët e tyre dhe sidomos nga ata që kryejnë funksione administrative, si për shembull presidenti i gjykatës së tyre apo një autoritet tjetër brenda gjykatës ose strukturave të pushtetit gjyqësor. Mungesa e garancive të tilla mund ta bëjë Gjykatën të pranojë se dyshimet e kërkuesit për pavarësinë dhe paanshmërinë e një gjykate ishin të objektivisht justifikuar.³²⁷

Pavarësia e gjykatave në raport me legjislativin është një nga shprehjet më evidente të parimeve të ndarjes së pushteteve, të

³²⁵ Shih paragrafin 78 të vendimit të Gjykatës në lidhje me çështjen *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, të lartpërmendur, si dhe vendimin e Gjykatës të 2.09.1998 në lidhje me çështjen *Lauko k. Sllovakisë*. Shih në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur. Shih gjithashtu, *Langborger k. Suedisë*, nr. 11179/84 § 32, GJEDNJ, 22.06.1989, *Bryan k. Mbretërisë së Bashkuar* nr. 19178/91, § 37, GJEDNJ, 22.11.1995, *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 73, GJEDNJ, 25.02.1997, *Brudnicka dhe të tjerët k. Polonisë*, nr. 54723/00, § 38, GJEDNJ, 3.03.2005, *Luka k. Rumanisë*, nr. 34197/02, § 37, GJEDNJ, 21.07.2009, *Pohoska k. Polonisë*, § 34., GJEDNJ, 10 .01. 2012,

³²⁶ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 19.04.1994 në lidhje me çështjen *Van de Hurk k. Hollandës*, Seria A, nr. 288; shih në 18 European Human Rights Reports 481. Në vendimin e saj të 25 shkruarit 1997 në lidhje me çështjen *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata konstatoi se gjykatat ushtarake britanike nuk ishin të pavarura pikërisht për këtë arsye.

³²⁷ Shih *Parlov-Tkaldiq k. Kroacisë*, nr. 24810/06, § 86, GJEDNJ, 22.12.2009, *Agrokompleks k. Ukrainës*, nr. 23465/03, § 137, GJEDNJ, 6.10.2011.

shtetit ligjor dhe të gjykimit të drejtë. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur ngrihen pretendime se aktet ligjore të miratuara nga legjislativi shkelin Kushtetutën ose të drejtat e njeriut. Gjykata ka thënë se “... *parimi i shtetit ligjor dhe i gjykimit të drejtë të sanksionuara nga neni 6 § 1 nuk pranojnë asnjë ndërhyrje nga legjislativi në administrimin e drejtësisë në mënyrë që të ndikojë në zgjidhjen gjyqësore të një mosmarrëveshjeje.*”³²⁸ Kjo nuk do të thotë që ligjvënësi nuk mund të miratojë ligje thjesht sepse një mosmarrëveshje me objekt të njëjtë me një projektligj është në gjykim e sipër përpara një gjykate kombëtare.³²⁹ Por në rast të një ndërhyrjeje të tillë duhet pasur kujdes qëllimi, mënyra dhe koha në të cilën pushteti legjislativ ndërhyr në rregullimin me ligj të një situatë të caktuar ligjore³³⁰. Konsideratat financiare, si të tilla nuk janë justifikim për ndërhyrjen e ligjvënësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që janë përpara gjykatave³³¹ apo që, *a fortiori*, janë zgjidhur përfundimisht në rrugë gjyqësore³³².

Raportet me ekzekutivin janë një nga pikat nevralgjike të nocionit të pavarësisë së gjykatave. Ndërhyrjet e ekzekutivit në organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit janë thuajse të pamundura për t’u justifikuar. Pavarësisht se siç e thamë edhe më sipër, krijimi i gjykatave speciale nuk është në parim në kundërshtim me Konventën, krijimi i tyre me akt të qeverisë nuk do mund të justifikohet. Edhe ndërhyrjet e mëvonshme të ekzekutivit nga pikëpamja e pavarësisë strukturore dhe funksionale e gjykatave do të ngrinin probleme nga pikëpamja e nenit 6 § 1 të Konventës. Në çështjen *Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar*³³³ Gjykata vendosi se

³²⁸ Shih *Rafineritë greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, nr. 13427/87, § 49, GJEDNJ, 9.12.1994, *M.K. dhe të tjerët k. Italisë*, nr. 5376/11, § 59-, GJEDNJ, 3.09.2013.

³²⁹ Shih *Tarbuk k. Kroacisë*, nr. 31360/10, § 51, GJEDNJ, 11.12.2012.

³³⁰ *Rafineritë greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, GJEDNJ, 9.12.1994, *Zielinski dhe Pradal dhe Gonzalez dhe të tjerët k. Francës*, [DH.M.], nr. 24846/94 dhe 34165/96 34173/96, 57 § e vijues, GJEDNJ, 28.10.1999, *Anagnostopoulos dhe të tjerët k. Greqisë*, nr. 39374/98, § 20-21, GJEDNJ, 7.11.2000,

³³¹ Shih *Azienda Agricola Silverfunghi SAS dhe të tjerë k. Italisë*, nr. 48357/07, 52677/07 dhe 52687/07, § 76 dhe 82, GJEDNJ, 24.06.2014.

³³² Shih *Scordino* (Nr. 1). Shih edhe ligjin shqiptar për kthimin dhe kompensimin e pronave 2015.

³³³ Vendim i 18.02.1999. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 19.02.1999 në lidhje me çështjen *Cable dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*.

gjykatat ushtarake në këtë rast nuk ishin në përputhje me kërkesat e Konventës për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Ajo kujtoi në këtë kuadër vendimin e saj në lidhje me çështjen *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*³³⁴ ku ajo konstatoi se një gjykatë ushtarake ishte në kundërshtim me nenin 6 § 1 “duke pasur parasysh rolin themelor që luante oficeri akuzues i cili ishte i lidhur ngushtë me autoritetet e prokurorisë, kishte një rang më të lartë se anëtarët e trupit gjykues dhe kishte kompetencë, pavarësisht se në situata të veçanta ta shpërbënte gjykatën ushtarake dhe të refuzonte njohjen e vendimit të saj”. Në çështjen *Sadak dhe të tjerë kundër Turqisë*³³⁵ dhe në një sërë çështjesh të tjera Gjykata mori në shqyrtin dhe madje konstatoi shkelje në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e Gjykatave për Sigurinë Kombëtare. Me shqetësim të veçantë në këto raste u vlerësua fakti se gjyqtarët ushtarakë merrnin pjesë në procese penale kundër civilëve në raste që nuk kishin aspak të bënin me rregullat e brendshme në forcave të armatosura.³³⁶ Një rast tjetër është ai kur ekzekutivi ndërhy në ekzekutimin e një vendimi, përfundimtar ose të ndërmjetëm të një gjykate të brendshme, ose edhe ndërkombëtare. Dy vendime kundër Shqipërisë e nxjerrin qartë në pah problemin që ekziston në Shqipëri në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit nga ekzekutivi³³⁷.

Një gjykatë nuk është e pavarur, nga ana tjetër, edhe në qoftë se ajo pranon si të detyrueshëm për të një mendim ose këshillë të dhënë nga ana e qeverisë në formën e një traktati, dispozitat e të cilit

³³⁴ Vendim i 25.02.1997.

³³⁵ Vendim i 17.07.2001. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

³³⁶ Shih gjithashtu *Incal k. Turqisë*, nr. 41/1997/825/1031, GJEDNJ, 9.06.1998, §§ 65 dhe 67-73 në lidhje me ngritjen dhe garantitë e këtyre gjykatave dhe *Ibrahim Gurkan k. Turqisë*, nr. 10987/10, § 17-20, GJEDNJ, 3.07.2012, në lidhje me përbërjen e gjykatave ushtarake.

³³⁷ Shih *Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10613/16, GJEDNJ, 11.1.2018 ku Këshilli i Ministrave iu kundërvu një vendimi të ndërmjetëm të Gjykatës Administrative të Vlorës. Shih sidomos paragrafët 92-97. Gjykata shprehet se ky veprim i Qeverisë Shqiptare “e privoi nenin 6 § 1 nga çdo pasojë e dobishme” Shih gjithashtu vendimin *Rrapo k. Shqipërisë*, nr. 58555/10, GJEDNJ, 25.09.2012 që kishte të bënte me mosrespektimin e një vendimi të ndërmjetëm të Gjykatës së Strasburgut. Në këtë çështje Gjykata gjeti shkelje të nenit 34 të Konventës. Megjithëse ky i fundit kishte të bënte me vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Strasburgut, e njëjta logjikë vepron.

ajo duhet të interpretoj³³⁸. Në çështjen *Sramek kundër Austrisë*³³⁹, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6 të Konventës mbi bazën e faktit që gjykata nuk ishte e pavarur përderisa përfaqësuesi i qeverisë në këtë proces ishte edhe eprori hierarkik i relatorit në këtë çështje³⁴⁰.

b. paanësia

Paanësia e gjykatës është një element i rëndësishëm i nocionit të shtetit ligjor. Ajo ka për qëllim, në një shoqëri demokratike, ku qytetarët dhe në veçanti të pandehurit duhet të kenë besim tek gjykatat.³⁴¹ Për këtë qëllim, Gjykata ka theksuar që në vitet e hershme të aktivitetit të saj se “drejtësia jo vetëm që duhet dhenë por ajo duhet edhe të shihet që është dhënë”³⁴². Pandaj edhe shfaqja është e rëndësishme për të krijuar dhe mbajtur besimin e gjyqësorit tek publiku. Garantimi i paanësisë ka të bëjë me të gjithë llojet e gjykatave, duke përfshirë ato që përfshijnë juritë, dhe të gjitha nivelet e juridiksionit.³⁴³ Paanësia nënkupton që gjykata nuk ka paragjykimë dhe nuk është e njëanshme në lidhje me çështjen ose qëndrimet e saj nuk mbahen në mënyrë që përfundimi i çështjes të shkojë në favor të ndonjëres nga palët në proces³⁴⁴. Në vlerësimin e faktit nëse gjykatat e brendshme kanë qenë apo jo të paanshme, Gjykata përdor dy teste, atë objektiv dhe atë subjektiv. Ajo është shprehur se ndërsa në shumicën dërrmuese të rasteve që ngrinin

³³⁸ Shih vendimin e saj të vitit 1994 në lidhje me çështjen *Beaumontin k. Francës*, Seria A, nr. 296 - B.

³³⁹ Vendim i Gjykatës i 22.10.1984, Seria A, nr. 84.

³⁴⁰ Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 23.04.1987 në lidhje me çështjen *Ettl k. Austrisë*, Seria A, nr. 117 në të cilën gjykata u konsiderua se ishte “e pavarur” pavarësisht nga prania në trupin gjyqësor e funksionarëve të shërbimit civil.

³⁴¹ Shih *Sander k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34129/96, § 22, GJEDNJ, 9.05.2000.

³⁴² Shih *Delcourt k. Belgjikës*, 17.01.1970, série A, nr. 11, fq. 17, § 31, *De Cubber k. Belgjikës*, nr. 9186/80, § 26, GJEDNJ, 26.10.1984, *Oleksandr Volkov dhe Ukrainës*, nr. 21722/11, § 106, GJEDNJ, 9.01.2013

³⁴³ Shih *Pullar k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22399/93, § 32, GJEDNJ, 10.06.1996, dhe *De Cubber k. Belgjikës*, nr. 9186/80, § 32, GJEDNJ, 26.10.1984.

³⁴⁴ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1982 në lidhje me çështjen *Piersack k. Belgjikës*, Seria A, nr. 53, *Kyprianou k. Qipros* [D.H.M.], nr. 73797/01, § 118-119, GJEDNJ, 2005, *Driza k. Shqipërisë*, nr. 33771/02, § 74, GJEDNJ, 13.11.2007.

çështjet e paanshmërisë, ajo është përqendruar në testin objektiv³⁴⁵ “nuk ekziston ndarje e qartë midis paanësisë subjektive dhe objektive pasi sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të ngrejë dyshime objektive në lidhje me paanshmërinë nga këndvështrimi i një vëzhguesi të jashtëm (testi objektiv), por mund të prekë gjithashtu çështje të bindjes së tij ose të saj personale (testi subjektiv)...”³⁴⁶. Në rast se ka prova bindëse për paanësi, qoftë objektive qoftë subjektive, gjyqtari ose anëtari i jurisë duhet të tërhiqet nga gjykimi i çështjes konkrete³⁴⁷.

i. Paanësia objektive

Në kuadrin e testit objektiv, ajo që analizohet është që, pavarësisht nga qëndrimi personal i një gjyqtari, ekzistojnë fakte që hedhin dyshime mbi paanshmërinë e tij. Çështja është pra nëse frika ose dyshimi i një kërkuesi që një gjyqtar nuk është i paanshëm mund të justifikohet apo jo objektivisht³⁴⁸. Ky test përdoret më shumë jo vetëm sepse është më i lehtë për tu identifikuar por edhe për tu provuar në raport me testin subjektiv³⁴⁹. Prandaj dhe ky test vesh një rëndësi të veçantë. Në kuadrin e testit objektiv mund të merren në shqyrtim lidhjet hierarkike apo të tjera ndërmjet gjyqtarit dhe aktorëve të tjerë në procedurë ose personave të interesuar për procedurën³⁵⁰. Sidoqoftë, nëse këto kushte janë përmbushur apo jo varet nga rrethanat e secilit rast konkret dhe shpeshherë një analizë tërësore e rrethanave është vendimtarja³⁵¹.

³⁴⁵ Shih *Micallef k. Maltës*, i lartpërmendur, § 95

³⁴⁶ Shih *Kyprianou k. Qipros* [DH.M.], nr. 73797/01, § 119, GJEDNJ, 2005-XIII, dhe *Micallef k. Maltës*, i lartpërmendur, § 93, ECHR 2009, *Morice k. Francës*, [DH.M.], nr. 29369/10 § 75, GJEDNJ, 23.04.2015.

³⁴⁷ Shih *Piersack kundër Belgjikës, Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës, De Cubber kundër Belgjikës, Hauschildt kundër Danimarkës, Padovani kundër Italisë*, të lartpërmendur, si dhe *Castillo Algar k. Spanjës*, nr. 28194/95, § 45, GJEDNJ, 28.10.1998, *Micallef k. Maltës*, [DH.M.], nr. 17056/06, § 98, GJEDNJ, 15.10.2009.

³⁴⁸ Shih paragrafin 30 të vendimit të Gjykatës të 24.02.1993 në lidhje me çështjen *Fey k. Austrisë*, Seria A, nr. 2655 - A, vendimin e 16.09.1999 në lidhje me çështjen *Buscemi k. Italisë* si dhe vendimin e 28 nëntorit 2002 në lidhje me çështjen *Lavents k. Letonisë*.

³⁴⁹ Shih *Pullar k. Mbretërisë së Bashkuar*, 10.06.1996, § 32, Raportet e Vendimeve 1996-III.

³⁵⁰ Shih *Kley n dhe të tjerë k. Holandës*, [DH.M.] nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, GJEDNJ, 6.05.2003, *Morice k. Francë*, [DH.M.] nr. 29369/10, § 77, GJEDNJ, 2015, *Mitrov k. Ish Republikës Jugosllave e Maqedonisë*, nr. 45959/09, GJEDNJ, 2.06.2016, *Kamenos k. Qipros*, nr. 147/07, § 99, GJEDNJ, 31.10.2017.

³⁵¹ Shih *Kristiansen k. Norvegjisë*, nr. 1176/10, GJEDNJ, 17.12.2015, ku Gjykata, paragrafin

Shembujt e mëposhtëm japin idenë se në cilat raste mund të shfaqen probleme.

Një pjesë e madhe e çështjeve me karakter penal që janë paraqitur përpara Gjykatës me pretendimin e paanësisë kanë pasur të bëjnë me anshmërinë e një gjyqtari i cili kishte marrë pjesë gjithashtu në marrjen e vendimeve në lidhje me masat e sigurimit. Kështu për shembull, në çështjen *Hauschildt kundër Danimarkës*³⁵², gjyqtari që kishte marrë pjesë në marrjen e vendimit për vendosjen e kërkuesit në gjendje arresti, e kishte marrë këtë vendim me arsyetimin se kishte “një dyshim veçanërisht të konfirmuar” që kërkuesi kishte kryer një krim. Gjykata vendosi se fakti që një gjyqtar ka marrë vendime të mëparshme në lidhje me masat e sigurimit çon në një “dyshim të legjitimuar” në lidhje me paanësinë e tij në mungesë të “rrethanave të posaçme”. Në këtë çështje u vendos për një shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak të faktit se vendimi në lidhje me masat e sigurimit të kërkuesit kishte kërkuar praktikisht që gjyqtari në fjalë të ishte fare pranë marrjes së një vendimi të ndërmjetëm për fajësinë e tij, e cila përbënte një “rrethanë të posaçme”³⁵³. Po ashtu, nëse i njëjti person, pasi ka shërbyer si prokuror në një çështje, thirret për të gjykuar si gjyqtar po në të njëjtën çështje, dyshimet e të akuzuarit për paanshmërinë e tij janë objektivisht të justifikuara³⁵⁴. Në të njëjtin përfundim arrihet edhe për një person që është marrë me hetimin e një çështje dhe pastaj gjykon si gjyqtar në atë çështje³⁵⁵.

Gjithashtu, përbën shkelje të nenit 6 § 1 situata kur, një proces

61 të vendimit, arriti në përfundimin se kishte shkelje duke analizuar “efektin kumulativ të faktorëve të përmendur më sipër – përmbajtja e deklaratave, koha e tyre, vendimi për të mos shkarkuar Jose l’u jepeshin instruksione anëtarëve të jurisë- përbënin arsye të justifikueshme për të dyshuar mbi paanësinë e Gjykatës së Lartë...”.

³⁵² Shih më lart.

³⁵³ Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 22.04.1994 në lidhje me çështjen *Saraiva de Carvalho k. Portugalisë*, Seria A, r. 268 - B; shih në 18 European Human Rights Reports 354, si dhe vendimin e saj të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Padovani k. Italisë*, Seria A, nr. 257 - B.

³⁵⁴ Shih *Piersack k. Belgjikës*, i lartpërmërdur, § 30.

³⁵⁵ Shih *Tierce dhe të tjerët k. San Marinos*, nr. 24954/94, 24971/94 dhe 24972/94, § 83, GJEDNJ, 25.06.2000.

penal zhvillohet në një gjykatë në të cilën punon si gjyqtare edhe mamaja e viktimës. Kjo situatë ngre dyshime objektivist të justifikuar për të gjithë atë juridiksion dhe vetëm arsye të forta mund ta justifikojnë³⁵⁶.

Megjithatë, thjesht fakti se një gjyqtar ka marrë pjesë më parë në gjykimin e disa çështjeve kundër të bashkëakuzuarve të një kërkuesi nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi paanësinë e një këtij gjyqtari në gjykimin e çështjes kundër kërkuesit.³⁵⁷ Në vendimin *Berhani kundër Shqipërisë*³⁵⁸, Gjykata pranoi argumentin e Qeverisë se nuk kishte pasur shkelje të paanësisë kur, dy nga tre gjyqtarët, të cilët vendosën mbi themelin në rastit të ankuesit, më parë kishin hedhur poshtë kërkesën e tij për mosrespektim të afateve, pra pa u shprehur mbi themelin³⁵⁹.

Gjykata ka marrë gjithashtu nën shqyrtim edhe paanësinë e gjykatave civile dhe administrative. Sipas saj është në kundërshtim me parimin e paanësisë të parashikuar nga ana e nenit 6 që një gjyqtar të kryesojë një trup gjykues i cili po merr në shqyrtim një vendim të ankuar të të njëjtit gjyqtar në shkallë të parë³⁶⁰. Në vendimin e 13 nëntorit 2007 në çështjen *Driza kundër Shqipërisë*³⁶¹, Gjykata, duke analizuar testin objektiv të paanshmërisë, vlerësoi se përbërja e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë përbëhej nga gjashtë gjyqtarë, të cilët kishin marrë pjesë edhe në trupat gjyqësorë të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë që kishin dhënë vendimet e mëparshme në rastin e kërkuesit. Për këtë arsye Gjykata

³⁵⁶ *Shih Mitrov k. Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, i lartpërmendur. Shih edhe *Sigurðsson k. Islandës*, nr. 39731/98, 10.04.2003.

³⁵⁷ *Shih Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rusisë*, nr. 11082/06 dhe 13772/05, § 544, GJEDNJ, 25.07.2013.

³⁵⁸ *Berhani k. Shqipërisë*, nr. 847/05, GJEDNJ, 27.05.2010.

³⁵⁹ Krahasoje këtë përfundim me vendimin *Fazli Aslaner k. Turqisë*, nr. 36073/04, GJEDNJ, 4.03.2014, në të cilin Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 për shkak të pjesëmarrjes në një trup gjykues prej tridhjetë e një gjyqtarësh edhe të tre gjyqtarëve që kishin marrë pjesë ndërkohë më përpara në procedurën e të njëjtës çështje dhe kishin mbajtur një qëndrim mbi vetë problemin që duhej vendosur. Gjykata i kushtoi gjithashtu rëndësi faktit që nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të justifikuar këtë pjesëmarrje dhe sidomos kryesimin e trupit gjykues nga një prej këtyre tre gjyqtarëve.

³⁶⁰ Shih vendimin e Gjykatës të 26.08.1997 në lidhje me çështjen *De Haan k. Hollandës*.

³⁶¹ *Driza k. Shqipërisë*, e lartpërmendur.

gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës nën këndvështrimin e testit objektiv të pavarësisë. Në çështjen *Lanborger kundër Suedisë*³⁶², Gjykata vendosi se prania në një sallë gjyqi e ekspertëve të cilët përfaqësonin pronarët e tokave dhe shoqatat qiramarrëse jepnin shkak për të dyshuar për një “anshmëri të mundshme” përderisa të dyja shoqatat kishin një interes në lidhje me rezultatin e çështjes. Për këtë arsye sipas Gjykatës kishte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Kërkesa e paanshmërisë zbatohet po ashtu edhe ndaj jurive, në vendet ku sistemi i drejtësisë është organizuar edhe mbi një organizëm të tillë. Në çështjen *Holm kundër Suedisë*³⁶³, Gjykata vendosi se kishte një shkelje të nenit 6 për shkak se anëtarët e jurisë ishin anëtarë të një partie politike me të cilën ishte i lidhur njëri nga të paditurit. Po ashtu edhe në çështjen *Remli kundër Francës*³⁶⁴, Gjykata konstatoi shkelje të kërkesës për një gjykatë të paanshme, për shkak të mosreagimit të plotë të një gjyqtari ndaj një deklaratë të bërë nga ana e një prej anëtarëve të jurisë duke u shpallur si racist³⁶⁵, edhe kur komentet me karakter racist mund të shprehen në formën e një shakaje³⁶⁶. Edhe kur në juri ka persona që e njohin viktimën dhe bëjnë komente mbi personalitetin e tij, mund të ngrihen dyshime objektivisht të bazuara mbi paanësinë e këtij anëtari të jurisë³⁶⁷.

ii. Paanësia subjektive

Në kuadrin e testit subjektiv, thelbi është që çdo gjyqtar duhet ta shqyrtojë dhe vendosë një çështje të caktuar që i paraqitet pa asnjë paragjykim. Duhet thënë që është tepër i vështirë për t'u

³⁶² Vendim i Gjykatës i 22.06.1989, Seria A, nr. 155; shih në 12 European Human Rights Reports 416.

³⁶³ Vendim i Gjykatës i vitit 1993, Seria A, nr. 279; shih në 18 European Human Rights Reports 79.

³⁶⁴ Vendim i Gjykatës i 23.04.1996; shih në 22 European Human Rights Reports 253.

³⁶⁵ Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 25.02.1997 në lidhje me çështjen *Gregory k. Mbretërisë së Bashkuar*.

³⁶⁶ Shih *Sander k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34129/96, i lartpërmendur, §§ 23 dhe 29, GJEDNJ, 9.05.2000.

³⁶⁷ Shih *Kristiansen k. Norvegjisë*, i lartpërmendur.

realizuar nga ana e një kërkuesi që ky të arrijë të tregojë se ka pasur paragjykim ose njëanshmëri të gjyqtarit ose gjyqtarëve në dëm të tij. Pra, çështja është nëse mund të tregohet në bazë të fakteve që një gjyqtar “ka vepruar në mënyrë të njëanshme” kundër kërkuesit³⁶⁸. Vështirësia qëndron gjithashtu në faktin se, për shkak të vetë funksionit të tij një gjyqtar prezumohet të jetë subjektivisht i paanshëm. Megjithatë ky prezumim është i kundërshtueshëm³⁶⁹, por vetëm kur arrihet të tregohet me prova bindëse dhe jo thjesht indicie³⁷⁰. Të njëjtat parime gjejnë zbatim edhe për juritë në sistemet juridike që e njohin këtë procedurë³⁷¹. Gjykata ka kujtuar se “përsa i përket testit subjektiv, ... diskrecioni që kërkohet nga autoritetet gjyqësore kur ata duhet të gjykojnë, duhet t’i bëjë ata të mos përdorin shtypin, madje as t’i përgjigjen provokimeve; kështu e kërkojnë nevojat e larta të drejtësisë dhe prestigji i funksionit gjyqësor. Në veçanti, fakti që Presidenti ose një gjyqtar i një gjykate që duhet të vendosin mbi një çështje, përdorin publikisht shprehje që nënkuptojnë një vlerësim negativ të pretendimeve të një prej palëve, është e papajtueshme me kërkesat për paanshmëri të çdo gjykate, të sanksionuar në nenin 6 § 1 të Konventës”.³⁷²

Kështu për shembull në vendimin e lartpërmendur *Driza k. Shqipërisë*, Gjykata konstatoi se pjesëmarrja në trupën gjyqësore e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili kishte filluar personalisht procedurën e rekursit në interes të ligjit³⁷³ e cila çoi në prishjen e një vendimi të mëparshëm të Gjykatës së Lartë në favor të kërkuesit, nuk respektonte testin e pavarësisë subjektive sipas

³⁶⁸ Shih vendimin e 24.05.1989 në lidhje me çështjen *Hauschild k. Danimarkës*, Seria A, nr. 154; shih në 12 European Human Rights Reports 266.

³⁶⁹ Shih *Fey k. Austri*, nr. 14396/88, § 28, GJEDNJ, 24.02.1993, *Akademia Trading Ltd dhe të tjerë k. Greqisë*, nr. 30342/96, § 43, GJEDNJ, 4.04.2000, *Piersack k. Belgjikës*, nr. 8692/79, i lartpërmendur, 30 §, GJEDNJ, 1.10.982, *Padovani k. Italisë*, nr. 13396/87 § 26, GJEDNJ, 26.02.1993, *Kyprianou k. Qipros*, [DH.M.], nr. 73797 /01, GJEDNJ, 15.12.2005.

³⁷⁰ Shih *Academy Trading Ltd. dhe të tjerë k. Greqisë*, i lartpërmendur, § 44, ku Gjykata pa u zgjatur hodhi poshtë pretendimet e kërkuesve për anshmëri subjektive disa anëtarë të Gjykatës së Kasacionit.

³⁷¹ Shih *Sander k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34129/96, § 25, 9.05.2000, *Remli k. Francës*, nr. 16839/90, § 46, GJEDNJ, 23.04.1996.

³⁷² Shih *Buscemi kundër Italisë*, nr. 29569/95, §§ 67-68, ECHR 1999-VI, *Lavents k. Letonisë*, nr. 58442/00, §§ 117-119, GJEDNJ, 28.11.2002. Shih edhe në L. Bianku.

³⁷³ Procedurë e parashikuar nga ish neni 451 i Kodit të Procedurës Civile në versionin në fuqi më 1996. Kjo procedurë u abrogua me Ligjin nr. 8812 të 17 majit 2001.

nenit 6 § 1. Prandaj, Gjykata gjeti një shkelje, në të dyja testet³⁷⁴, të paanshmërisë së Gjykatës Supreme në përcaktimin e të drejtave të pronësisë së kërkuesit.

III. Garanci procedurale

A. Barazia e procedurës

a. *parimi i kontradiktoritetit*

Në mënyrë që të jenë në përputhje me nenin 6, procedurat gjyqësore duhet të respektojnë parimin e kontradiktoritetit³⁷⁵. Kjo është një garanci themelore e procesit të drejtë³⁷⁶. Si koncept ai është mjaft i afërt me atë të barazisë së mjeteve në një proces gjyqësor që do shqyrtojmë në vijim. Parimi i kontradiktoritetit është një koncept autonom që mbulon një gamë të gjerë të të drejtave procedurale si në proceset civile ashtu edhe penale. E drejta për procedura që respektojnë kontradiktoritetin nënkupton në parim “të drejtën e palëve në një proces që të marrin dënim në lidhje me çdo provë ose pretendim që i paraqitet gjyqtarit, me qëllim që të ndikojë në vendimin e tij, dhe ta diskutojnë atë³⁷⁷. Me fjalë të tjera, parimi i kontradiktoritetit synon të forcojë besimin e palëve ndërgjyqëse në funksionimin e drejtësisë, për të siguruar interesat e tyre dhe për të garantuar të drejtën e tyre për t’u shprehur çdo pjesë e dosjes.³⁷⁸ Ky parim vlen jo vetëm për vëzhgimet e paraqitura nga palët, por edhe për ato të dorëzuara nga një magjistrat i pavarur³⁷⁹, nga një gjykatë

³⁷⁴ Shih konkluzionin më sipër për testin objektiv.

³⁷⁵ Shih nenin 18 të Kodit të Procedurës Civile.

³⁷⁶ Shih *Kamasinski k. Austrisë*, nr. 9783/82, § 102, GJEDNJ, 19.12.1989.

³⁷⁷ Shih *inter alia* vendimin e Gjykatës të 20.02.1996 në lidhje me çështjen *Vermelen k. Belgjikës* si dhe vendimin tjetër të saj të 18.02.1997 në lidhje me çështjen *Niderost Huber k. Zvicrës*, në 25 European Human Rights Reports 709, *Lobo Machado k. Portugalisë*, nr. 15764/89 § 31, GJEDNJ, 20.02.1996, *Kress k. Francës*, § 74, GJEDNJ, 7.06.2001, *Morel k. Francës*, nr. 34130/96, § 27, GJEDNJ, 6.06.2000, *Ruiz-Mateos k. Spanjës*, nr. 12952/87, § 63, GJEDNJ, 26.06.1993.

³⁷⁸ Shih *Niderost-Huber k. Zvicrës*, nr. 18990/91, § 29-30, GJEDNJ, 1.02.1997.

³⁷⁹ Shih vendimin e 25 qershorit 1997 në çështjen *Van Orshoven kundër Belgjikës*, në të cilën paditësi në një proces me karakter administrativ përpara gjykatave belge nuk pati mundësi që t’u përgjigjej pretendimeve të bëra nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm në seancë gjyqësore. Gjykata konstatoi se parimi i kontradiktoritetit ishte shkelur në atë çështje.

që ka dhenë vendimin që kundërshtohet³⁸⁰, nga një administratë, ose ekspertë apo agjenci financiare³⁸¹. Por nga ana tjetër, kjo e drejtë nuk gjen zbatim në lidhje me dokumente që nuk paraqiten nga një palë, megjithëse mund të ndikojnë në marrjen e vendimit. Të tilla janë për shembull propozimet ose projekt-vendimet e gjyqtarëve ose juristëve relatorë në një çështje, dokumente që janë të brendshme dhe i nënshtrohet sekretit të vendim-marrjes³⁸². Ai nuk gjen zbatim, në parim, as për zbulimin e identitetit dhe raporteve nga agentët e infiltruar për shembull³⁸³. Një gjyqtar duhet të jetë shumë i kujdesshëm në respektimin e parimit të kontradiktoritetit, sidomos kur zgjidh një mosmarrëveshje në bazë të një argumenti ose të një përjashtimi të ngritur *ex officio*³⁸⁴.

Në çështjen *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*³⁸⁵ Gjykata e Apelit kishte vendosur që të dënonte kërkuesit për ndihmë dhe mbështetje për një falimentim, e cila nuk ishte vepra penale për të cilën ata ishin akuzuar, pa i dëgjuar argumentat e palëve në lidhje me këtë pikë. Gjykata arriti në përfundimin se e drejta e kërkuesve për t'u informuar në hollësi në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur ndaj tyre si dhe e drejta e tyre për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes ishin shkelur. Gjykata ka konstatuar shkelje të këtij parimi edhe në rastet kur një të akuzuari, i cili dëshironte të përfaqësohej vetë në seancë, iu refuzua nga ana e prokurorit këqyrja e dosjes gjyqësore dhe marrja e kopjeve të dokumenteve të përmbaheshin në të, dhe për këtë arsye ai nuk ishte në gjendje të përgatiste një mbrojtje adekuate³⁸⁶. Çështja *Slimane-Kaïd kundër Francës*³⁸⁷ kishte të bënte

³⁸⁰ Shih *Gramaxo Rozeira k. Portugalisë*, nr. 21976/09, § 31, GJEDNJ, 21.01.2014.

³⁸¹ Shih *Zagrebacka Banka D.D. k. Kroacisë*, nr. 39544/05, § 201 dhe 202, GJEDNJ, 12.12.2013.

³⁸² Shih *Marc-Antoine k. Francës*, nr. 54984/09, § 31, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 4.06.2013. megjithatë krahasojë me *Slimane-Kaïd k. Francës*, të referuar më poshtë.

³⁸³ Shih *Van Wesenbeeck Belgjikës*, nr. 67496/10 dhe 52936/12, 68 § e vijues, GJEDNJ, 23.05.2017. Shih *mutatis mutandis* në lidhje me dëshmitë e të penduarve, *Habran dhe Dalem k. Belgjikës*, nr. 43000/11 dhe 493801/11, § 101 e vijues, GJEDNJ, 17.01.2017.

³⁸⁴ Shih *Çepëk k. Republikës Çeke*, nr. 9815/10 § 45, GJEDNJ, 5.09.2013

³⁸⁵ Vendim i Gjykatës i 25.03.1999.

³⁸⁶ Vendim i Gjykatës i 18.03.1997 në lidhje me çështjen *Foucher k. Francës*; shih në 24 European Human Rights Reports 234.

³⁸⁷ Vendim i 26.01.2000.

me mosvënien në dijëni të kërkuesit ose të avokatit të tij të raportit të gjyqtarit relator, raport që ishte vënë në dispozicion të Avokatit të Përgjithshëm në një proces përpara Gjykatës së Kasacionit.

b. barazia e mjeteve

Parimi i barazisë së mjeteve, që siç e thamë më sipër ngjan shumë me parimin e kontradiktoritetit që sapo trajtuam, kërkon gjithashtu që çdo pale në proces t'i jepen mundësi të mjaftueshme për të parashtruar pretendimet e veta në lidhje me çështjen, por për më tepër, kjo duhet të bëhet në kushte të tilla që nuk e vënë atë në një pozitë më pak të favorshme sesa ajo e palës tjetër. Pra, nuanca në raport me konceptin e trajtuar më sipër është se parimi i barazisë së mjeteve nënkupton “një ekuilibër të drejtë” ndërmjet palëve në një proces. Thelbi dhe ajo që duhet theksuar është se parimi i barazisë është pjesë përbërëse e konceptit të gjykimit të drejtë. Ashtu si edhe parimi i kontradiktoritetit mbulon të gjithë ligjin procedural të Shteteve Kontraktuese dhe zbatohet që nga faza e njoftimit të palëve mbi aktet gjyqësore³⁸⁸ dhe zbatohet si në çështjet penale ashtu edhe në ato civile³⁸⁹.

Kështu për shembull gjatë procesit penal në ngarkim të katër kërkuesve në çështjet *Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Fitt kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁹⁰, prova me rëndësi themelore nuk i ishin vënë në dispozicion palës së akuzuar me justifikimin e mbrojtjes së interesit publik. Në çështjen e *Rowe dhe Davis*, prokurori në bazë të ligjit të zbatueshëm në atë kohë, pa dijeninë ose miratimin e gjyqtarit, vendosi që këto prova të mos bëheshin të njohura as për mbrojtjen. Gjykata e shpreh se “nën dritën e kërkesave të nenit 6 § 1, prokuroria duhet t'i bëjë të njohur mbrojtjes të gjitha provat materiale që ka në dispozicion në favor ose kundra të akuzuarit

³⁸⁸ Shih *Avotinš k. Letonisë*, [DH.M.], nr. 17502/07, § 119, GJEDNJ, 23.05.2016.

³⁸⁹ Shih *Dombo Beheer B.K. k. Holandës*, nr. 14448/88, § 33, GJEDNJ, 27.10.1993, *Werner k. Austrisë*, nr. 138/1996/757/956, § 63, GJEDNJ, 24.11.1997.

³⁹⁰ Vendimi në lidhje në lidhje me këto tre çështje u dha nga Gjykata më 16.02.2000.

dhe se vështirësitë me të cilat haset pala mbrojtëse duhet të baraspeshohen në mënyrë të kënaqshme në kuadrin e procedurave të ndjekura nga autoritetet gjyqësore” dhe arriti në përfundimin se një procedurë e tillë nuk ishte në pajtim me kërkesat e së drejtës për një gjykim të drejtë. Ndërsa kur ndodhën ngjarjet e çështjeve *Fitt dhe Jasper*, ligji kishte ndryshuar. Sipas rregullimit të ri, prokurori duhet t’i bënte një kërkesë gjyqtarit të çështjes që ku të autorizonte mosbërjen të njohur të provave në fjalë. Niveli i informacionit që i ishte dhënë kërkuarit varej nga kategoria e informacionit. Gjykata vuri në dukje se në secilin rast mbrojtjes i ishte thënë se ishte bërë kërkesa për autorizimin nga gjyqtari dhe në çështjen e z. Fitt iu ishte treguar kategoria e informacionit si dhe një përmbledhje e tij. Duke pasur parasysh këto rrethana dhe duke vlerësuar se kishte qenë gjyqtari i çështjes ai që kishte marrë në shqyrtim gjatë procesit gjyqësor nevojën për të bërë të njohura apo jo informacionet përkatëse, gjë që përbënte një garanci shtesë, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6³⁹¹. Megjithatë parimi është që në çështjet penale, “*nuk është e drejtë që organi i akuzës t’i paraqesë një gjykatë pretendime pa dijeninë e palës së akuzuar*”³⁹². Përveç kësaj, për të respektuar barazinë e mjeteve, të akuzuarve duhet t’u jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur në mënyrë efektive versionin e tyre të fakteve përpara gjykatave të brendshme³⁹³.

Parimi i barazisë së mjeteve gjen zbatim gjithashtu në lidhje me proceset civile dhe sidomos në mosmarrëveshjet ndërmjet personave privatë, “*kërkon që secilës palë t’i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta në kushte që nuk e vendosin në një situatë disavantazhi të qartë në raport me kundërshtarin e tij*”³⁹⁴.

³⁹¹ Shih gjithashtu vendimet e Gjykatës të 27.04.2000 në lidhje me çështjen *Kuopila k. Finlandës*, të 28.07.2001 në lidhje me çështjen *F.R. k. Zvicrës*, të 20 dhjetorit 2001 në lidhje me çështjen *Buchberger k. Austrisë*, të 21.02.2002 në lidhje me çështjen *Ziegler k. Zvicrës*, të 5 dhjetorit 2002 në lidhje me çështjen *Craxi k. Italisë* (Nr. 2) dhe të 26.02.2002 në lidhje me çështjen *Frette k. Francës*.

³⁹² Shih *Bulut k. Austrisë*, nr. 17358/90, § 49, GJEDNJ, 22.02.1996.

³⁹³ Shih *Kasparov dhe tjetër k. Rusisë*, nr. 21613/07, 58 § e vijues, GJEDNJ, 3.10.2013.

³⁹⁴ Shih *Dombo Beheer B.K. k. Holandës*, i lartpërmendur, § 33, *Kress k. Francës*, [D.H.M.], nr. 39594/98, § 72, GJEDNJ, 7.06.2001, *Khrabrova k. Rusisë*, nr. 18498/04, § 39 e vijues, GJEDNJ, 2.10.2012.

Parimi i barazisë është shkelur për shembull në rastet kur njëra palë nuk ishte lejuar t'u përgjigjej pretendimeve me shkrim që i kishte paraqitur gjykatës së brendshme avokati që vepronte për llogari të shtetit³⁹⁵. Në çështjen *Dombo Beheer kundër Holandës*, të sapo cituar, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak se kërkuesi nuk u lejua që të thërriste për të dëshmuar një dëshmitar që ai e mendonte të rëndësishëm ndërkohë që pala tjetër ishte lejuar ta bënte një gjë të tillë. Në çështjen *Ankerl kundër Zvicrës*³⁹⁶, nga ana tjetër, Gjykata nuk konstatoi shkelje të parimit të barazisë së mjeteve në lidhje me një refuzim nga ana e një gjykate zvicerane që të lejonte bashkëshorten e kërkuesit që të jepte një dëshmi, duke u betuar, në mbështetje të pretendimit të kërkuesit. Megjithëse pala tjetër kishte pasur mundësi që të thërriste për të dëshmuar nën betim një dëshmitar të vetin, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk ishte vënë në sajë të këtij fakti në një dizavantazh themelor³⁹⁷. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata vlerësoi se mungesa e neutralitetit të një eksperti të caktuar nga gjykata kompetente mundet në disa raste të shkaktojë shkelje të parimit të barazisë së mjeteve³⁹⁸.

Parimi i barazisë së mjeteve konsiderohet se shkelet edhe në rastet ku organi ligjvënës i një shteti anëtar miraton një legjislacion që synon të sigurojë hedhjen poshtë të një pretendimi civil të një pale, pretendim që është ndërkaq në gjykim e sipër në gjykatat e brendshme³⁹⁹.

c. pranimi i provave

Një numër i konsiderueshëm rastesh kanë qenë përqendruar mbi

³⁹⁵ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Ruiz Mateos k. Spanjës*, *Seria A*, nr 262; shih në 16 *European Human Rights Reports* 505.

³⁹⁶ Vendim i Gjykatës i 23.10.1996. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 24.02.1997 në lidhje me çështjen *De Haes dhe Gijssels k. Belgjikës*.

³⁹⁷ Dëshmia e dëshmitarit të thirrur nga pala tjetër nuk u mor shumë për bazë nga ana e gjykatës zvicerane edhe për faktin se ajo ishte bazuar vetëm në betimin e tij.

³⁹⁸ Shih *Sara Lind Eggertsdottir k. Islandës*, nr. 31930/04, § 47, *GJEDNJ*, 5.07.2007, *Pla k. Italisë*, nr. 48754/11, § 74, *GJEDNJ*, 21.01.2014.

³⁹⁹ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1994 në lidhje me çështjen *Greek Refineries dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, *Seria A*, Nr. 301; shih në 19 *European Human Rights Reports* 293.

faktin nëse ka pasur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 § 1 si pasojë e pranimi të disa provave në procedurat përpara gjykatave të brendshme⁴⁰⁰. Gjykata ka pranuar që pranimi i provave është në radhë të parë një çështje që rregullohet nga e drejta e brendshme dhe si rregull u përket gjykatave të brendshme që të vendosin në lidhje me marrjen e provave nga ana e tyre. Detyra e Gjykatës në bazë të Konventës nuk është që ato të vendosin nëse provat apo deklaratat e dëshmitarëve janë pranuar apo jo në mënyrën e duhur nga ana e gjykatave të brendshme, por të verifikojë nëse procedurat gjyqësore në tërësinë e tyre, përfshirë edhe mënyrën në të cilën ishin marrë provat, ishin të drejta apo jo⁴⁰¹. Analiza e bërë në këtë seksion në lidhje me provat është e vlefshme edhe në lidhje me analizën që bëhet në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës, me të cilin do merremi më vonë, i cili ka të bëjë me pyetjen e dëshmitarëve në një proces penal. Prandaj edhe në vendimet e Gjykatës fenomeni trajtohet shpesh së bashku nën nenin 6 § 1 dhe 6 § 3 (d) të Konventës.

Në çështjen *Schenk kundër Zvicrës*⁴⁰² Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me marrjen si provë nga një gjykatë e brendshme të një regjistrimi audio të bërë në mënyrë të paligjshme e cila përbënte një provë akuzuese kundër kërkuesit. Gjykata e argumentoi vendimin e saj në bazë të faktit që pala e akuzuar kishte qenë në gjendje ta kundërshtonte marrjen parasysh të kësaj prove dhe se kishte pasur prova të tjera që mbështesnin pretendimin për dënimin e të akuzuarit. As në çështjen *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁴⁰³, sipas Gjykatës, nuk kishte pasur

⁴⁰⁰ Shih gjithashtu Nenin 6 § 3 (d) në lidhje me çështjet kur pala akuzuese ka parashtruar deklaratat të bëra nga persona të cilët nuk mund të dalin si dëshmitarë në një çështje të caktuar.

⁴⁰¹ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 23.04.1997 në lidhje me çështjen *Van Mechelen dhe të tjerë k. Hollandës*, shih në 25 European Human Rights Reports 647 si dhe në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur. Shih gjithashtu *Pelissier dhe Sassi k. Francës*, [DH.M.], nr. 25444/94, § 45, GJEDNJ, 25.03.1999, *Jalloh, i lartpërmendur*, § 95; *Bykov, i lartpërmendur*, § 89, *Taxquet k. Belgjikës* [DHM], nr. 926/05, § 84, ECHR 2010; dhe *Schatschaschwili k. Gjermanisë* [DHM], nr. 9154/10, § 101, GJEDNJ 2015.

⁴⁰² Shih në Seria A, nr. 140, si dhe në 13 European Human Rights Reports 242.

⁴⁰³ Vendim i 12.05.2000.

shkelje të nenit 6 në lidhje me përdorimin e provave që ishin marrë në kundërshtim me nenin 8. Në çështjen *Teixero de Castro kundër Portugalisë*⁴⁰⁴, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 6 për shkak se kërkuesi kishte qenë dënuar kryesisht mbi bazën e deklaratave të bëra nga ana e oficerëve të paignifikuar të policisë të cilët edhe e kishin shtyrë atë që të kryente veprën penale për të cilën ai akuzohej. Ajo shtoi që interesi publik nuk mund të justifikonte marrjen për bazë të provave të ofruara si pasojë e nxitjes së policisë për kryerjen e veprës penale⁴⁰⁵. Në çështjen *Brennan kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁴⁰⁶ nuk kishte pasur shkelje në lidhje me përdorimin si prova në proces të pohimeve që ishin bërë në prani të policisë dhe në mungesë të një avokati⁴⁰⁷.

Pra, duket që Gjykata i kushton rëndësi të veçantë në këtë kontekst faktit nëse kërkuesi ka pasur mundësi të vërë në dyshim vërtetësinë e provave dhe të kundërshtojnë përdorimin e tyre⁴⁰⁸. Ajo i kushton sidomos rëndësi elementit nëse provat në fjalë kishin pasur një ndikim vendimtar në procedurën penale⁴⁰⁹.

Një analizë veçanërisht e kujdesshme i kushtohet nga Gjykata situatave kur provat janë marrë si pasojë e torturës ose keqtrajtimeve. Gjykata është përballur me këtë problem kompleks në një sërë çështjesh, përfshirë edhe në *Dhomë të Madhe*⁴¹⁰. Ajo ka theksuar se përdorimi i provave të marra nëpërmjet torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues ndikon në karakterin e drejtë të procedurës penale si tërësi, pavarësisht nga vlera provuese e provës

⁴⁰⁴ Vendim i 9.06.1998.

⁴⁰⁵ *Ibid.* në paragrafin 36.

⁴⁰⁶ Vendim i 16.10.2001 Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁴⁰⁷ Shih gjithashtu vendimin e 27.02.2001 në lidhje me çështjen *Lucà k. Italisë*.

⁴⁰⁸ Shih *Erkapic k. Kroacisë*, nr. 51198/08, § 78, GJEDNJ, 25.04.2013.

⁴⁰⁹ Shih *Gäfgen k. Gjermanisë*, [DH.M.], nr. 22978/05, § 164. GJEDNJ, 1.06.2010.

⁴¹⁰ Shih sidomos *Gäfgen k. Gjermanisë*, i lartpërmendur.

konkrete⁴¹¹. Në vendimin *Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*⁴¹², gjykata u shpreh se pranimit si provë nga ana e gjykatave të brendshme e deklaratave të bëra nga kërkuesi i parë si rezultat i torturës përbënte shkelje të nenit 6 § 1, përderisa një deklaratë e bërë në kushte të tilla e bën gjithmonë në tërësi procedurën të padrejtë. Ajo gjeti shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me provat kundër kërkuesit të dytë, të cilat ishin treguar nga kërkuesi i parë si pasojë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3, Gjykata vlerësoi se procesi gjyqësor ndaj kërkuesit të dytë, në tërësinë e tij, ishte i padrejtë për shkak të pranimit dhe përdorimit të tyre për fajësimin e kërkuesit të dytë.

Ajo ka arritur madje të shprehet se edhe mundësia që një sistem ligjor krijon që në procesin penal ndaj një personi që i përdoren provat e marra nën torturë, përbën mohim flagrant të drejtësisë⁴¹³.

Gjykata është përpjekur gjithsesi të kodifikojë elementët që janë përcaktues, sidomos në lidhje me administrimin e provave dhe dëshmimeve, veçanërisht në kontekstin penal. Në paragrafin 274 të vendimit të lartpërmendur *Ibrahim dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe identifikoi këto elementë:

- a) pozita apo jo e brishtë e personave në proces, sidomos kërkuesit, për shkak të moshës, shëndetit, etj.;
- b) kuadri ligjor që rregullon procedurat paraprake dhe atë të pranueshmërisë së provave në gjykim, dhe nëse ajo është respektuar;
- c) mundësinë e kërkuesit për të kundërshtuar vërtetësinë e

⁴¹¹ Shih *Ors dhe të tjerët k. Turqisë*, nr. 46213/99, § 60, GJEDNJ, 20.06.2006, *Soylemez k. Turqisë*, nr. 46661/99, § 107 dhe 122-124, GJEDNJ, 21.09.2006, *Gogmen k. Turqisë*, nr. 72000/01, §§ 73 dhe 74, GJEDNJ, 17.10.2006, *Harutyunyan k. Armenisë*, nr. 36549/03, §§ 63, 64 dhe 66, GJEDNJ, 28.06.2007, *Levința k. Moldavisë*, nr. 17332/03, §§ 101, 104-105, GJEDNJ, 16.12.2008, *Stanimirović k. Serbisë*, nr. 26088/06, 18 October 2011, *Iordan Petrov k. Bulgaria*, nr. 22926/04, 24.01.2012; *Grigoryev k. Ukraine*, nr. 51671/07, 15 May 2012; *Hajnal k. Serbisë*, nr. 36937/06, 19.06.2012, *Turbytevo k. Rusisë*, nr. 4722/09, § 90, GJEDNJ, 6.10.2015.

⁴¹² Shih *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë nr. 33192/07 dhe 33194/07*, §§ 114-130, GJEDNJ, 25.06.2013. Shih L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁴¹³ Shih *Othman (Abu Qatada) k. the United Kingdom*, nr. 8139/09, 17 January 2012. Shih L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur....

- provave dhe përdorimin e tyre;
- d) cilësia e provave, rrethanat në të cilat janë marrë, dhe besueshmëria e tyre;
 - e) paligjshmëria eventuale e provave dhe dëshmime;
 - f) në rastin e një deklarate eventuale, natyra e saj dhe nëse ajo u tërhoq apo u ndryshua menjëherë.
 - g) mënyra e përdorimit të provave;
 - h) nëse fajësia është vlerësuar nga gjyqtarë profesionistë apo nga juri.
 - i) interesi publik në hetimin dhe ndëshkimi i veprës penale në fjalë.
 - j) masat e tjera përkatëse procedurale të parashikuara nga ligji dhe praktika e brendshme⁴¹⁴

Ky katalog, shërben si udhërrëfytes në lidhje me marrjen dhe administrimin e provave në proceset penale, kur gjyqtarët vendas dhe ata të Strasburgut, bëjnë vlerësimin që ngelet gjithmonë konkret, sipas rastit të caktuar⁴¹⁵.

d. prania në proces dhe e drejta për t'u dëgjuar personalisht

E drejta e secilës palë në një proces për t'u dëgjuar personalisht është një element tjetër i rëndësishëm i nocionit të procesit të drejtë sipas nenit 6 § 1. Kjo e drejtë është e rëndësishme dhe ka lidhje me garancitë dhe fazat e procedurës që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe akoma më tepër e rëndësishme kur këtë vlerësim gjykatat e bëjnë në seancë me dyer të mbyllura⁴¹⁶. Ajo shfaqet si garanci e kombinuar qoftë me këto që sapo përmendëm qoftë edhe me të drejtën për t'u mbrojtur vetë për të cilën do flasim në vijim në kuadrin e garancive në procesin penal. E drejta për tu dëgjuar

⁴¹⁴ Shih gjithashtu vendimin e Dhomës së Madhe të 12.05.2017, *Simeonovi k. Bullgarisë*, nr. 21980/04, § 120.

⁴¹⁵ Shih *O'Halloran dhe Francis k. the Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nos. 15809/02 dhe 25624/02, § 53, ECHR 2007-III, dhe *Ibrahim dhe të tjerë*, të lartpërmendur.

⁴¹⁶ Shih *Serrano Contreras k. Spanjës*, nr. 49183/08, § 37 e vijues, GJEDNJ, 20.03.2012, *Denk k. Austrisë*, nr. 23396/09, vendim komiteti, § 18, GJEDNJ, 5.12.2013.

personalisht gjen zbatim edhe në çdo fazë apeli kur një gjykatë “shqyrton një çështje mbi themelin dhe mbi ligjin dhe procedon me një vlerësim të përgjithshëm të fajësisë apo të pafajësisë, ajo nuk mund të vendosë mbi këtë çështje pa vlerësuar drejtpërdrejt provat e paraqitura personalisht nga i akuzuari [...] nga parimi i mbajtjes së seancave publike rrjedh e drejta e të akuzuarit për tu dëgjuar personalisht nga gjykatat e apelit. Nga kjo pikëvështrimi, parimi i karakterit publik të seancave ndjek qëllimin që t’i sigurojë të akuzuarit të drejtat e tij të mbrojtjes”.⁴¹⁷

Duket se jurisprudenca e Gjykatës sugjeron që në çdo proces gjyqësor ku elementët personalë të njërës nga palët dhe sidomos të të akuzuarit në proces penal kanë peshë në marrjen e vendimit, dëgjimi personalisht i palës merr vlerë të veçantë. Kështu për shembull në rastin e *De Tommaso kundër Italisë*⁴¹⁸, Gjykata u shpreh se ishte e nevojshme një seancë publike, duke pasur parasysh që gjykatat vendase duhet të merrnin në konsideratë elemente të tilla si personaliteti i aplikantit, sjellja dhe rrezikshmëria e tij, të cilat ishin vendimtare për zbatimin e masës parandaluese. Në çështjen *Cani kundër Shqipërisë*, të lartpërmendur, Gjykata u shpreh se e drejta për tu dëgjuar personalisht merr rëndësi edhe për shkak të elementëve të tillë si të tilla si “keqardhja e një të akuzuari pas krimit, mungesa e dënimeve të mëparshme penale, prejardhja e tij dhe vështirësitë ekonomike të familjes”⁴¹⁹. Për Gjykatën këto janë të gjitha çështjet për të cilat, për sa i përket drejtësisë, ai duhet të ishte dëgjuar personalisht. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata kërkon gjithashtu që edhe personat e burgosur që janë pjesë të procedurave civile të dëgjohen personalisht.⁴²⁰ Kjo e drejtë gjen zbatim edhe në të drejtën civile, ku gjykata ve në balancë mundësitë procedurale që kanë pasur palët për të ndikuar mbi vendimin gjyqësor⁴²¹. Një kujdes i veçantë thotë Gjykata iu duhet kushtuar

⁴¹⁷ Shih *Tierce dhe të tjerët k. San Marinos*, nr. 24954/94, 24971/94 dhe 24972/94, § 95, GJEDNJ, 25.07.2000.

⁴¹⁸ Shih *Tommaso k. Italisë*, [DH.M.], nr. 43395/09, 167. GJEDNJ, 23.02.2017.

⁴¹⁹ Shih *Cani k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, § 63.

⁴²⁰ Shih *Yevdokimov dhe të tjerët k. Rosisë*, nr. 27236/05,44223/05 dhe të tjerët, § 32 e vijues, GJEDNJ, 16.02.2015.

⁴²¹ Shih *Martinie k. Francës*, [DH.M.], nr. 58675/00, GJEDNJ, 12.04.2006.

të miturve, të cilët kur përfshihen në procedura gjyqësore dhe sidomos penale, duhet të trajtohen duke marrë parasysh moshën, pjekurinë, kapacitetin mendor dhe gjendjen psikike, në mënyrë që ai të mund të kuptojë procedurën dhe pjesëmarrjen në të⁴²².

Gjykata ka pranuar se mund të ketë edhe përjashtime nga e drejta për t'u dëgjuar personalisht. Situata më e zakonshme është ajo që ka të bëjë me mungesën e njëres apo të dy palëve në procesin gjyqësor. Një palë në një çështje civile ose penale mund të mos e shfrytëzojë të drejtën e tij për të qenë prezent në një seancë me gojë por duhet pasur parasysh që refuzimi "të jetë shprehur në një mënyrë të qartë" dhe "që gjithsesi të ketë në seancë garancitë minimale në përputhje me rëndësinë e saj"⁴²³. Këtë aspekt do ta trajtojmë në detaje në lidhje me gjykimet në mungesë në procesin penal. Një përjashtim tjetër që pranohet është ai kur një procedurë, kryesisht ajo përpara gjykatave me juridiksion vetëm mbi çështjet ligjore apo kushtetuese, siç është rasti i Gjykatave të Larta ose Kushtetuese⁴²⁴. Madje edhe përpara gjykatës së apelit e drejta e një personi për të marrë pjesë në seancat e çështjes së tij që zhvillohet në lidhje me apelimin e vendimit të shkallës së parë varet në qëllimin e procesit në këto shkallë të mëtejshme të gjykimet. Në qoftë se gjykata e apelit merr në shqyrtim vetëm çështje të ligjit, prania e vetë personit nuk do të jetë e nevojshme. Në qoftë se gjykata e apelit merr në shqyrtim fakte përveç çështjes së interpretimit të ligjit, nevoja e pjesëmarrjes së personit në seancë varet nga rëndësia që kjo seancë ka për të si dhe nga nevoja e gjykatës për praninë e tij për përcaktimin ose shpjegimin e fakteve të ndryshme⁴²⁵.

⁴²² Shih K. k. *Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24888/94, § 105 e vijues raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 4.12.1998.

⁴²³ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Poitrimol k. Francës*, Seria A, nr. 277 - A; shih në 18 European Human Rights Reports 130.

⁴²⁴ Shih *Fejde k. Suedisë*, nr. 12631/87, § 31, GJEDNJ, 29.10.1991, *K.D.B. k. Holandës*, nr. 80/1997/18641/075, § 39, GJEDNJ, 27.03.1998, *Keskinen dhe Veljekset Keskinen Oy k. Finlandës*, nr. 34721/09, § 33, GJEDNJ, 5.06.2012, *Salomonsson k. Suedisë*, nr. 38978/97, § 34, GJEDNJ, 12.11.2002.

⁴²⁵ Shih vendimin e Gjykatës të 25.03.1998 në lidhje me çështjen *Beliziuk k. Polonisë*, si dhe vendimin e saj të 29.10.1991 në lidhje me çështjen *Helmerts k. Suedisë*, Seria A, nr. 212; shih në 15 European Human Rights Reports 285.

e. e drejta për një vendim të arsyetuar

Neni 6 i Konventës kërkon gjithashtu që gjykatat e brendshme të japin arsytet për vendimin që ato kanë marrë. Edhe përse ky element nuk është parashikuar shprehimisht në Konventë, detyrimi i gjykatave vendase për të motivuar vendimet e tyre është konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata e Strasburgut. Ky aspekt ka rëndësi sepse mungesa e motivimit jo vetëm që mund të çojë në abuzime por edhe bën që të humbasë besimi i palëve dhe i publikut në procesin gjyqësor dhe është aspekt themelor i miradministrimit të drejtësisë⁴²⁶. Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit gjyqësor është i rëndësishëm në mënyrë që palët të mund edhe ta apelojnë vendimin përkatës⁴²⁷.

Përveç kësaj, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të gjithë elementët që kemi shqyrtuar deri tani, si qasja në gjykatë, barazia e mjeteve dhe kontradiktoriteti, pranimi i provave dhe i garancive që do shqyrtojmë në vijim nuk do kishin kuptim nëse argumentet dhe vëzhgimet e palëve nuk shqyrtohen siç duhet nga gjykata kompetente. Kjo do të thotë që *“neni 6 ngarkon gjykatën me detyrimin për të kryer një shqyrtim efektiv të pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, përveçse kur nuk i konsideron të rëndësishme”*⁴²⁸.

Detyrimi për të arsyetuar vendimet vetëm në lidhje me themelin e një çështje, por edhe për pjesën e shpenzimeve ose gjobave të dhëna për abuzim të së drejtës për padi.⁴²⁹

⁴²⁶ Shih *Hiroisaari k. Finlandës*, nr. 49684/99, §§ 30-33, 27.09.2001, Chevrol, §§ 76-84

⁴²⁷ Kjo e drejtë njihet specifikisht për çështjet penale por jo për ato civile. Shih nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës. Shih edhe *Hadjianastassiou k. Greqisë*, nr. 12945/87, § 33, GJEDNJ, 16.12.1992.

⁴²⁸ Shih *Van de Hurk k. Holandës*, nr. 16034/90, § 59, GJEDNJ, 19.04.1994, *Turizmi i biznesit k. Francës*, nr. 17814/10, § 25, GJEDNJ, 16.02.2012.

⁴²⁹ Shih *Francesco Quattrone k. Italisë*, nr. 13431/07, § 44, GJEDNJ, 26.11.2013.

Megjithatë kjo nuk do të thotë që një gjykatë është e detyruar që të japë një përgjigje të hollësishme në lidhje me çdo argument të pretenduar nga ana e secilës prej palëve. Por, megjithatë, në qoftë se një pretendim dhe argument në lidhje me provat ose me ligjin i ndonjëres prej këtyre është me rëndësi themelore për përfundimin e çështjes atëherë gjykata duhet ta vlerësojë atë në mënyrë të veçantë në arsyetimin e vendimit të vet⁴³⁰.

Gjykata ka treguar një lloj fleksibiliteti në lidhje me këtë aspekt të nenit 6 duke pasur parasysh edhe sistemet e ndryshme ligjore që ajo mbulon. Pyetja nëse një gjykatë kombëtare ka përbushur detyrimin për të motivuar vendimet vlerësohen në dritën e rrethanave të secilës çështje⁴³¹. Kështu për shembull në lidhje me sistemet ligjore që parashikojnë juri për të shprehur vendimin e fajësisë apo jo në proceset penale Gjykata ka treguar një lloj tolerance të kuptueshme⁴³².

Një element tjetër që lidhet me atë të arsyetimit të vendimeve, por edhe me parimin e sigurisë juridike është ai i vendimeve kontradiktore të gjykatave të brendshme, në lidhje me të njëjtat dispozita dhe zbatimin e tyre në situata praktikisht të njëjta, madje edhe në lidhje me të njëjtën situatë⁴³³. Megjithatë për të arritur

⁴³⁰ Shih *Hiro Balani k. Spanjës*, Seria A, nr. 303 - B; në 19 European Human Rights Reports 565, 15.04.1994, *Ruiz Torija k. Spanjës*, nr. 18390/91, § 29 dhe 30, GJEDNJ, 9.12.1994, *Georgiadis k. Greqisë*, nr. 21522/93, § 43, GJEDNJ, 29.05.1997 *Helle k. Finlandës*, 19.12.1997, në 26 European Human Rights Reports 159.

⁴³¹ Shih *Hiro Balani k. Spanjës*, nr. 18064/91, § 27, GJEDNJ, 9.12.1994, *Garcia Ruiz k. Spanjës*, [DH.M.], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ, 21.01.1999, *Carlan k. Roumanisë*, nr. 34828/02, § 34, GJEDNJ, 20.04.2010, *Ferreira Alves k. Portugalisë [nr.4]*, nr. 41870/05, § 3, GJEDNJ, 14.04.2009.

⁴³² Shih *Taxquet k. Belgjikës*, [DH.M.], nr. 926/05, § 89, GJEDNJ, 16.11.2010, *Agnelet k. Francës*, nr. 61198/08, § 56 e vijues, GJEDNJ, 10.01.2013, *Fraumens k. Francës*, nr. 30010/10, § 34 e vijues, GJEDNJ, 10.01.2013, *Oulahcene k. Francës*, nr. 44446/10, § 40 e vijues, GJEDNJ, 10.01.2013, *Lhermitte k. Belgjikës*, [DH.M.], nr. 34238/09, § 74 e vijues, GJEDNJ, 29.11.2016.

⁴³³ Shembulli më i mirë, ndoshta edhe më flagrant, është vendimi *Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 9074/07, 23.03.2010, ku Gjykata konstatoi se ish-in kryer tri seri procedimesh mbi thelbësisht të njëjtën çështje - ligjshmërinë e të njëjtës leje ndërtimi. Këto procedura arrinin në konkluzione kontradiktore, përfshirë edhe vetë Gjykatën e Lartë, dhe vazhduan për një periudhë pothuajse dhjetëvjeçare. Në këto kushte, Gjykata konstatoi një shkelje të parimit të sigurisë juridike të garantuar me nenin 6 për shkak të mungesës së arsyetimeve të qëndrueshme në vendimet e gjykatave të brendshme. Shih *Ştefăniacă dhe të tjerët k. Rumanisë*, nr. 38155/02, § 37, GJEDNJ, 2.11.2010.

në përfundimin nëse ka shkelje të parimit të sigurisë ligjore në rrethana të tilla Gjykata analizon nëse konfliktet jurisprudenciale janë serioze dhe afatgjata dhe nëse ekziston një mekanizëm për të korigjuar një situatë të tillë dhe nëse mekanizmi në fjalë është përdorur në mënyrë efektive në rastin konkret⁴³⁴.

B. Transparenca e procedurës

a. Seancat publike dhe pjesëmarrja e medias

Neni 6 § 1 kërkon shprehimisht që çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë në seancë publike ose thënë ndryshe – me dyer të hapura⁴³⁵. Mbjajtja e seancave me dyer të hapura është një parim themelor i cili i mbron palët nga një administrim sekret i drejtësisë pa një “mbikëqyrje” publike dhe që synon krijimin e besimit të publikut tek pushteti gjyqësor dhe tek gjykimi i drejtë⁴³⁶. E drejta për një seancë publike përfshin në vetvete të drejtën për një “seancë me gojë” përveçse kur ka rrethana të jashtëzakonshme të cilat justifikojnë mos-mbjajtjen e një seance të tillë⁴³⁷. Kjo e drejtë presupozon para së gjithash që palët në proces duhet të jenë rregullisht të informuara për mbajtjen e seancës, në mënyrë që të përgatiten, të jenë të pranishme dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre për të marrë efektivisht pjesë në seancë⁴³⁸.

⁴³⁴ Shih *Mullai dhe të tjerët k. Shqipërisë, i lartpërmendur, Iordan Iordanov dhe të tjerët k. Bullgarisë*, nr. 23530/02, § 49, GJEDNJ, 2.07.2009, *Schwarzkopf dhe Tausik k. Republikës Çeke*, nr. 42162/02, vendim mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 2.12.2008, *Spaseski dhe të tjerë k. ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 15905/07, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 27.09.2011, ku Gjykata pranon se harmonizimi i praktikës gjyqësore mund të kërkojë një kohë të caktuar.

⁴³⁵ Shih, GJEDNJ, 23.02.1994, *Fredin k. Suedisë* [Nr. 2], nr. 18928/91, §§ 21 dhe 22, GJEDNJ, 15.03.2005, *Yakovlev k. Rusisë*, nr. 72701/01, § 21., GJEDNJ, 24.10.2017, *Eker k. Turqisë*, nr. 24016/05, § 23.

⁴³⁶ Shih *Pretto dhe të tjerët k. Italisë*, nr. 7984/77, § 21 GJEDNJ, 08.12.1983, *Axen k. Gjermanisë*, nr. 8273/78, § 25, GJEDNJ, 08.12.1983, *Sutter k. Zvicrës*, nr. 8209/78, § 26, GJEDNJ, 22.02.1984, *Diennet k. Francës*, nr. 18160/91, § 33, GJEDNJ, 26.09.1995, *Gautrin dhe të tjerët k. Francës*, nr. 38/1997/8221/025-1028.9 § 42, GJEDNJ, 20.05.1998, *Werner k. Austrisë*, nr. 138/1996/757/956, 45, GJEDNJ, 24.11.1997.

⁴³⁷ Vendim i Gjykatës i 26.04.1995 në lidhje me çështjen *Fischer k. Austrisë*, Seria A, nr. 312; shih në 20 European Human Rights Reports 349 si dhe vendimin e saj të 19.02.1998 në lidhje me çështjen *Allan Jacobsson k. Suedisë* (Nr. 2).

⁴³⁸ Shih *Yakovlev k. Rusisë*, i lartpërmendur, GJEDNJ, 15.03.2005, *Shandrov k. Rusisë*, nr. 15093/05, 28 § e vijues, GJEDNJ, 15.03.2011, *Vorobyev k. Rusisë*, nr. 15722/05, GJEDNJ, 1.10.2012.

Në analizën e saj në lidhje me publicitetin e procedurës Gjykata merr parasysh rregullat procedurale dhe praktikat e ndryshme gjyqësore në lidhje me mënyrat se si vihet në zbatim parimi i karakterit publik të seancave. Ajo thekson se për të arritur në përfundimin nëse publiciteti i një procedure të rregulluar nga një shtet i caktuar respekton apo jo objektin dhe qëllimin e nenit 6 § 1, duhen pasur parasysh natyra dhe karakteristikat e procedurës në fjalë, të marra si një e tërë⁴³⁹.

Karakterit publik i procesit është veçanërisht i rëndësishëm në çështjet penale, në të cilat Gjykata ka thënë se “zakonisht duhet të ketë një gjykatë të shkallës së parë që përmbush plotësisht kërkesat e nenit 6 dhe [...] dhe para së cilës çdo i akuzuar mund të kërkojë në mënyrë legjitime që të “dëgjohet” dhe të përfitojë sidomos mundësinë e paraqitjes me gojë të mbrojtjes së tij, duke dëgjuar provat e prokurorisë, duke dëgjuar dëshmitë kundër tij, duke pyetur dhe kundërshtuar dëshmitarët”⁴⁴⁰. Gjykata ka thënë se mbajtja e një procesi penal në një vend paraburgimi, ku në parim publiku nuk ka qasje përbën një pengesë serioze për qëllimet e karakterit të saj publik. Në raste të tilla, Shteti ka detyrimin të marrë masa për të siguruar që publiku dhe media të informohen si duhet në lidhje me vendin e seancës dhe të kenë qasje në të⁴⁴¹.

Gjykata, në lidhje me çështje civile, ka treguar një lloj tolerance duke i lejuar palëve që të mos insistojnë në të drejtën për një gjykim publik, qoftë duke e shprehur këtë në mënyrë të qartë qoftë edhe të nënkuptuar⁴⁴². Gjykata është shprehur se vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me natyrën e pyetjeve të

⁴³⁹ Shih *Sutter k. Zvicrës*, nr. 8209/78, § 33, GJEDNJ, 22.02.1984.

⁴⁴⁰ Shih *Jussila k. Finlandës*, nr. 73053/01, § 40, GJEDNJ, 23.11.2006, *Flisar k. Sllovenisë*, nr. 3127/09, § 33, GJEDNJ, 29.09.2011, *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22107/93, § 79, GJEDNJ, 25.02.1997.

⁴⁴¹ Shih *Hummatov k. Azerbajxhanit*, nr. 9852/03, § 30, GJEDNJ, 29.11.2007.

⁴⁴² Shih vendimin e Gjykatës të 21.02.1990 në lidhje me çështjen *Hakasson dhe Sturesson k. Suedisë*, Seria A, nr. 171; shih në 13 European Human Rights Reports 1. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 30 nëntorit 1987 në lidhje me çështjen *H k. Belgjikës*; Seria A, nr. 127; shih në 10 European Human Rights Reports 399 si dhe vendimin e saj të 23.06.1981 në lidhje me çështjen *Le Compte k. Belgjikës*, Seria A, nr. 41; shih në 4 European Human Rights Reports 1.

paraqitura para gjyqtarit në kuadrin e procedurës në fjalë, mund të justifikojnë mosmbajtjen e një seance publike. Megjithatë në çështjen *Werner kundër Austrisë*⁴⁴³, Gjykata konstatoi një shkelle të nenit 6 për shkak se kërkuesi nuk kishte pasur një gjykim publik në lidhje me pretendimin e tij për kompensim si pasojë e një heqjeje së paligjshme të lirisë së tij. Megjithëse ai nuk kishte kërkuar shprehimisht një gjykim të tillë në lidhje me pretendimin e tij, ai nuk mund të thuhet se nuk e kishte shfrytëzuar mundësinë për një gjykim publik duke pasur parasysh se një gjë e tillë nuk parashikohej në bazë të së drejtës austriake⁴⁴⁴. Por nga ana tjetër, ajo ka pranuar se është e kuptueshme që në një fushë shumë teknike, të tilla si mosmarrëveshjet në lidhje me sigurimet shoqërore, autoritetet kombëtare, duke marrë parasysh nevojat e efikasitetit dhe kostove nuk organizojnë sistematikisht seanca publike⁴⁴⁵. Megjithatë, një procedurë “civile” mbi themelin që zhvillohet si rregull dhe plotësisht me dyer të mbyllura pa i krijuar mundësi një pale të kërkojë një seancë publike duke iu referuar veçorive të çështjes së tij, në parim nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me nenin 6 § 1 të Konventës⁴⁴⁶.

Është më se e vërtetë që neni 6 § 1 parashikon përjashtime nga parimi i seancave publike, sidomos në interes të moralit, rendit publik ose të drejtësisë si dhe kur e kërkojnë interesat e të miturve⁴⁴⁷, mbrojtjen e jetës private të palëve në gjykim ose interesat e drejtësisë. Megjithatë, këto përjashtime duhen interpretuar ngushtë dhe pas vlerësimit konkret të rrethanave të secilit rast. Gjykatat duhet të marrin në konsideratë veçanërisht nëse një përjashtim nga parimi i karakterit publik është i nevojshëm për mbrojtjen e një interesi

⁴⁴³ Vendim i 24 nëntorit 1997; shih në 26 European Human Rights Reports 310.

⁴⁴⁴ Shih gjithashtu vendimin e saj të 21.03.2000 në lidhje me çështjen *Rushiti k. Austrisë*, vendimin e 29.09.1999 në lidhje me çështjen *Serre k. Francës* e cila kishte të bënte me mungesën e një gjykimi me dyer të hapura në procedura me karakter disiplinor si dhe vendimin e 22.07.1999 në lidhje me çështjen *Scarth k. Mbretërisë së Bashkuar* e cila kishte të bënte me një seancë me dyer të mbyllura në një proces arbitrazhi.

⁴⁴⁵ Shih *Bocellari dhe Rizza k. Italisë*, nr. 399/02, § 36, GJEDNJ, 13.11.2007.

⁴⁴⁶ Shih *Martinie k. Francës*, [DH.M.], nr. 58675/00, § 42, GJEDNJ, 12.04.2006.

⁴⁴⁷ Shih vendimin *K. k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur.

publik dhe për të verifikuar nëse ky përjashtim kufizohet në atë që është e nevojshme për të arritur qëllimin e ndjekur⁴⁴⁸. Një refuzim i mbajtjes së një seance publike nga një gjykatë pa dhënë asnjë arsye mund të përbëjë shkelje të nenit 6 § 1⁴⁴⁹.

Përjashtime të tjera të justifikueshme janë ato kur kërkuesi ka pasur një gjykim të çështjes së tij me seanca publike në shkallë të parë dhe nuk është e nevojshme që seancat në gjykatën e apelit të jenë publike në rast se ato kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin e aspekteve ligjore dhe jo edhe të atyre faktike⁴⁵⁰. Një përjashtim tjetër është ai kur palët heqin dorë nga seancat publike. Megjithatë duhet që kjo dorëheqje, e shprehur ose e nënkuptuar, të jetë vullnetare, pa ekuivokë dhe nuk është kundër ndonjë interesi publik⁴⁵¹.

Ka pasur pak raste përpara Gjykatës në lidhje me përjashtimin e medias dhe të publikut *“në interes të moralit, të rendit publik ose të sigurimit kombëtar ... [ose] ...kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces, ose në shkallën që çmohet tepër e domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta natyra e publicitetit do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”* Duke pasur parasysh fleksibilitetin e vazhdueshëm të Gjykatës në lidhje me këtë fushë, mund të thuhet se një hapësirë e gjerë vlerësimi⁴⁵² do t'i lejohet përgjithësisht shtetit në zbatimin e kësaj kërkesë të Konventës. Megjithatë, Gjykata do të jetë pa dyshin e gatshme për të shqyrtuar

⁴⁴⁸ Shih *Luchaninova k. Ukrainës*, nr. 16347/02, § 58, GJEDNJ, 9.06.2011, *Elsholz k. Gjermanisë*, [DH.M.], nr. 25735/94, § 66, GJEDNJ, 13.07.2000, *Fazlıyski k. Bullgarisë*, nr. 40908/05, § 69, GJEDNJ, 16.04.2013, *Nikolova dhe Vandova k. Bullgarisë*, nr. 20688/04, 574, GJEDNJ, 17.12.2013.

⁴⁴⁹ Shih *Põnkä k. Estonisë*, nr. 64160/11, § 34 e vijues, GJEDNJ, 8.11.2016.

⁴⁵⁰ Shih vendimin e Gjykatës të 29.10.1991 në lidhje me çështjen *Helmers k. Suedisë*, Seria A, nr. 212; shih në 15 European Human Rights Reports 285. Shih nga ana tjetër vendimin e Gjykatës të vitit 1988 në lidhje me çështjen *Ekbatani k. Suedisë*, Seria A, nr. 134; Shih shih në 13 European Human Rights Reports 504) në të cilën Gjykata ishte e mendimin se një gjykim në gjykatën e apelit i cili vendoste për çështjen mbi bazë të fakteve dhe të ligjit duhet të ishte bërë i hapur për publikun.

⁴⁵¹ Shih *Schuler-Zraggen k. Zvicrës*, nr. 14518/89, § 58, GJEDNJ, 24.06.1993, *Pauger k. Austrisë*, nr. 16717/90, § 58, GJEDNJ, 28.05.1997.

⁴⁵² Në lidhje me një spjegim fare të shkurtër të doktrinës së hapërsirës së vlerësimit shih L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

bazat faktike të një përjashtimi të zbatimit të një kërkese tillë⁴⁵³.

b. Shpallja publikisht e vendimeve

Në ndryshim nga e drejta për të pasur një gjykim publik në lidhje me çështjen përkatëse, e drejta që vendimi të “jepet publikisht” nuk i nënshtrohet asnjë përjashtimi në kuadrin e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës⁴⁵⁴. Në çështjen *Pretto kundër Italisë*⁴⁵⁵, Gjykata vendosi që «*forma e publicitetit që duhet t'i jepet një “vendimi” ... duhet vlerësuar nën dritën e tipareve të veçanta të procesit në fjalë dhe duke mbajtur parasysh gjithmonë objektin dhe qëllimin e nenit 6 § 1.*» Në këtë çështje, depozitimi i vendimit në regjistrin e gjykatës së Kasacionit, gjë e cila e bënte të gjithë tekstin e tij të mundshëm për t'u lexuar nga çdokush, përmbushte sipas Gjykatës kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës⁴⁵⁶. Gjithashtu në rastet kur vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta kanë qenë shpallur publikisht, është konsideruar si e panevojshme që edhe vendimi i Gjykatës së Lartë të shpallet gjithashtu publikisht⁴⁵⁷.

Nga ana tjetër, edhe kur një gjykatë apeli e bën publik vendimin e saj i cili përmban një përmbledhje të vendimit të shkallës së parë që nuk është shpallur publikisht, garancia e publicitetit të vendimit është korrigjuar në apel për qëllimet e Gjykatës së Strasburgut.⁴⁵⁸ Gjykata pranon se qëllimi i parimit në fjalë është arritur, së paku

⁴⁵³ Shih për shembull vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*; shih në 7 European Human Rights Reports 165. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁴⁵⁴ Shih përsëri *Rushiti k. Austrisë* në poshtëshënimin e mësipërm 46.

⁴⁵⁵ Vendim i Gjykatës i vitit 1983, Seria A, nr. 71; shih në 6 European Human Rights Reports 182.

⁴⁵⁶ Ndërsa në vendimin e 22.02.1984 në lidhje me çështjen *Sutter k. Zvicrës*, Seria A, nr. 74 (shih në 6 European Human Rights Reports 272) përveçse mundësisë për ta parë në regjistrin përkatës pranë sekretarisë së gjykatës, vendimi gjithashtu botohej në një përmbledhje të jurisprudencës së gjykatës.

⁴⁵⁷ Shih vendimin e Gjykatës të 29.06.1982 në lidhje me çështjen *Axen k. Gjermanisë*, Seria A, nr. 72; 6 European Human Rights Reports 195. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 24 nëntorit 1997 në lidhje me çështjen *Szucs k. Austrisë*.

⁴⁵⁸ Shih *Lamanna k. Austri*, nr. 28923/95, § 33 dhe 34, GJEDNJ, 10.07.2001, shih edhe në L. Bianku, O. Kumbaro, lartpërmendur. Shih gjithashtu *Shmushkovych k. Ukrainës*, nr. 3276/10, 55 e vijues, GJEDNJ, 14.11.2013.

për Gjykatën e Kasacionit, me depozitën në regjistër, duke i lejuar të gjithë të kenë qasje në tekstin e plotë të aktgjykimit ose duke lexuar i kësaj të fundit në gjykatë të hapur⁴⁵⁹.

A. Kohëzgjatja e procedurës - Afati i arsyeshëm⁴⁶⁰

Paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës parashikon shprehimisht që gjykimi i drejtë kërkon që proceset gjyqësore të zhvillohen “brenda një afati të arsyeshëm”. Gjykata është shprehur se kjo kërkesë e nenit 6 § 1 tregon qartë rëndësinë që Konventa, ashtu si dokumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut⁴⁶¹, i kushtojnë miradministrimit të drejtësisë⁴⁶². Në të vërtetë, vonesat e tepërta në funksionimin e sistemit drejtësisë rrezikojnë efektivitetin e vetë sistemit dhe mund të çojnë edhe në mohim të drejtësisë⁴⁶³, siç thotë edhe aksioma e vjetër angleze që autorë të ndryshëm e venë në gojën e Jeremy Bentham “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”⁴⁶⁴. Kohëzgjatja e procedurave është një nga problemet me të cilin Gjykatës i është dashur të merret më shumë në Strasburg⁴⁶⁵. Garancia për gjykim të shpejtë në procedurat penale është e lidhur me të drejtën e lirisë, me

⁴⁵⁹ Shih *Pretto dhe tjetra k. Italisë*, nr. 7984/77, i lartpërmërdendur, § 27, GJEDNJ, 8.12.1983.

⁴⁶⁰ Shih edhe Frédéric Edel, Human Rights files no. 9, “*The length of civil and criminal proceedings in the case-law of the European Court of Human Rights*”, Council of Europe, 2007.

⁴⁶¹ Kjo e drejtë mishërohet në nenin 14 (3) (c) të KNDCP-së, në nenin 21 (4) (c) të Statutit të Jugosllavisë, në nenin 20 (4) (c) të Statutit të Ruandës dhe në nenin 67 (1) (c) të Statutit të GJNK-së, të cilët kërkojnë që gjyqet për akuza penale të zhvillohen pa vonesa të panevojshme dhe në nenin 7 (1) (d) të Kartës së Afrikës, në nenin 8 (1) të Konventës Amerikane, në nenin 6 (1) të Konventës Evropiane, të cilët kërkojnë që të gjithë gjyqet (për çështje penale ose të tjera) të zhvillohen brenda një kohe të arsyeshme.

⁴⁶² Shih *Maltzan [Freiherr Von] dhe të tjerët k. Gjermanisë*, nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, Vendimi mbi Pranueshmërinë, GJEDNJ, [DH.M.], 2.03.2005, § 132, *Raudsepp k. Estonisë*, nr. 54191/07, § 72, GJEDNJ, 08.11.2011, *Süssmann k. Gjermanisë*, nr. 20024/92, § 57, GJEDNJ, 16.09.1996.

⁴⁶³ Shih *Vernillo k. Francës*, nr. 11889/85, § 38, GJEDNJ, 20.02.1991, *Moreira de Azevedo k. Portugalisë*, nr. 11296/84, § 74, GJEDNJ, 23.10.1990, *Boddaert k. Belgjikës*, nr. 12919/87, § 39, GJEDNJ, 12.10.1992.

⁴⁶⁴ Shih edhe referencën 2, fq. 1 më lart tek Magna Carta si dhe Gjyqtarin Willes të Gjykatës Angleze të Panelit të Mbretit në çështjen *Whitham v Hill*, më 1759 ku shprehet se “*Ta vonosh drejtësinë dhe ta mohosh drejtësinë është e njëjta gjë sipas Magna Carta*”.

⁴⁶⁵ Shih Rekomandimin CM / Rec (2010) 3 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mjetet juridike efektive për zgjatje të tepërt të procedurave (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 24 shkurt 2010 në mbledhjen e 1077-të të zëvendësministrave).

prezumimin e pafajësisë dhe me të drejtën për t'u mbrojtur. Ajo synon të sigurojë që fati i një personi të akuzuar të përcaktohet pa vonesë të panevojshme. Ajo synon të sigurojë që mbrojtja e një personi të mos minohet nga zgjatje të parregullta kohe, gjatë të cilave kujtimi i dëshmitarëve mund të zbehet ose mund të shtrembërohet, dëshmitarët mund të mos gjenden më dhe dëshmitë e tjera mund të prishen ose të zhduken. Ajo gjithashtu synon të sigurojë që pasiguria me të cilën ndeshet një person i akuzuar dhe njolla që i ngjitet një personi të akuzuar për veprë penale, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, të mos jenë të zgjatura në kohë. Kjo garanci do të thotë që, përballë të drejtës të akuzuarit për kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, procedurat duhen filluar dhe gjykimi përfundimtar duhet dhënë pa vonesa të panevojshme. Kjo e drejtë i detyron autoritetet që të sigurojnë që të gjitha procedurat, nga fazat e paraprake deri tek vendimi më i fundit, të përfundohen dhe të jepen gjykimet brenda një kohe të arsyeshme.

Megjithëse barra për të vërtetuar se procedurat nuk janë zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme bie në përgjithësi mbi të akuzuarin, një person i akuzuar nuk ka përse të thotë se vonesa ka shkaktuar ndonjë paragjykim të veçantë.

Karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së procedurave varet nga rrethanat e veçanta të çështjes konkrete qoftë kjo me karakter penal apo jo. Për këtë arsye Gjykata nuk ka preferuar që të vendosë një afat maksimal me karakter absolut. Ashtu si edhe shumë nocione të tjera të Konventës edhe ai i kohëzgjatjes është një nocion autonom dhe Gjykata ka zhvilluar një sërë kriteresh për vlerësimin e kohëzgjatjes së procesit, duke filluar nga identifikimi i momenteve kyçe kohore për llogaritjen e kohëzgjatjes (a) dhe pastaj duke vazhduar me kompleksitetin e çështjes (b), sjelljen e autoriteteve (c), sjelljen e kërkuesit (d)

dhe rëndësinë e çështjes për vetë atë (e)⁴⁶⁶. Po përpiqemi t'i analizojmë shkurtimisht një nga një në vijim për të qartësuar sadopak interpretimin e nocionit të kohëzgjatjes në Strasburg.

a. periudha që merret në shqyrtim

Përpara se të fillojë analizën e kritereve të mirëfillta në gjykimin e pretendimeve për vonesë të procedurave gjyqësore, Gjykata përcakton së pari periudhën që ajo duhet të marrë për bazë, pra fillimi (*dies ad quo*) dhe fundi i procedurës përkatëse (*dies ad quem*).

- *Dies ad quo*

Në çështjet penale, momenti vendimtar është ai nga i cili kërkuesi është “akuzuar” sipas kuptimit të Konventës. Ky nocion gjithashtu ka një karakter autonom sipas Konventës dhe në lidhje me këtë pikë Gjykata është shprehur se:

“Gjykata nuk është e lidhur me kualifikimet e dhëna nga ligji i brendshëm, këto kanë vetëm një vlerë relative”⁴⁶⁷

Gjykata është përpjekur ta përkufizojë nocionin e akuzës sipas Konventës si “njoftimin zyrtar, të bërë nga një autorit kompetent, që e ngarkon me kryerjen e një vepre penale”⁴⁶⁸. Në rastet kur nuk ka pasur një njoftim të mirëfilltë zyrtar Gjykata ka adoptuar përjasjen

⁴⁶⁶ Shih Shih vendimin e Gjykatës të 6.05.1981 në lidhje me çështjen *Bucholz k. Gjermanisë*, Seria A, nr. 42; shih në 3 European Human Rights Reports 597. Shih gjithashtu X k. *Francës*, 31 March 1992, Series A nr. 234-C, p. 90, § 32, *Silva Pontes k. Portugalisë*, 23 March 1994, Series A nr. 286-A, p. 15, § 39, *Comingersoll S.A. k. Portugalisë* [GC], nr. 35382/97, § 19, ECHR 2000-IV, [DH.M.], 27.06.2000, *Frydlender k. Francës*, nr. 30979/96, § 43, *Vilho Eskelinen dhe të tjerë dhe të tjerë k. Finlandës* [GC], nr. 63235/00, § 67, ECHR 2007-II, dhe *Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, §§ 84-99, GJEDNJ, 01.04.2014.

⁴⁶⁷ Shih *Gäfgen k. Gjermanisë*, e lartpërmendur §§ 94 dhe 108, *Malige k. Francës*, nr. 27812/95, § 34, 23.09.1998; *Öztürk k. Gjermanisë*, nr. 22479/93, §§ 49-50, 21.02.1984.

⁴⁶⁸ Pra koha fillon të ecë që nga momenti kur kërkuesit i është bërë e ditur se ka filluar procedimi penal k. tij. Shih në lidhje me këtë çështjet *Schertenleib k. Zvicrës*, përpara Komisionit, në Decisions and Reports 17/180 si dhe vendimin e Gjykatës të 27.02.1980 në lidhje me çështjen *Deweer k. Belgjikës*, Seria A, nr. 5; shih në 2 European Human Rights Reports 439.

e “*pasojave të rëndësishme mbi situatën*” e të dyshuarit⁴⁶⁹. Kjo do të thotë që koha e fillimit të procedurës në çështjet penale mund të jetë “*një datë përpara fillimit të procedurës nga organi gjyqësor, sidomos ajo e arrestimit, akuzës ose fillimit të hetimit paraprak*”⁴⁷⁰. Si datë për fillimin e llogaritjes së afatit për qëllimet e kohëzgjatjes Gjykata ka konsideruar gjithashtu kontrollin e shtëpisë ose zyrës së kërkuesit, duke mbajtur parasysh ndikimin dhe pasojat që kishin pasur këto veprime në jetën profesionale të tij⁴⁷¹. Pra mund të thuhet se kjo periudhë fillon kur i dyshuari merr dijëni formalisht ose jo se autoritetet po ndërmarrin hapa specifikë për ta marrë në ndjekje penale.

Në çështjet civile koha fillon të ecë normalisht që me paraqitjen e kërkesë-padisë në gjykatën kombëtare. Megjithatë edhe kjo mund të varet nga natyra e çështjespasi në raste të caktuara koha mund të fillojë edhe para kësaj date⁴⁷². Kjo është veçanërisht e zakonshme në rastet ku sipas ligjit kombëtar, kërkuesit duhet të shterojnë ankimin administrativ përpara se ti drejtohen gjykatës. Në një rast të tillë, procedurat para organit administrativ duhet të përfshihen në llogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës për qëllimet e zbatimit të nenit 6⁴⁷³.

- *Dies ad quem*

Koha për qëllimet e përllogaritjes së kohëzgjatjes merr fund me përfundimin e procedurave të parashikuara me ligj në instancën më të lartë, vendimi i së cilës është i formës së prerë. Megjithatë

⁴⁶⁹ Ibid. Shih gjithashtu *Eckle k. Gjermanisë*, nr. 8130/78, § 73, GJEDNJ, 15.07.1982.

⁴⁷⁰ *Shih Hoze k. Hollandës*, nr. 81/1997/865/1076, § 43, GJEDNJ, 22.05.1998. Shih gjithashtu *Polz k. Austrisë*, nr. 24941/08, § 45, GJEDNJ, 25.10.2011.

⁴⁷¹ *Shih Diamantides k. Greqisë*, nr. 60821/00, § 21, GJEDNJ, 23.10.2003, *Stratumgjes dhe Communications dhe Dumoulin k. Belgjikës*, nr. 31370/97, § 42, GJEDNJ, 15.07.2002.

⁴⁷² *Shih Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, sidomos paragrafëin 88. *Shih gjithashtu Anogianakis k. Greqisë*, nr. 22510/09, vendim Komiteti, § 21, GJEDNJ, 12.06.2012, *Maorakis k. Greqisë*, nr. 21591/13, vendim komiteti, § 10, -, GJEDNJ, 7.09.2017.

⁴⁷³ *Shih persëri Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*, i lartpërmendur, § 89. *Shih gjithashtu Ichtagiarglou k. Greqisë*, nr. 12045/06, § 38, GJEDNJ, 19.06.2008, *Gletsos k. Greqisë*, nr. 58572/10, vendim komiteti, 20 §, GJEDNJ, 6.02.2014, *Georgakis k. Greqisë*, nr. 40279/14, vendim komiteti, § 23, GJEDNJ, 7.01.2016.

duhet theksuar përsëri se edhe në lidhje me këtë element natyra e çështjes luan një rol përcaktues. Kështu për shembull në çështjet penale periodha në fjalë përfundon, në parim, me marrjen ose me njoftimin, nëse ky është më i vonë, i vendimit i cili përcakton përfundimisht dëbimin, që mban parasysht, sipas rastit, periudhën e paraburgimit ose që jep dënimin në tërësi.⁴⁷⁴ Kurse në çështjet civile dhe administrative ky moment shtrihet deri në fazën e ekzekutimit të vendimeve përkatëse, situatë që ka rëndësi të veçantë për situatën shqiptare. Kujtojmë se më lart faza e ekzekutimit u analizua si pjesë përbërëse e nocionit të procesit të rregullt sipas kuptimit të Konventës. Gjykata është shprehur se vonesat që i atribuohen autoriteteve shtetërore në lidhje me ekzekutimin e një vendimi me karakter civil duhet të merren parasysht për qëllimin e afatit të arsyeshëm.⁴⁷⁵

Duhet theksuar se neni 6 § 1 i Konventës mund të jetë i ndryshëm në vlerësim nga neni 5 § 3 i saj. Kjo konsideratë e ndryshme mund të çojë në konstatimin e shkeljes së njërit apo të tjetrit veç e veç dhe jo domosdoshmërisht të të dyve bashkë, pavarësisht nga ngjashmëria ndërmjet tyre në pamje të parë. Kështu për shembull në çështjen *B. kundër Austrisë*⁴⁷⁶, kërkuesi u akuzua në korrik 1980 dhe u dënua në shkallën e parë në nëntor 1982. Gjykata nga ana e saj vlerësoi se kjo kohëzgjatje nuk përbënte shkelje të nenit 5 § 3. Megjithatë ankimi i tij në apel kundër vendimit që e kishte dënua nuk mori përgjigje deri në dhjetor 1995. Në lidhje me këtë kohëzgjatje Gjykata vlerësoi se ajo ishte zgjatur në mënyrë të pajustificueshme dhe kështu që përbënte shkelje të nenit 6 § 1.

Duhet theksuar gjithashtu që Gjykata e merr në shqyrtim kohëzgjatjen e procedurave duke filluar nga data që një Shtet palë

⁴⁷⁴ Shih *Eckle kundër Gjermanisë*, i lartpërmendur, § 76-77 si dhe *Polz k. Austrisë*, i lartpërmendur, § 45.

⁴⁷⁵ Shih *Estima Jorge k. Portugalisë*, nr. 16/1997/800/1003, § 35 e vijues, GJEDNJ, 21.04.1998. Shih gjithashtu pjesën më të madhe të vendimeve kundër Shqipërisë në çështjet penale, që nga Qufaj Sh.p.k. e deri tek Luli e të tjerë, të gjitha të lartpërmendura.

⁴⁷⁶ Vendim i Gjykatës i 28.03.1990, Seria A, nr. 175; shih në 13 European Human Rights Reports 20.

ka njohur të drejtën e ankimit individual, por mban gjithashtu parasysh edhe sa kohë ka kaluar deri në atë datë⁴⁷⁷. Pasi përcakton me saktësi periudhën që duhet të marrë në shqyrtim në çdo çështje më vete, madje në çdo procedurë më vete edhe brenda së njëjtës çështje, Gjykata analizon elementët vijues për të arritur në përfundimin nëse kriteri i gjykimit të drejtë është respektuar apo jo.

b. kompleksiteti i çështjes

Natyrisht që për të vlerësuar kohëzgjatjen e procedurave Gjykata nuk mund të anashkalojë një nga elementët që jo vetëm justifikojnë që një gjykatë e brendshme të marrë kohën e duhur për të shqyrtuar një çështje – pikërisht elementin e kompleksitetit. Për këtë qëllim Gjykata i referohet një numri faktorësh, të tillë si numri i të akuzuarve, akuzave apo seancave dëgjimore⁴⁷⁸, numri i madh i dëshmitarëve, vëllimi i rëndësishëm i dosjes, nevoja e pranisë së ekspertëve në shqyrtimin e çështjes⁴⁷⁹, zhvillimi paralel i dy ose më shumë procedurave penale⁴⁸⁰, ose i një procedure civile dhe i një procedure administrative⁴⁸¹, numri i vendimeve të marra në çështjen në fjalë⁴⁸², kualifikimi i vështirë ligjor i fakteve të tyre⁴⁸³, numri i kreditorëve dhe shumat e pretenduara në një procedurë falimentimi⁴⁸⁴, etj. Mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë së ligjit të zbatueshëm në një çështje mund ta bëjë të vështirë shqyrtimin e një çështje edhe kur vetë faktet nuk paraqesin ndonjë kompleksitet të veçantë. Megjithatë, Gjykata ka vendosur që këto

⁴⁷⁷ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 16 dhjetorit 1997 në lidhje me çështjen *Proszak k. Polonisë*.

⁴⁷⁸ Shih *Struc k. Moldavisë*, nr. 4013/09, § 79, GJEDNJ, 4.12.2012, *Shcherbakov dhe Rusisë* [nr. 2], nr. 34959/07, §§ 109 dhe 111, GJEDNJ, 24.10.2013,

⁴⁷⁹ Shih *Scopelliti k. Italisë*, nr. 15511/89, § 23, GJEDNJ, 23.11.1993.

⁴⁸⁰ Shih *Boddaert k. Belgjikës*, nr. 12919/87, §§ 36-39, GJEDNJ, 12.10.1992.

⁴⁸¹ Shih *Fergadioti-Rizaki k. Greqi*, nr. 27353/09, § 15, GJEDNJ, 18.04.2013.

⁴⁸² Shih *Stamouli k. Greqisë*, nr. 55862/07, § 25, GJEDNJ, 11.06.2009. Shih gjithashtu rreth zhvillimit paralel të procedurave të shpronësimit *Guillemin k. Francës*, nr. 19632/92, § 42, GJEDNJ, 21.02.1997.

⁴⁸³ Shih *Shoqata e Personave viktimat e S.K. Rompetrol S.A. dhe S.K. Geomin S.A. të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 24133/03, § 78, GJEDNJ, 25.06.2013.

⁴⁸⁴ Shih *Sedminek kundër Sllovenisë*, nr. 9842107, § 48, GJEDNJ, 24.10.2013.

mangësi të ligjit të cilat mund të kontribuojnë haptazi në zgjatjen kohëzgjatja e procedurës, i atribuohen tërësisht autoriteteve kombëtare⁴⁸⁵.

c. sjellja e autoriteteve

Kriteri i tretë që është pa dyshim ai ku Gjykata ndalet më me kujdes në analizën e saj është ai i qëndrimit që kanë mbajtur autoritetet në zhvillimin e një procesi të caktuar. Në të vërtetë autoritetet janë përgjegjëse jo vetëm për shkak të sjelljes së organeve gjyqësore por eventualisht të veprimit të të gjithë aparatit legjislativ, gjyqësor dhe administrativ⁴⁸⁶ që ato kanë ngritur ose duhet të ngrenë në këmbë për t'iu përgjigjur kërkesave për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm⁴⁸⁷. Kujtojmë që më lart theksuam se edhe faza e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfshihet në nocionin e procesit të rregullt, pra kohëzgjatja gjen zbatim edhe në këtë aspekt⁴⁸⁸. Kjo kërkon që për të shmangur problemet të duhet të vlerësohen masa legjislative, administrative madje edhe financiare⁴⁸⁹. Në veçanti në lidhje me funksionimin e gjyqësorit neni 6 i detyron Shtetet që ta organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në një mënyrë të tillë që gjykatat të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e saj, duke përfshirë detyrimin për t'i zgjidhur çështjet e ndryshme brenda një afati të arsyeshëm kohor⁴⁹⁰. Kjo për shkak se një shtet nuk do të jetë në gjendje që të argumentojë në një mënyrë të pranueshme që gjykatat e tij janë të mbytura me çështje dhe kjo gjë shkakton vonesën, në qoftë se kjo sasi pune

⁴⁸⁵ Shih *Famullia katolike Greke Lupeni dhe të tjerë k. Rumanisë*, [D.H.M.], nr. 76943/11, më lart, § 150, GJEDNJ, 29.11.2016.

⁴⁸⁶ Shih për shembull çështjen *Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*, §§ 88-99, ku përgjegjës për kohëzgjatjen e procedurave ishin sa organet gjyqësore aq edhe Komisionet e Kthimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit të Pronave. Shih gjithashtu *Mishgjoni k. Shqipërisë*, i lartpërmendur.

⁴⁸⁷ Shih *Moreira de Azevedo k. Portugalisë*, nr. 11296/84, § 73 GJEDNJ, 23.10.1990.

⁴⁸⁸ Shih *Estima Jorge k. Portugalisë*, nr. 16/1997/800/1003, § 35, GJEDNJ, 21.04.1998.

⁴⁸⁹ Shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët k. Shqipërisë*, i përmendur më lart, §§ 102-118.

⁴⁹⁰ Shih paragrafin 68 të vendimit të Gjykatës të 1.07.1997 në lidhje me çështjen *Pamel k. Gjermanisë*; shih në 26 European Human Rights Reports 100. Shih gjithashtu *Pelissier dhe Sassi k. Francës*, [D.H.M.], nr. 25444/94, § 74, GJEDNJ, 25.03.1999, *Gouillard k. Francës*, nr. 57435/08, § 35, GJEDNJ, 30.06.2011, *Liga Portuguesa de Futebol Profissional k. Portugalisë*, nr. 4687/11, § 95, GJEDNJ, 30.05.2016.

ishte e parashikueshme dhe ai nuk ka arritur që të marrë masat për ta shmangur atë⁴⁹¹.

Kjo kërkesë zbatohet edhe për çështjet civile mes dy palëve private në të cilat shteti mund të mos jetë fare palë. Megjithatë detyrimet pozitive nën kuadrin e Konventës kërkojnë që shtetet të marrin masa për të shmangur kohëzgjatjen në çdo lloj procedure që bien nën fushën e veprimit të nenit 6⁴⁹². Përveç kuadrit legjislativ dhe administrativ një nga elementët që Gjykata analizon më shpesh në këtë kuadër është ai nëse shtyrjet që gjykatat e brendshme i kanë bërë procedurave kanë qenë apo jo të justifikuar⁴⁹³.

d. *sjellja e kërkuetit*

Gjykata e ka thënë qartë se vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të justifikojnë gjetjen e një mangësie për respektimin e kriterit të afatit të arsyeshëm⁴⁹⁴. Kjo është më se e natyrshme pasi qëndrimet e kërkuetit nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore. Kjo do të thotë se periudhat e vonesës për shkak të sjelljes ose neglizhencave të kërkuetit nuk merren parasysh në llogaritjen e kohëzgjatjes së tepërt apo jo të një procesi. E njëjta gjë vlen për vonesat serioze për shkak të sëmundjes së kërkuetit⁴⁹⁵. Megjithatë kjo nuk do të thotë që kërkuetit nuk ka drejtë që të përdorin ankimet që ju njih e drejta e brendshme, edhe kur këto ankime çojnë në tejzgjatje të procedurave.⁴⁹⁶ Gjykata bën dallime të kujdesshme në çështjet civile krahasuar me ato penale për sa

⁴⁹¹ Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Zimmerman dhe Steiner k. Zvicrës*, Seria A, nr. 66 të vitit 1983; shih në 6 European Human Rights Reports 17 si dhe vendimin e një viti më vonë, 1984, në lidhje me çështjen *Guincho k. Portugalisë*, Seria A, nr. 81; shih në 7 European Human Rights Reports 223.

⁴⁹² Shih *Lăcătuș dhe të tjerë k. Rumanisë*, nr. 12694/04, 13.11.2012, GJEDNJ, § 118.

⁴⁹³ Shih *JGK Statyba Ltd dhe Guselnikovas k. Lituaniës*, nr. 3330/12, § 75, GJEDNJ, 5.11.2013.

⁴⁹⁴ Shih *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [GC], nr. 49017/99, § 49, ECHR 2004-XI. GJEDNJ, 23.04.1987, *Erkner dhe Hofauer k. Austrisë*, nr. 9616/81, § 68 - GJEDNJ, 23.04.1987, *Poiss k. Austrisë*, nr. 9816/82, § 57 - GJEDNJ, 17.01.2017, *Pantea k. Rumanisë* fno 2], nr. 36525/07, S25.

⁴⁹⁵ Shih GJEDNJ, 10.05.2012, *Krakolinig k. Austrisë*, nr. 33992/07, vendim pranueshmëria, § 27.

⁴⁹⁶ Shih GJEDNJ, 23.04.1987, *Erkner dhe Hofauer k. Austri*, § 68. - GJEDNJ, 23.04.1987, *Poiss k. Austrisë*, § 57.

i përket qëndrimit të kërkuesit. Në çështjet penale ajo pranon që “nuk mund t’i kërkohet të akuzuarit të bashkëpunojë aktivisht me autoritetet gjyqësore”⁴⁹⁷. Pra, përveçse kur është haptazi pengues, qëndrimi i kërkuesit në çështjet penale nuk luan rol të veçantë. Kurse në çështjet civile, kur që në premisë nisma iu përket palëve sjellja e kërkuesit merr një rëndësi më të spikatur. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që autoritetet duhet t’ia lënë procesin civil plotësisht në dorë palëve. Në lidhje me të gjitha llojet e proceseve, e drejta për gjykim brenda një kohë të arsyeshme nuk varet nga kërkesa që të akuzuarit i bëjnë autoriteteve për të shpejtuar procedurat. Gjyqtarët mbreten përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë e ecurisë së procesit në kohë me kërkesat e nenit 6⁴⁹⁸.

e. rëndësia e çështjes për kërkuesin

Elementi i fundit që Gjykata merr në analizë për të arritur në përfundimin nëse ka pasur apo jo probleme për sa i përket kohëzgjatjes është rëndësia e çështjes konkrete për kërkuesin. Megjithëse nuk haset gjithmonë në analizën e Gjykatës në lidhje me kohëzgjatjen⁴⁹⁹ duket se ky element ka fituar tashmë një status të rëndësishëm në ushtrimin e kësaj analize. Në bazë të këtij kriteri Gjykata kërkon që në raste të veçanta, gjykatat duhet të jenë më të zellshme, duke mbajtur parasysh rëndësinë e elementit kohë për fatet e kërkuesve dhe në disa raste edhe për vetë zgjidhjen e çështjes konkrete.

Kështu për shembull në çështjen *X kundër Francës*⁵⁰⁰, kërkuesi kishte marrë virusin HIV nga një transfuzion i infektuar gjaku.

⁴⁹⁷ Shih GJEDNJ, 25.02.1993, *Dobbertin k. Francës*, nr. 13089/87,S 43 - GJEDNJ, 8.06.1995, *Yagci dhe Sargin k. Turqisë*, nr. 16419/90, § 66 - GJEDNJ, 15.07.1982, *Eckle k. Gjermanisë*, i lartpërmendur, § 82, *Basoukos k. Greqisë*, nr. 7544/04, § 17, GJEDNJ, 27.04.2006.

⁴⁹⁸ Shih *Scopelliti k. Italisë*, nr. 15511/89, i lartpërmendur, 25 §, GJEDNJ, 23.11.1993, *Duclos k. Francës*, nr. 23661/94, § 55, GJEDNJ, 17.12.1996, *Vassilios Athanasiou dhe të tjerë k. Greqisë*, nr. 50973/08, § 28, GJEDNJ, 21.12.2010, *Glykanzi k. Greqisë*, nr. 40150/09, § 47, GJEDNJ, 30.11.2012.

⁴⁹⁹ Shih *Enver Kaplan k. Turqisë*, nr. 40343/08, § 26, GJEDNJ, 25.12.2013, *Batmaz k. Turqisë*, nr. 714/08, § 45, GJEDNJ, 18.02.2014.

⁵⁰⁰ Vendim i Gjykatës i 23.03.1991, Seria A, nr. 234 - C; shih në 14 European Human Rights Reports 483.

Ai filloi procedurat gjyqësore kundër shtetit për të kërkuar një kompensim nga ana e tij, procedura që zgjatën rreth dy vjet. Duke pasur parasysh kushtet e kërkesit dhe të ardhmen e jetës së tij, Gjykata konsideroi se kohëzgjatja e procedurave ishte tepër e gjatë. Sipas saj gjykatat e brendshme nuk kishin arritur të shfrytëzonin pushtetin e tyre për të përshpejtuar procedurat e gjykimit të kësaj çështjeje. I njëjti qëndrim u mbajt në një sërë çështjesh kundër Francës në vitet 1980, të ashtuquajtura “gjaku i kontaminuar”⁵⁰¹.

Duke mbajtur parasysh se çfarë interesash të kërkesit gjykoheshin, Gjykata ka vendosur që një zell i veçantë kërkohet në raste që kanë të bëjnë për shembull me kufizimet e takimeve ndërmjet një prindi dhe një fëmije⁵⁰² ose në përgjithësi në lidhje me çështje ku janë të përfshirë fëmijët ku kohëzgjatja mund të çojë në një zgjidhje *de facto* të situatës dhe ku pasojat e mundshme, serioze dhe të pakthyeshme, si dhe kujdesi që fëmija të gëzojë të drejtën për respekt të jetën familjare kërkon që autoritetet të veprojnë me kujdes të jashtëzakonshëm për të garantuar një të qetë shpejtësia e procedurës⁵⁰³. Të tilla janë çështje si punësimi⁵⁰⁴, mosmarrëveshjet e pensioneve⁵⁰⁵, përfshirë të drejtën për një pension invaliditeti⁵⁰⁶, identiteti i personave dhe sidomos fëmijëve⁵⁰⁷, e drejta e pronësisë

⁵⁰¹ Shih X. k. Francës, nr. 18020/91, § 47 GJEDNJ, 31.03.1992, *Vallee k. Francës*, nr. 22121/93, § 47- GJEDNJ, 26.04.1994, *Karakaya k. Francës*, nr. 22800/93, § 43, GJEDNJ, 26.08.1994, *Paitot k. Francës*, nr. 32217/96, § 68, GJEDNJ, 22.04.1998, GJEDNJ, 22.04.1998, *Richard k. Francë*, nr. 33441/96, § 64.

⁵⁰² Shih vendimin e Gjykatës të 7.08.1996 në lidhje me çështjen *Johanssen k. Norvegjisë*, në 23 European Human Rights Reports 33, fq. 1010-1011, paragrafi 88. Shih gjithashtu *Kapes k. Greqisë*, nr. 8673/13, vendim komiteti, § 29 GJEDNJ, 21.06.2016.

⁵⁰³ Shih *Paulsen-Medalen dhe Svensson k. Suedisë*, nr. 149/1996/770/967, § 39, GJEDNJ, 19.02.1998, *Plaza k. Polonisë*, nr. 18830/07, § 74, GJEDNJ, 25.01.2011, *K.A.M. k. Serbisë*, nr. 39177/05, GJEDNJ, 13.03.2007.

⁵⁰⁴ Shih vendimin e Gjykatës të 6.05.1981 në lidhje me çështjen *Bucholz k. Gjermanisë*, Seria A, nr. 42; shih në 3 European Human Rights Reports 597. (*Ibid* shënim 51). Shih edhe *Caleffi k. Italisë*, nr. 11890/85, § 17, GJEDNJ, 24.05.1991, *Vocaturro k. Italisë*, nr. 11891/85, § 17, GJEDNJ, 24.05.1991, *Obermeier k. Austrisë*, nr. 11761/85, § 72, GJEDNJ, 28.06.1990, *Gjoka k. Greqisë*, nr. 44806/07, §§ 22-25, GJEDNJ, 16.04.2009, *Cangelaris k. Greqisë*, nr. 28073/09, § 23, GJEDNJ, 3.05.2012.

⁵⁰⁵ Shih GJEDNJ, 26.02.1992, *Nibbio k. Italisë*, nr. 12854/87, § 1B - GJEDNJ, 22.07.2010, *Tsoukalas k. Greqisë*, nr. 12286/08, i lartpërmendur, § 52.

⁵⁰⁶ Shih vendimin e Gjykatës të 26 nëntorit 1997 në lidhje me çështjen *Stamoulakatos k. Greqisë* (Nr. 2).

⁵⁰⁷ Shih *Mikulic k. Kroacisë*

mbi pasuri të paluajtshme⁵⁰⁸, ose në rastet kur kërkuesi ka qenë viktimë e një aksidenti rrugor⁵⁰⁹.

Gjykata nuk e pati fort të vështirë për shembull që, në lidhje me çështje me karakter civil, të vendoste se procedurat gjyqësore mbi divorcin që zgjasin për nëntë vjet me radhë janë tepër të gjata dhe në këtë rast ato rezultojnë “jo nga aktiviteti i ulët por nga aktiviteti i tepërt i gjyqësorit”⁵¹⁰. Ajo e ka konsideruar si të tepërt gjithashtu një afat prej gjashtë vjetësh e gjysmë për të vendosur në lidhje me çështje “jo veçanërisht komplekse”⁵¹¹. Megjithatë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se në rastet kur vetë kërkuesit kanë qenë përgjegjës për zgjatjen e procedurave atëherë një kohëzgjatje prej shtatë vjet e gjysmë e procedurave “në një çështje jo shumë problematike” me karakter civil nuk shkel nenin 6 § 1 të Konventës⁵¹².

Në çështjen *Süßmann kundër Gjermanisë*⁵¹³ një afat prej tre vjetësh e gjysmë përpara Gjykatës Kushtetuese gjermane nuk u konsiderua i paarsyeshëm në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Gjykata vendosi që megjithëse kërkesa e zhvillimit të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm zbatohet edhe ndaj çështjeve përpara gjykatave kushtetuese ai nuk mund të interpretohet në të njëjtën mënyrë si

⁵⁰⁸ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1994 në lidhje me çështjen *Hentrich k. Francës*, Seria A, nr. 296; shih në 18 European Human Rights Reports 440. Shih sidomos *Gjonbocari dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10508/02, 23.10.2007, Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë, i lartpërmendur.

⁵⁰⁹ Shih vendimin e vitit 1987 në lidhje me çështjen *Silva Pontes k. Portugalisë*, Seria A, nr. 286; shih në 18 European Human Rights Reports 156.

⁵¹⁰ Shih vendimin *Bock k. Gjermanisë*, 29.03.1989, série A n° 150, p. 23, par. 49, ku Gjykata tha se “çështja ka të bëjë me aspekte thelbësore të jetës private dhe familjare: marrëdhëniet midis bashkëshortëve, dhe mes tyre dhe fëmijëve të tyre.” Krahaso me vendimin e 27.10.1993 në lidhje me çështjen *Monnet k. Francës*, në 18 European Human Rights Reports 27 në të cilën një procedurë divorci bashkë me dhe procedurat e ndërmjetme që ishin pak a shumë të vështira dhe që zgjatën shtatë vjet nuk u konsideruan si shkelje e nenit 6 të Konventës.

⁵¹¹ Shih vendimin e Gjykatës të 27.04.1989 në lidhje me çështjen *Neves da Silva k. Portugalisë*, Seria A, nr. 153. Shih gjithashtu vendimin e saj të 7.07.1989 në lidhje me çështjen *Union Alimentaria Sanders S. A. k. Spanjës*, Seria A, nr. 157; shih në 12 European Human Rights Reports 24, në të cilin një çështje, për kthimin e një borxhi, e cila kishte zgjatuar pesë vjet kishte shkelur Nenin 6 § 1 të Konventës.

⁵¹² Shih vendimin e Gjykatës të 20.02.1991 në lidhje me çështjen *Vernillo k. Francës*, Seria A, nr. 198; shih në 13 European Human Rights Reports 881.

⁵¹³ Shih në 25 European Human Rights Reports 64.

përpara gjykatave të zakonshme. Kjo për shkak se sipas saj gjykatat kushtetuese duhet të mbajnë parasysh edhe faktorë jo të zakonshëm për përcaktimin e përparësisë së shqyrtimit të çështjeve (siç mund të jenë natyra e një çështjeje të caktuar dhe rëndësia e saj në kuptimin politik dhe shoqëror).

PJESA III

GARANCI TË POSAÇME TË PROCESIT TË DREJTË NË RAST TË NJË AKUZE PENALE

Procesi penal në kuadrin e nenit 6 të Konventës merr një rëndësi të veçantë. Kjo është më se e qartë po të vihet re se, siç e thamë edhe në fillim të këtij komentari, pjesa më e madhe e dispozitave të nenit 6, dhe tërësia e paragrafëve 2 dhe 3, i kushtohet pikërisht procesit penal dhe garancive që duhet t'u jepen të akuzuarve gjatë këtij procesi. Këto garanci janë specifike për procesin penal dhe ju shtohen atyre që analizuam deri tani si garanci të përgjithshme të nocionit të procesit të drejtë sipas nenit 6 të Konventës. Një vëmendje specifike dhe garanci të shtuara për procesin penal janë më se të logjikshme por të mbahet parasysh se të akuzuarit në një proces penal janë personat më të prekshëm dhe ndaj të cilëve abuzimet mund të shfaqen më lehtë. Për këtë qëllim garancitë që parashikohen nën 6 në lidhje me procesin penal janë shumë më të detajuara se ato në lidhje me procesin civil dhe Gjykata është treguar historikisht më strikte në këto procese në krahasim me ato civile. Gjithsesi mund të thuhet se ka një lloj ndjeshmërie në gjirin e Gjykatës, sidomos në vitet e fundit, në lidhje me proceset penale që kanë të bëjnë me autorë ose të dyshuar për kryerjen e veprave terroriste. Kjo ndjeshmëri natyrisht që lidhet me barrën e rëndë që, në mbrojtje të jetës së personave të pafajshëm, autoritetet e Shteteve anëtare kanë në luftën e tyre kundër akteve terroriste ose krimit të organizuar. Megjithatë Gjykata është shprehur se kjo nuk përjashton mbrojtjen e ofruar nga neni 6 i Konventës edhe në rastin e këtyre personave⁵¹⁴.

⁵¹⁴ Shih vendimin *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur, në paragrafin 252 të të cilit Gjykata shprehet se:

Analiza vijuese do të ndalet pikërisht në këto garanci të veçanta që neni 6 parashikon në lidhje me proceset penale dhe të akuzuarit për kryerjen e veprave penale.

I. Prezumimi i pafajësisë - Neni 6 § 2

A. Fusha e zbatimit të nenit 6 § 2 – E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm në lidhje me një akuzë penale

Prezumimi i pafajësisë është garancia e parë që i njihet një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale⁵¹⁵. Nuk mund të ketë në koncept gjykim të drejtë të një personi në qoftë se ai person prezumohet se është fajtor⁵¹⁶. Një perceptim i tillë që në fillim të procedurave hetimore dhe gjyqësore do të dëmtonte të gjithë procesin. Megjithëse në logjikën e tij ky nocion duket i lidhur ngushtë me atë të gjyimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe ka ndikim mbi një sërë elementesh të procesit penal, është e rëndësishme të theksohet se prezumimi i pafajësisë sipas nenit 6 § 2 të Konventës është një nocion autonom dhe përfiton nga një analizë dhe vlerësim i pavarur në raport me garancitë e tjera të parashikuara nga neni 6 Konventës. Kjo do të thotë që edhe nëse të

Kërkesat e përgjithshme të gjyimit të drejtë të përfshira në nenin 6 zbatohen në të gjitha procedimet penale, pavarësisht nga lloji i veprës penale në fjalë. Është e papranueshme që të shmangen garancitë e të drejtës për gjykim të drejtë vetëm për arsyen se individët në fjalë detyrohen për përfshirje në terrorizëm. Në këto kohë sfiduese, Gjykata konsideron se është me rëndësi të veçantë që Palët Kontraktuese të demonstrojnë angazhimin e tyre për të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor duke siguruar respektimin, ndër të tjera, garancitë minimale të nenit 6 të Konventës. Megjithatë, kur vendoset nëse procedurat në tërësi kanë qenë të drejta, mund të merret në konsideratë pesha e interesit publik në hetimin dhe dënimin e veprës së caktuar në fjalë (shih Jalloh kundër Gjermanisë [DH.M.], nr.541010/00, § 97, GJEDNJ 2006-IX). Për më tepër, neni 6 nuk duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që i vë në vështirësi joproporcionale autoritetet policore në lidhje me mënyrën e marrjes së masave efektive për të luftuar terrorizmin ose krimet t tjera të rënda gjatë kryerjes së detyrës së tyre sipas neneve 2, 3 dhe 5 § 1 të Konventës për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të drejtën për sigurinë trupore të publikut (shih, mutatis mutandis, Sher dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 5201/11, § 149, GJEDNJ 2015 (ekstrakte)). Sidoqoftë, shqetësimet e interesit publik nuk mund të justifikojnë masat që shuajnë thelbin e të drejtave të mbrojtjes të një kërkuesi (shih Jalloh, cituar më lart, § 97, Bykov k. Rusisë [DH.M.], nr. 4378/02, § 93, 10 mars 2009; Aleksandr Zaichenko kundër Rusisë, nr. 39660/02, § 39, 18 shkurt 2010).

⁵¹⁵ Shih gjithashtu nenin 14 § 2 të PNDCCP dhe Komentin e përgjithshëm nr. 32 mbi këtë nen të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, të 23 gushtit 2007.

⁵¹⁶ Shih *Allen De Ribemont k. Francës*, nr. 15175/89, § 35, GJEDNJ, 10.02.1995, shih në L. Bianku, O. Kumbaro, e lartpërmendur. Shih gjithashtu *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar* [DH.M.], nr. 25424/09, § 93, CEDH 2013.

gjitha garancitë e tjera të parashikuara nga paragrafët 1 dhe 3 të nenit 6 respektohen me përpikëri, kjo nuk do të thotë që të mos gjendet një shkelje e nenit 6 § 2 për shkelje të prezumimit të pafajësisë. Në fakt edhe kur nuk ka probleme të gjykimit nga një gjykatë e pavarur mund të ketë shkelje të nenit 6 § 2⁵¹⁷. Kjo duket të jetë edhe arsyeja përse në strukturën e nenit 6, prezumimi i pafajësisë është e vetmja garanci që është vendosur në një paragraf më vete, paragrafin 2.

Ky paragraf i nenit 6 jep në vetvete edhe thelbin e nocionit sipas të cilit çdo i akuzuar “prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”⁵¹⁸. Në vitet e para të jurisprudencës Gjykata dukej se përqendrohej në zbatueshmërinë e këtij parimi vetëm në raport me anëtarët e trupit gjykues që shqyrtonin çështjen e kërkuarit. Kështu për shembull, në çështjen e përdorur për vite si referenca në këtë drejtim, *Minelli kundër Zvicrës*, Gjykata, u shpreh se “prezumimi i pafajësisë shkelet nëse, pa u vendosur ligjërisht më parë fajësia e një të akuzuari dhe, në veçanti, pa pasur ky i fundit mundësi për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes, një vendim gjyqësor në lidhje me të pasqyron ndjesinë se ai është fajtor”⁵¹⁹. E njëjta ndjesi krijohet edhe nga leximi i një vendimi tjetër të rëndësishëm në lidhje me këtë garanci, ku Gjykata shprehet se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që “në përmbushjen e funksioneve të tyre pjesëtarët e trupit gjykues nuk duhet të nisen nga ideja paraprake se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar; barra e provës i takon akuzës dhe dyshimet janë në favor të të akuzuarit”⁵²⁰.

Në dy vendimet më të fundit të Dhomës së Madhe ku është ngritur problemi i prezumimit të pafajësisë Gjykata ka shkuar edhe më tej. Ajo është shprehur se “...i konsideruar si një mbrojtje procedurale në kontekstin e procesit penal, prezumimi i pafajësisë ka gjithashtu një

⁵¹⁷ Shih për shembull *Gutsanovi k. Bullgarisë*, nr. 34529/10, GJEDNJ, 15.10.2013.

⁵¹⁸ Shih vetë tekstin e paragrafit 2 të nenit 6. Shih gjithashtu edhe paragrafin 93 të vendimit *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar, të sapo përmendur më lart*.

⁵¹⁹ Shih *Minelli k. Zvicrës*, nr. 8660/79, § 37, GJEDNJ, 25.03.1983. Shih gjithashtu *El Kaada k. Gjermanisë*, nr. 2130/10, § 53, GJEDNJ, 12.11.2015.

⁵²⁰ Shih *Barberà, Messegué dhe Jabardo k. Spanjës*, nr. 1090/83, § 77, GJEDNJ, 6.12.1988.

aspekt tjetër. Qëllimi i tij i përgjithshëm, në këtë aspekt të dytë, është të mbrojë individët të cilët janë shpallur të pafajshëm ose për të cilat janë pushuar procedimet penale nga trajtimi prej zyrtarëve publikë dhe autoriteteve sikur të jenë në fakt fajtorë për veprën për të cilën janë akuzuar. Në këto raste, prezumimi i pafajësisë ka funksionuar tashmë, nëpërmjet zbatimit gjatë gjykimit të kërkesave të ndryshme që janë pjesë e garancisë procedurale që ajo ofron, për të parandaluar dhënien e një dënimi të padrejtë penal. Pa mbrojtjen për të siguruar respektimin e vendimit të pafajësisë ose të pushimit të procedimit, garancitë e nenit 6 § 2 për një gjykim të drejtë rrezikojnë të bëhen teorike dhe iluzive.”⁵²¹

Ajo që del qartë nga zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës është një zgjerim i mbrojtjes që ofron neni 6 § 2, sidomos jashtë sallave të gjykatave. Gjykata ka thënë se parimi e prezumimit të pafajësisë nuk kufizohet në një garanci procedurale në çështjet penale. Shtrirja e tij është më e gjerë pasi ai jo vetëm siç e thamë më lart lidhet me pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave por ka lidhje me perceptimin e dhënies së drejtësisë nga publiku, me mënyrën si ky i fundit percepton pozitën e personit që ndiqet penalisht,⁵²² si dhe me respektin për nderin dhe dinjitetin e këtij të fundit⁵²³.

Përveç faktit se pozicionet e tilla mund të minojnë pavarësinë e drejtësisë, ato cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e të akuzuarve, fajësia e të cilëve akoma nuk është vërtetuar.

Në këtë mënyrë, për situata me shumë vlerë për realitetin shqiptar, në këto çështje Gjykata thekson se “Ajo që është në rrezik edhe kur procedurat penale kanë përfunduar është reputacioni i personit dhe mënyra në të cilën ky person perceptohet nga publiku. Në një masë të

⁵²¹ Shih *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar*, të sapo përmendur më lart, § 93. Shih edhe *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë k. Italisë*, [D.H.M.] nr. 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11, § 314, GJEDNJ, 28.06.2018.

⁵²² Shih *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur, § 94, *Urfi Cetinkaya k. Turqisë*, nr. 19866/04, § 147-150 GJEDNJ, 23.07.2013, *El Kaada k. Gjermanisë*, nr. 2130/10, § 42, GJEDNJ, 12.11.2015, *Kemal Cogkun k. Turqisë*, nr. 45028/07, § 42, GJEDNJ, 28.03.2017.

⁵²³ Shih *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur, si dhe *Konstas k. Greqisë*, nr. 53466/07, i lartpërmendur, § 32, GJEDNJ, 24.05.2011.

caktuar, mbrojtja e ofruar në bazë të nenit 6 § 2 në lidhje me këtë mund të mbivendoset me mbrojtjen e ofruar nga neni 8⁵²⁴.

B. Kriteret e zbatimit

Gjithsesi shkelja apo jo e parimit të prezumimit të pafajësisë mund të shqyrtohet vetëm në rastin konkret duke marrë parasysht kontekstin dhe rrethanat kur qëndrimi i kundërshtuar është mbajtur⁵²⁵. Kritereve e mëposhtme mund të na ndihmojnë që të ravijëzojmë më mirë udhëzimet e jurisprudencës mbi nenin 6 § 2.

a. natyra e deklaratave

Natyrë e deklaratave është elementi më thelbësor për të kuptuar nëse ka problem për qëllimet e nenit 6 § 2 apo jo. Gjykata ka thënë se “ajo që ka rëndësi, megjithatë, është kuptimi i vërtetë i deklaratave në fjalë, duke pasur parasysht rrethanat e veçanta në të cilat janë formuluar”⁵²⁶. Megjithëse neni 6 § 2 i Konventës nuk ndalon prezumimin e fakteve ose të akteve ligjore të cilat mund të jenë në kundërshtim me interesat e personit të akuzuar, prezumimi i pafajësisë si nocion krijon detyrime mbi mënyrën si këto presupozime shfaqen dhe administrohen⁵²⁷ ashtu edhe mbi barrën e provës⁵²⁸. Për këtë arsye Gjykata ka theksuar që Shtetet Palë duhet ta kufizojnë veprimin e këtyre prezumimeve “brenda kufijve të arsyeshem të cilët mbajnë parasysht rëndësinë e asaj që është në lojë dhe ruajnë të drejtat e palës së akuzuar”⁵²⁹.

⁵²⁴ Shih *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar*, të sapo përmendur më lart, § 93 dhe *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë k. Italisë*, të sapo përmendur më lart, § 314. Shih gjithashtu *Zollman k. Mbretërisë së Bashkuar* (vendim mbi pranueshmërinë), no. 62902/00, GJEDNJ 2003-XII; *Taliadorou dhe Stylianou k. Qipros*, nos. 39627/05 and 39631/05, §§ 27 and 56-59, 16.10.2008.

⁵²⁵ Shih *Daktaras k. Lituanisë*, nr. 42095/98, § 43, GJEDNJ, 10.10.2000, *Kampanellis k. Greqisë*, nr. 9029/05, § 27, GJEDNJ, 21.06.2007.

⁵²⁶ Shih *Y.B. dhe të tjerët k. Turqisë*, 48173/99 dhe 48319/99, § 44, GJEDNJ, 28.10.2004 dhe *Gutsanovi k. Bullgarisë*, nr. 34529/10, § 191, GJEDNJ, 15.10.2013.

⁵²⁷ Shih *Salabiaku k. Francës*, 7.10.1988, § 28, Seria A, 141 A, dhe *Radio France dhe të tjerët k. Francës*, nr. 53984/00, § 24, GJEDNJ 2004 II.

⁵²⁸ *Ibid.* Shih gjithashtu *Telfner k. Austrisë*, nr. 33501/96, § 15, 20.03.2001.

⁵²⁹ Shih vendimin e Gjykatës të 7.10.1988 në lidhje me çështjen *Salabiaku k. Francës*, Seria A, nr. 141; shih në 13 European Human Rights Reports 379 si dhe vendimin e saj të 25.09.1992, *Pham Hoang k. Francës*, Seria A, nr. 243; shih në 16 European Human Rights Reports 53.

Gjykata ka thënë se duhen bërë dallime të kujdesshme. Ndërsa shprehjet ose deklaratat që shprehin një ndjesi se personi i akuzuar është fajtor shkelin nenin 6 paragrafi 2, ato që kufizohen vetëm në pasqyrimin e një “gjendje dyshimi” janë në përgjithësi të pranueshme në një procedurë penale⁵³⁰. Megjithatë ato duhen formuluar me kujdes që të mos krijojnë përshtypjen se ka paragjykim⁵³¹.

Vendimi më interesant i kohëve të fundit për të bërë dallimin se cilat deklaratat janë problematike dhe cilat jo është ai *Gutsanovi kundër Bullgarisë*, i lartpërmendur. Kështu për shembull Gjykata vendosi se mënyra se si kryeministri bullgar ishte shprehur, në mënyrë krejt spontane, në lidhje me kërkuesit nuk përbënte shkelje të nenit 6 § 2. Ai kishte thënë se kërkuesi ishte arrestuar me vendim të një gjykate e cila duhet të ketë pasur prova të mjaftueshme për këtë qëllim. Për të arritur në këtë përfundim, vendimtare ishte analiza e Gjykatës në lidhje me kuptimin literal dhe figurativ të këtyre shprehjeve dhe sidomos faktin që ai i ishte referuar arrestit dhe jo fajësisë⁵³². Gjykata arriti në konkluzionin se edhe deklaratat e prokurorit në lidhje me arrestimin e z. Gutsanovi nuk kishin bërë gjë tjetër vetëm se kishin përshkruar rrethanat e arrestit dhe veprat penale për të cilat ai dhe personat e tjerë të dyshuar akuzoheshin⁵³³. Nga ana tjetër Gjykata i gjeti problematike deklaratat e Ministrit të Brendshëm bullgar i cili kishte dhënë një intervistë të posaçme mbi këtë për një gazetë bullgare të nesërmen e arrestimit, pra përpara se gjykata të vendoste mbi masën e arrestit ndaj kërkuesit. Ministri iu ishte referuar detajeve të hetimit, shumave të parave që të dyshuarit kishin përfituar në llogaritë e tyre, dhe kishte

⁵³⁰ Shih *Lutz k. Gjermanisë*, nr. 9912/82, § 62, GJEDNJ, 25.08.1987, *Marziano k. Italisë*, no 45313/99, § 31, 28 novembre 2002, *Popovi k. Bullgarisë*, nr. 39651/11, § 85, GJEDNJ, 9.06.2016, *Bivolaru k. Rumanisë*, nr. 28796/04, § 122., GJEDNJ, 28.02.2017.

⁵³¹ Shih *Capeau k. Belgjikës*, nr. 42914/98, § 25, GJEDNJ, 13.01.2005.

⁵³² Shih *Gutsanovi k. Bullgarisë*, i lartpërmendur, §§ 194-196.

⁵³³ *Ibid.* § 197. Shih edhe qasjen e nuancuar të Gjykatës në rastin e deklaratave i Prokurorit, *Daktaras k. Lituanisë*, nr. 42095/98, § 44., GJEDNJ, 10.10.2000, *Shuvalov k. Estonisë*, nr. 39820/08 dhe 14942/09, § 78-84, GJEDNJ, 29.05.2012, *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, nr. 40984/07, § 159- 163, GJEDNJ, 22.04.2010.

përdorur termin “makinacion i përgatitur prej shumë vitesh”. Gjykata vlerësoi se mënyra se si ministri ishte shprehur, mund të krijonte në publik përshtypjen se kërkuesi ishte koka e një rrjeti kriminal që kishte përvetësuar fonde publike⁵³⁴. Interesante është edhe analiza që Gjykata i bën qëndrimit të gjyqtarit që vendosi mbi nevojën e mbajtjes në arrest në burg të kërkuesit. Në vendimin për këtë qëllim, gjyqtari u shpreh se “në radhe të parë [gjykata] është gjithmonë e mendimit se është kryer një vepër penale dhe se i akuzuari është i përfshirë në kryerjen e saj (...)”. Kjo fjali në një vendim paraprak që do të vlerësonte vetëm masën e arrestit, ishte e mjaftueshme për Gjykatën që të vendoste që gjyqtari i rrethit, ashtu si edhe ministri i brendshëm, kishin shkelur prezumimin e pafajësisë sipas nenit 6 § 2⁵³⁵.

Ky vendim përmban gjithashtu një kujtesë tjetër në lidhje me natyrën e deklaratave. Në lidhje me deklaratat e ministrit Gjykata shprehet se karakteri i qëllimshëm i një deklaratë nuk është i nevojshëm për të gjetur shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës⁵³⁶. Në lidhje me natyrën e deklaratave, nga jurisprudenca kuptohet se “mjafton, edhe në mungesë të një konstatimi formal, një arsyetim që të bën të mendosh se zyrtari e konsideron personin në fjalë fajtor”⁵³⁷, që neni 6 § 2 të jetë shkelur. Duhet theksuar gjithsesi që neni 6 § 2 nuk shkelet, në parim, përveçse kur deklaratat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kërkuesin si i akuzuar⁵³⁸. Por edhe ky saktësim duhet interpretuar gjerë. Gjykata ka thënë se parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe nga deklarata paraprake në lidhje me fajësinë e një të akuzuari, të bëra në një proces më vete ndaj një të bashkakuзуari të tij⁵³⁹.

⁵³⁴ Ibid. §§ 198-200.

⁵³⁵ Ibid. §§ 202-203.

⁵³⁶ Ibid. § 201.

⁵³⁷ Shih *Gutsanovi k. Bullgarisë, i lartpërmendur*, § 191. Shih gjithashtu *Mulosmani k. Shqipërisë*, nr. 29864/03, § 137, GJEDNJ, 08.10.2013.

⁵³⁸ Shih *Gjerde k. Norvegjisë*, nr. 18672/91, Kom.EDH, 31.03.1993.

⁵³⁹ Shih *Karaman k. Gjermanisë* [nr. 2], nr. 17103/10, § 42, GJEDNJ, 27.02.2014, *Bauras k. Lituanisë*, nr. 56795/13, § 52, GJEDNJ, 31.10.2017.

b. kush i bën deklaratat?

Në fillimet e jurisprudencës e saj mbi nenin 6 § 2 Gjykata duket se i ka kushtuar rëndësi të veçantë vlerësimeve të autoriteteve gjyqësore lidhur me fajësinë e kërkuesit përpara përfundimit të procedurës penale⁵⁴⁰. Gjykata ka qenë dhe është shumë e kujdesshme në këtë drejtim, pra që gjyqtarët të mos mbanin qëndrime që paragjykonin fajësinë e kërkuesve. Kështu për shembull, në çështjen *Laovents kundër Letonisë*⁵⁴¹, ajo gjeti shkelje për shkak të deklaratave të bëra në shtyp nga gjyqtarja e çështjes nga të cilat dukej se ajo ishte e bindur për fajësinë e kërkuesit dhe se sipas saj kërkuesi duhej të provonte fajësinë e tij. Megjithatë në jurisprudencën e saj të mëvonshme e ka shtrirë rrethin e personave që mund të bëjnë deklaratat që konsiderohen problematike sipas këtij neni. Kështu për shembull, që në vendimin *Allenet de Ribemont kundër Francës*⁵⁴², Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se prezumimi i pafajësisë i imponon çdo përfaqësuesi të shtetit të përmbahen nga deklaratat në lidhje me fajësinë e kërkuesit përpara se çështja e tij të vendoset nga një gjykatë⁵⁴³. Në atë vendim, neni 6 § 2 i Konventës ishte shkëlur sipas Gjykatës për shkak të një deklaratë në një konferencë shtypi nga ana e ministrit të brendshëm sipas së cilit kërkuesi, i cili kishte qenë arrestuar mbi bazën e një dyshim për kryerjen e një vrasjeje, e kishte kryer këtë vepër penale.

Jurisprudenca e mëvonshme e Gjykatës ka theksuar se autoritetet që mund të cenojnë parimin e prezumimit të pafajësisë janë edhe kryeministri⁵⁴⁴, ministrat, edhe kur ata ushtrojnë funksionet e tyre

⁵⁴⁰ Shih *Minelli k. Zvicrës*, dhe *Barberà, Messegué dhe Jabardo k. Spanjës*, të lartpërmendur.

⁵⁴¹ Vendim i 28.10.2002. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur. Shih gjithashtu Gutsanovi k. Bullgarisë §§ 202-203, i sapo përmendur më lart.

⁵⁴² Vendim i Gjykatës, 20 European Human Rights Reports 557. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁵⁴³ Shih, GJEDNJ, 10.02.1995, *Allenet de Ribemont k. Francës*, nr. 15175/89, par. § 35-36. Shih gjithashtu, GJEDNJ, 30.06.2009, *Viorel Burzo k. Rumanisë*, nr. 75109/01 dhe 12639/02. GJEDNJ, 24.05.2011, *Konstas k. Greqisë*, nr. 53466/07, i lartpërmendur, § 32 e vijues.

⁵⁴⁴ Shih Gutsanovi k. Bullgarisë, i lartpërmendur, § 197. Interesant do të jetë të shihet vendimi i Gjykatës në lidhje me kërkesën tashmë të komunikuar nr. 53488/15 në çështjen *Francesco Becchetti dhe të tjerë k. Shqipërisë*, që ka të bëjë me deklaratat në Twitter të Kryeministrit Rama në lidhje me televizionin Agon. Shih pyetjen 4 që Gjykata i drejton Qeverisë Shqiptare.

politike, qoftë edhe gjatë debateve parlamentare, parlamentarët. Në këtë drejtim Gjykata është shprehur se sidomos ministri i drejtësisë për shembull *“duhet të jetë veçanërisht i vëmendshëm në përdorimin e termave që mund të krijojnë përshtypjen se ai dëshiron të ndikojë në rezultatin e një çështje në gjykim në gjykatën kompetente”*, pasi ai është *“par excellence autoriteti politik që mbikëqyr organizimin dhe mirëfunksionimin e gjykatave”*⁵⁴⁵. Siç e pamë më lart edhe gjyqtarët e prokurorët janë gjithashtu organe që mund të çojnë, me qëndrimet e tyre në probleme nën këndvështrimin e nenit 6 § 2 të Konventës. Gjykata, duke theksuar rëndësinë e informimit publik, ka vënë në dukje se edhe gazetarët kanë për detyrë të shmangin komentet që mund cenojnë karakterin e drejtë të një procesi penal në zhvillim e sipër⁵⁴⁶. Është interesante, nga ana tjetër, që Gjykata është shprehur se kryetari i një partie të pavarur politike, në opozitë, nuk mund të konsiderohet si zyrtar publik⁵⁴⁷.

Në lidhje me rrethin e personave që bëjnë deklaratat, zhvillimet e jurisprudencës kanë bërë të qartë pra se shtrirja parimit të prezumimit të pafajësisë është shumë më e gjerë se sa vetëm në raport me trupin gjykues. Kështu Gjykata e ka plotësuar qëndrimin e saj duke thënë se prezumimi i pafajësisë *“shkelet nëse një deklaratë zyrtare në lidhje me një të pandehur pasqyron ndjesinë se ai është fajtor, ndërkohë që fajësia e tij nuk është vendosur ligjërisht më parë”*⁵⁴⁸, apo nga *“formulimi nga gjykata apo ndonjë autoritet tjetër publik i deklaratave të parakohshme për fajësinë e të akuzuarit”*⁵⁴⁹.

⁵⁴⁵ Shih Konstas k. Greqisë, i lartpërmendur, § 43, GJEDNJ, 24.05.2011.

⁵⁴⁶ Shih Worm k. Austrisë nr. 83/1996/702/894, § 50., GJEDNJ, 29.08.1997, Pullicino k. Maltës, nr. 45441/99, vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ, 15.06.2000. Ky është një debat shumë interesant në lidhje me ekuilibrin mes prezumimit të pafajësisë dhe lirisë së shprehjes. Shih K. ANTONIOU, E drejta për prezumimin e pafajësisë kundrejt të drejtës për liri të shprehje në Paliament: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjykimi në Konstas k. Greqi, EHRLR 2012 (3), f. 319-326, dhe mutatis mutandis vendimin e njohur *Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar*, në L. Bianku, O. Kumbaro.

⁵⁴⁷ Shih Mulosmani k. Shqipërisë, nr. 29864/03, GJEDNJ, 8.10.2013.

⁵⁴⁸ Shih Gutsanovi k. Bullgarisë, i lartpërmendur, § 191. Shih gjithashtu Mulosmani k. Shqipërisë, nr. 29864/03, § 137, GJEDNJ, 08.10.2013.

⁵⁴⁹ Shih *Allenet de Ribemont, cituar më lart*, §§ 35-36, dhe *Nešták kundër Sllovakisë*, nr. 65559/01, § 88, 27 shkurt 2007.

c. kur bëhen deklaratat?

Duhet kujtuar se parimi i prezumimit të pafajësisë gjen zbatim vetëm në kuadrin e procedurave penale⁵⁵⁰. Pra po nuk pati procedim penal një person nuk mund të pretendojë prezumim të pafajësisë. Duhet theksuar se kjo garanci gjen zbatim përgjatë gjithë procedurës, pavarësisht nga rezultati i ndërmjetëm apo përfundimtar i procedurës⁵⁵¹. Kjo garanci gjen zbatim sidomos në procedurat në apel ku “gjqytari që ka juridiksion duhet të rishqyrtojë vendimin në fakt dhe në ligj”⁵⁵². Vendimi i Dhomës së Madhe G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë kundër Italisë sugjeron që kjo garanci gjen zbatim edhe në procedurat e kasacionit⁵⁵³. Madje, duhet të themi tashmë, në bazë të këtij vendimi dhe të vendimit *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i lartpërmendur që kjo garanci nuk merr fund me mbylljen e procedimit penal por vazhdon ta shtrijë efektin edhe pas tij, sidomos për të parandaluar një procedim të ri në lidhje me të njëjtën vepër penale⁵⁵⁴ ose në lidhje me procedura të tjera që janë pasojë ose të ndërlidhura me procedurën penale.⁵⁵⁵

Kështu, për shembull, Gjykata ka pranuar se prezumimi i pafajësisë gjen zbatim edhe pasi një i akuzuar është shpallur përfundimisht i pafajshëm kur vazhdojnë procedura të tilla si ato që kanë të bëjnë me kërkesat e një të ish akuzuari për kompensim në lidhje me periudhën e paraburgimit⁵⁵⁶ ose të dëmeve të tjera të shkaktuara nga procedura

⁵⁵⁰ Shih *Sharxi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, e lartpërmendur, §§ 176-178. Shih edhe *Zollman k. Mbretërisë së Bashkuar*, të sapo përmendur më lart.

⁵⁵¹ Shih *Neagoe k. Rumanisë*, nr. 23319/08, § 49, GJEDNJ, 21.07.2015. *Kolomenskiy k. Rusisë*, 27297/07, § 107, GJEDNJ, 13.12.2016.

⁵⁵² Shih *Konstas k. Greqisë*, nr. 53466/07, i lartpërmendur, § 36.

⁵⁵³ Shih G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë k. Italisë, të sapo përmendur më lart, §§ 314-318. Shih gjithashtu *Giosakis k. Greqisë* (nr. 3), no. 5689/08, § 41, 3.05.2011.

⁵⁵⁴ Shih *Allen k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 98, dhe sidomos G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë k. Italisë, të përmendur më lart.

⁵⁵⁵ Shih *Minelli k. Italisë*, nr. 9660/79, § 30, GJEDNJ, 25.03.1983 si dhe *Lutz k. Gjermanisë*, nr. 9912/82 § 56, GJEDNJ, 25.08.1987

⁵⁵⁶ Shih *Sekanina k. Austria*, 25.08.1993, § 22, Series A no. 266-A; *Rushiti k. Austria*, no. 28389/95, § 27, 21.03.2000; *Mulaj and Sallahi k. Austria* (dek.), no. 48886/99, 27.06.2002; *O. k. Norway*, no. 29327/95, §§ 33-38, ECHR 2003-II; *Hammern*, cited above, §§ 41-46; *Baars k. the Netherlands*, no. 44320/98, § 21, 28.10.2003; *Capeau k. Belgium* (dek.), no. 42914/98, 6.04.2004; *Del Latte k. the Netherlands*, no. 44760/98, § 30, 9.11.2004; *A.L. k. Germany*, no. 72758/01, §§ 31-33, 28.04.2005; *Puig Panella*, cited above, § 50; *Tendam*, cited above, §§ 31 and 36; *Bok k. the Netherlands*, no. 45482/06, §§ 37-48, 18.01.2011; and *Lorenzetti k. Italy*, no. 32075/09, § 43, 10.04.2012.

penale kundër tij⁵⁵⁷, sidomos të atyre të paligjshme ose të gabuara⁵⁵⁸, ose me kërkesat e tij për rimbursimin e shpenzimeve të mbrojtjes së tij⁵⁵⁹. Gjithashtu neni 6 § 2 gjen zbatim në lidhje me procedurat mbi detyrimin e të ish akuzuarit për të mbuluar shpenzimet ligjore ose hetimore⁵⁶⁰, mbi detyrimin për të kompensuar viktimën⁵⁶¹ ose ndaj masave disiplinore ose të largimit të tij ndaj puna, etj.⁵⁶² Siç e thamë lart, Gjykata ka theksuar gjithashtu se në lidhje me këto efekte pas përfundimit të procedurës penale, elementë të tjerë, të tillë si nderi, dinjiteti dhe reputacioni i personit hyjnë në lojë në mbrojtjen e ofruar nga neni 6 § 2.⁵⁶³

Në çështjen *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁵⁶⁴ nuk kishte shkelje në lidhje me zbatimin e një prezumimi me ligj mbi sigurimin e të ardhurave të kërkuesit me anë të trafikut të drogës. Ky prezumim ligjor nuk ishte zbatuar për të lehtësuar fajësimin e kërkuesit në lidhje me ndonjë vepër penale por, në fakt, për t'u mundësuar gjykatave të brendshme një vlerësim të shumës që duhej konfiskuar. Gjithashtu zbatimi i prezumimit pas dënimit

⁵⁵⁷ Shih për shembull në lidhje me vazhdimin e urdhrin të kujdestarisë së fëmijës kur prokuroria vendosi të mos procedonte me akuzën për abuzim me fëmijët, *O.L. k. Finland* (dek.), no. 61110/00, 05.07.2005, mbi revokimin e së drejtës së kërkuesit për strejim social *Vassilios Stavropoulos k. Greece*, no. 35522/04, §§ 28-32, 27 shtator 2007, ose mbi refuzimin e padive civile ndaj kompanive të sigurimit *Lundkoist k. Suedisë* (dek.), no. 48518/99, ECHR 2003-XI, and *Reeves k. Norvegjisë* (dek.), no. 4248/02, 8 korrik 2004

⁵⁵⁸ Shih *Panteleyenko k. Ukrainës*, no. 11901/02, § 67, 29 qershor 2006, dhe *Grabchuk k. Ukrainës*, no. 8599/02, § 42, 21 shtator 2006

⁵⁵⁹ Shih *Lutz k. Gjermanisë*, 25 gusht 1987, §§ 56-57, Series A no. 123; *Leutscher k. the Holandës*, 26 mars 1996, § 29, Reports 1996-II; *Yassar Hussain*, e sipërpërmendur, § 19; dhe *Ashendon and Jones k. the Mbretërisë së Bashkuar* (revision), nos. 35730/07 dhe 4285/08, §§ 42 dhe 49, 15 dhjetor 2011)

⁵⁶⁰ Shih *Minelli k. Zvicrës*, 25 mars 1983, §§ 30-32, Series A no. 62, dhe *McHugo k. Zvicrës* (dek.), no. 55705/00, 12 maj 2005.

⁵⁶¹ *Ringold k. Norvegjisë*, no. 34964/97, § 36, GJEDNJ 2003-II; *Y k. Norvegjisë*, no. 56568/00, § 39, GJEDNJ 2003-II; *Orr*, e sipërmendur, §§ 47-49; *Erkol k. Turqisë*, no. 50172/06, §§ 33 dhe 37, 19 prill 2011; *Vulakh and Others k. Rusisë*, no. 33468/03, § 32, 10 janar 2012; *Diacenco k. Rumanisë*, no. 124/04, § 55, 7 shkurt 2012; *Lagardère k. Francës*, no. 18851/07, §§ 73 dhe 76, 12 prill 2012; dhe *Constantin Florea k. Rumanisë*, no. 21534/05, §§ 50 dhe 52, 19 qershor 2012

⁵⁶² Shih *Moullet k. Francës* (dek.), no. 27521/04, 13 shtator 2007; *Taliadorou and Stylianou*, e sipërpërmendur, § 25; *Šikić*, e sipërpërmendur, §§ 42-47; and *Çelik* (Bozkurt) *k. Turqisë*, no. 34388/05, § 34, 12 prill 2011.

⁵⁶³ *Ibid.* Shih gjithashtu *Kostas k. Greqisë*, nr. 53466/07, § 32, GJEDNJ, 24.05.2011.

⁵⁶⁴ *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 41087/98 § 35, GJEDNJ, 5.07.2001.

të të akuzuarit⁵⁶⁵, ose edhe gjatë arsyetimit të vendimit⁵⁶⁶ nuk konsiderohen, në parim, si në kundërshtim me nenin 6 § 2.

Në çështjen *Minelli kundër Zvicrës*⁵⁶⁷, ndjekja penale e kërkuesit u pezullua për shkak të parashkrimit të ndjekjes së veprës penale konkrete. Pavarësisht nga ky fakt gjykata e brendshme nxori një urdhër që kërkuesi të paguante një pjesë të shpenzimeve procedurale si dhe një kompensim viktimave të pretenduara përderisa në qoftë se do të ishte arritur të përfundohej procesi brenda afatit ai mund edhe të kishte qenë dënuar. Gjykata natyrisht që konstatoi në këtë rast shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës për shkak të faktit se ky urdhër i gjykatës së brendshme nuk ishte në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë⁵⁶⁸. Në çështjen *Weixelbraun kundër Austrisë*⁵⁶⁹ kishte shkelje për shkak se pasi u la i lirë kërkuesi pretendoi që të kompensohej për periudhën e paraburgimit por pretendimi i tij u hodh poshtë me arsyetimin se ai nuk ishte liruar për shkak se ishte provuar pafajësia e tij por për shkak se ekzistonin dyshime në lidhje me fajësinë e tij si pasojë e disa papajtueshmërive ndërmjet deklaratave të dëshmitarëve të ndryshëm. Parimi ndalon gjithashtu parashikimin e sanksioneve penale për trashëgimtarët, për shkak të evazionit fiskal të kryer nga ana e trashëgimlënësit të tyre. Prezumimi i pafajësisë përfshin pra edhe parimin themelor të së drejtës penale që përgjegjësia penale nuk vazhdon së ekzistuari pas vdekjes së personit që ka kryer veprën penale, por ajo ka karakter plotësisht personal⁵⁷⁰.

Prezumimi i pafajësisë mund të shkelet edhe gojarisht, gjatë seancës, edhe përmes arsyetimit të aktit gjyqësor duke dhënë

⁵⁶⁵ *Ibid.* Shih gjithashtu *Matijasevic k. Serbisë*, nr. 23037/04, § 46, GJEDNJ, 19.09.2006.

⁵⁶⁶ *Shih, Telfner k. Austrisë*, nr. 33501/96, § 17-18, GJEDNJ, 20.03.2001.

⁵⁶⁷ Vendim i Gjykatës i 25.03.1983, Seria A, nr. 62; shih në 5 European Human Rights Reports 554.

⁵⁶⁸ Megjithatë shih për një qëndrim të ndryshëm vendimin e Gjykatës të vitit 1987 në lidhje me çështjen *Lutz, Noelkenbockoff dhe Englert k. Republikës Federale Gjermane*, Seria A, nr. 123; shih në 10 European Human Rights Reports 163.

⁵⁶⁹ Vendim i 20 dhjetorit 2001. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁵⁷⁰ *Shih vendimin e Gjykatës të 29.08.1997 në lidhje me çështjen E. L., R. L. dhe J. O. L. k. Zvicrës.*

përshtypjen se gjyqtarët e konsiderojnë të akuzuarin fajtor⁵⁷¹. Siç e pamë më lart ai mund të shkelet në çdo moment përpara deklarimit përfundimisht fajtor të të akuzuarit, qoftë me deklarata në shtyp ose në parlament, intervista apo qëndrime të tjera publike.

Është e rëndësishme të theksohet, së fundi, se një mangësi në lidhje me prezumimin e pafajësisë mund të ndreqet nga një gjykatë më e lartë, kur ajo në mënyrë të qartë e “*shkarkon të akuzuarin nga çdo konstatim fajësie*”⁵⁷².

II. E drejta për tu informuar mbi akuzën

Neni 6 § 3 (a) i Konventës kërkon që një person i akuzuar me një vepër penale “*të informohet menjëherë në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që i bëhet*”. Në çështjen *Salvador Torres kundër Spanjës*⁵⁷³ kërkuesi u ankua se Gjykata e Lartë Spanjolle ishte bazuar në rrethana rënduese, që nuk ishin përmendur në akuzën që i ishte bërë për të rritur masën e dënimit ndaj tij. Gjykata nuk konstatoi në këtë rast shkelje të nenit 6 § 3 (a) të Konventës përderisa rrethanat ishin një element përbërës i akuzës kundër kërkuesit dhe që ishin të njohura prej tij që në fillim të procedimit. Megjithatë Gjykata ka theksuar se një i akuzuar duhet të marrë një informacion të hollësishëm në lidhje me akuzën që i bëhet dhe një prezumim i bazuar vetëm mbi shërbimin postar nuk është i mjaftueshëm⁵⁷⁴.

Njoftimi i menjëhershëm dhe në mënyrë të kuptueshme i akuzës merr një rëndësi të jashtëzakonshme për të huajt të cilët nuk janë të familjarizuar me gjuhën, me institucionet juridike dhe me zakonet e shtetit në të cilin ata po ndiqen penalisht. Një i akuzuar që nuk është i mësuar të përdorë gjuhën teknike të organeve të drejtësisë mund

⁵⁷¹ Shih, *Matijasevic k. Serbisë*, § 45, GJEDNJ, 19.09.2006, *Deweere k. Belgjikës*, nr. 6903/75, § 56, GJEDNJ, 27.02.1980, *Allenet de Ribemont k. Francës*, nr. 15175/89, § 35-36, GJEDNJ, 10.02.1995.

⁵⁷² Shih *Adolfk. Austrisë*, nr. 8269/78, § 40, GJEDNJ, 26.03.1982.

⁵⁷³ Vendim i Gjykatës i 24.10.1997.

⁵⁷⁴ Shih për shembull çështjen *C k. Italisë*, Decisions and Reports 56/40.

të vihet në një gjendje dizavantazhuese në qoftë se atij nuk i jepet një kopje e akuzës e përkthyer në një gjuhë që ai e kupton më mirë, në qoftë se nuk do të ishte e mundur në gjuhën e tij amtare⁵⁷⁵. Në çështjen *Kamasinski kundër Austrisë*⁵⁷⁶ Gjykata konfirmoi kërkesën e përgjithshme që materialet kryesore të akuzës duhet të përkthehen megjithëse kjo mund të rrisë numrin e faqeve të dosjes gjyqësore⁵⁷⁷. Ka pasur fare pak raste përpara Gjykatës në lidhje me nivelin e “hollësive” që duhet t’i jepen personave të akuzuar mbi akuzat që atyre u bëhen. Megjithatë del e qartë, nga një krahasim ndërmjet termave të përdorur në nenin 6 § 3 (a) me termat e përdorur në nenin 5 § 2⁵⁷⁸ që informacioni i kërkuar duhet të jetë shumë më i hollësishëm në rastin e parë të nenit 6 § 3 (a) sesa në rastin e dytë që ka të bëjë me momentin e arrestimit.

E DREJTA PËR TË MOS U VETË-AKUZUAR

E drejta për një proces të drejtë përfshin gjithashtu të drejtën për të mos qenë i detyruar që të akuzosh vetveten. Në çështjen *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁵⁷⁹, kërkuesi që ishte drejtues i një shoqërie tregtare, ishte i detyruar me ligj që t’u përgjigjej pyetjeve që i bëheshin nga ana e inspektorëve të qeverisë të cilët po hetonin në lidhje me blerjen e një shoqërie tregtare. Një dënim me karakter penal parashikohej nga ligji në rast se ai refuzonte t’u përgjigjej këtyre pyetjeve. Gjykata konstatoi në këtë rast një shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak se informacionet që kërkuesi dha gjatë seancës së pyetjeve u futën si prova kundër tij në dosjen gjyqësore të procesit në përfundim të të cilit ai u deklarua fajtor. Megjithatë nuk është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës që një gjykatë, në konstatimin e fajësisë së të akuzuarit, të nxjerrë deduksione nga mospranimi i të akuzuarit për t’u përgjigjur pyetjeve të policisë ose për të paraqitur

⁵⁷⁵ Shih vendimin e Gjykatës të 19 dhjetorit 1989 në lidhje me çështjen *Kamasinski k. Austrisë*, Seria A, nr. 168.

⁵⁷⁶ *Ibid.*

⁵⁷⁷ Shih gjithashtu çështjen *X k. Austrisë* në Decisions and Reports 2/68.

⁵⁷⁸ Shih paragrafin 5.10 të Kreut V të kësaj Pjese.

⁵⁷⁹ Vendim i Gjykatës i 17 dhjetorit 1996. Shih gjithashtu vendimin tjetër të saj të 25.02.1993 në lidhje me çështjen *Funke k. Francës*, Seria A, nr. 255 – B.

prova të favorshme duke pasur parasysh edhe peshën e provave që janë mbledhur kundër tij⁵⁸⁰. Nuk përbën shkelje të parimit të lirisë për të mos u vetë-akuzuar gjatë një personi që refuzon të betohet dhe të dëshmojë përpara një hetuesi ose prokurori⁵⁸¹.

III. E drejta për të përgatitur mbrojtjen - neni 6 § 3 (b)

E drejta e të akuzuarit për të pasur mundësitë e përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij nënkupton që ai duhet të ketë “hapësirën për të organizuar mbrojtjen e tij në një mënyrë të përshtatshme dhe pa asnjë kufizim për sa i përket mundësisë për të paraqitur të gjitha dokumentet që i mendon të favorshme përpara trupit gjykues”⁵⁸².

Me qëllim që të arrijë të organizojë siç duhet mbrojtjen e tij, natyrisht që në radhë të parë personi i akuzuar duhet që të jetë në gjendje të komunikojë me avokatin ose këshilltarin e tij ligjor që kur është në gjendje arresti⁵⁸³. Gjykata e Strasburgut do të marrë në shqyrtim me kujdes çdo kufizim në lidhje me këtë të drejtë. Në çështjen *Krocher dhe Moller kundër Zvicrës*⁵⁸⁴, kufizimet e ashpra që iu bënë kërkuesve, të dyshuar për terrorizëm, që të takoheshin me avokatët e tyre ndërkohë që ishin në gjendje arresti u justifikuan me arsyet e sigurisë dhe për këtë shkak u konsideruan se nuk përbënin shkelje të nenit 6 § 3 (b) të Konventës. E drejta për të komunikuar lirish me një avokat përshtin gjithashtu edhe të drejtën për të komunikuar me anë letrash. Çdo kufizim që iu bëhet të dënuarve me heqje lirie në lidhje me korrespondencën që kanë me avokatin përkatës do ta shtrojë çështjen gjithashtu për shqyrtim në bazë të nenit 8 të Konventës⁵⁸⁵. Kështu

⁵⁸⁰ Shih vendimin e Gjykatës të 8.02.1996 në lidhje me çështjen *John Murray k. Mbretërisë së Bashkuar*, shih në 22 European Human Rights Reports 29.

⁵⁸¹ Shih vendimin e Gjykatës të 20.10.1997 në lidhje me çështjen *Serves k. Francës*.

⁵⁸² Shih Raportin i Komisionit në lidhje me çështjen *Can k. Austrisë*, në Seria A, nr. 96. Çështja u zgjidh me pajtim ndërmjet palëve kur kaloi përpara Gjykatës.

⁵⁸³ Shih vendimin e Gjykatës të 28.06.1984 në lidhje me çështjen *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, nr. 80; shih në 7 European Human Rights Reports 165; Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁵⁸⁴ Shih në Decisions and Reports 34/ 25.

⁵⁸⁵ E drejta për respektimin e korrespondencës. Shih paragrafin 8.13 të Kreut VIII të kësaj Pjese. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 21.02.1975 në lidhje me çështjen *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, nr. 18; shih në 1 European Human Rights Reports 524 si dhe në L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

për shembull në rastin *Domenichini kundër Italisë*⁵⁸⁶, këqyrja nga ana e autoriteteve të burgut e letrave të kërkuesit drejtuar avokatit të tij u konsiderua se përbënte një shkelje të nenit 6 § 3 (b) të Konventës. Me qëllim që i akuzuari të ketë mundësi të përgatisë mbrojtjen e tij është tepër e rëndësishme që ai të ketë mundësi të shohë dosjen gjyqësore. Megjithatë Gjykata e ka pranuar edhe faktin që një shtet mund t'ia kufizojë avokatit të një të akuzuari mundësinë për të parë dosjen gjyqësore⁵⁸⁷.

Në rast se i akuzuari ka të drejtën për të apeluar vendimin e dënimit të tij, ai duhet të ketë lehtësitë e nevojshme për të përgatitur kërkesën e apelit. Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*⁵⁸⁸, mosdhënia kërkuesit, nga ana e autoriteteve, e tekstit të vendimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit për bërjen e kërkesës së apelit u konsiderua se përbënte shkelje të nenit 6 § 3 (b)⁵⁸⁹.

Kjo garanci e parashikuar nga ana e nenit 6 § 3 (b) kërkon gjithashtu që i akuzuari të ketë kohën e përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij. Vlerësimi i termit “kohë e përshtatshme” varet nga rrethanat e rastit konkret. Në çështjen *Kremzow kundër Austrisë*⁵⁹⁰ Gjykata konstatoi se përderisa i akuzuari kishte marrë një kopje të mendimit të Prokurorit të Përgjithshëm tre javë përpara seancës, ai kishte pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur në kohë për seancën në fjalë përgjigjen e tij ku të parashtronte mendimet dhe argumentat e veta. Në çështjen *GB kundër Francës*⁵⁹¹ nuk kishte shkelje në lidhje me mosakordimin e kohës së mjaftueshme ekspertit për të studiuar materialet e reja të paraqitura gjatë procesit gjyqësor.

⁵⁸⁶ Vendim i Gjykatës i 15 nëntorit 1996.

⁵⁸⁷ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 21.09.1993 në lidhje me çështjen *Kremzow k. Austrisë*, Seria A, nr. 268 – B, shih në 11 European Human Rights Reports 322.

⁵⁸⁸ Vendim i Gjykatës i vitit 1992, Seria A, nr. 252; shih në 16 European Human Rights Reports 219.

⁵⁸⁹ Shih gjithashtu vendimin e 5 dhjetorit 2002 në lidhje me çështjen *Craxi k. Italisë* (Nr. 2).

⁵⁹⁰ Vendim i Gjykatës i 21.09.1993, Seria A, nr. 268 – B, shih në 11 European Human Rights Reports 322.

⁵⁹¹ Vendim i 2.10.2001.

PRANIA E TË AKUZUARIT NË PROCES

Në lidhje me çështjet penale, Gjykata ka vendosur që të akuzuarit duhet të lejohen në parim që të jenë të pranishëm në seancat e procesit gjyqësor⁵⁹². Megjithatë mund të lejohet edhe zhvillimi i seancave edhe në mungesë të të akuzuarit në rastet kur autoritetet gjyqësore kanë vepruar me zellin dhe gatishmërinë e duhur por nuk kanë qenë në gjendje që ta njoftonin të akuzuarin në lidhje me zhvillimin e seancës⁵⁹³. Në çështjen *Cooke kundër Austrisë*⁵⁹⁴, e cila kishte të bënte me një proces penal në ngarkim të kërkuesit në përfundim të të cilit ai u gjet fajtor për veprën penale të vrasjes, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6. Është interesante të shihet se në një vendim të dhënë të njëjtën ditë në lidhje me çështjen *Prinz kundër Austrisë*⁵⁹⁵, e cila kishte të bënte me një akuzë penale ndaj kërkuesit për kanosje. Në këtë çështje gjykatat austriake kishin konstatuar se kërkuesi nuk ishte penalisht përgjegjës por që gjithsesi përmbusheshin kushtet për mbylljen e tij në një institucion për të sëmurët mendorë që paraqisnin rrezikshmëri. Gjykata nga ana e saj konstatoi se “nuk kishte arsye të posaçme që të kërkonin praninë e kërkuesit në seancë në Gjykatën e Lartë, përderisa interesat e tij mbroheshin nga përfaqësuesi i tij ligjor” dhe për pasojë nuk gjeti shkelje të nenit 6.

Në çështjen *Krombach kundër Francës*⁵⁹⁶ kërkuesit i ishte mohuar e drejta e përfaqësimit me avokat në gjykatën e ‘Asizit’⁵⁹⁷, e cila e dënoi atë në mungesë. Gjykata vuri re se ndalimi për tu përfaqësuar me avokat në seancat në gjykatën e ‘Asizit’ kishte

⁵⁹² Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1988 në lidhje me çështjen *Ekbatani k. Suedisë*, Seria A, nr. 134; shih në 13 European Human Rights Reports 504.

⁵⁹³ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1985 në lidhje me çështjen *Colloza dhe Rubinat k. Italisë*, Seria A, nr. 89; shih në 7 European Human Rights Reports 512. shih gjithashtu vendimin e 6 dhjetorit 2001 në lidhje me çështjen *Tsironis k. Greqisë*.

⁵⁹⁴ Vendim i 8.02.2000.

⁵⁹⁵ Vendim i 8.02.2000.

⁵⁹⁶ Vendim i Gjykatës i 13.02.2001. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁵⁹⁷ “Cour d’Assise” në sistemin penal francez është një gjykatë penale e shkallës së parë e cila përbëhet edhe nga juri e zgjedhur dhe se k. vendimit të saj nuk parashikohet, deri në kohën e ngjarjeve mundësi ankimi. Sidoqoftë reforma e nisur me ligjin e 8.06.2000 i ashtuajtur “*prezumimi i pafajësisë*” i cili hyri në fuqi më 1 janar 2001 e ndryshoi plotësisht këtë rregullim.

karakter absolut sipas së drejtës franceze. Ajo vlerësoi se penalizimi i mospjesëmarrjes së kërkuesit në gjykim me një ndalim të një natyre të tillë, pra pamundësinë për tu përfaqësuar me avokat, ishte haptazi jo-proporcional. Ajo u shpreh se “e drejta e çdo të akuzuari për tu përfaqësuar në mënyrë efektive, megjithëse jo absolute është një prej elementëve themelorë të një gjykimi të drejtë dhe i akuzuari nuk mund ta humbasë këtë të drejtë thjesht për shkak se nuk merr pjesë në seancat gjyqësore.” Për këtë arsye ajo vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës⁵⁹⁸.

Kështu për shembull në çështjen *Cani kundër Shqipërisë*⁵⁹⁹, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 për shkak se autoritetet nuk kishin siguruar pjesëmarrjen e kërkuesit në procedurat gjyqësore as përpara Gjykatës së Apelit Vlorë dhe as në Gjykatë të Lartë, përderisa sidomos në të parën, si gjykatë që gjykonte edhe në themel, mund të merreshin për bazë elementë të tillë si rrethanat lehtësuese dhe kur do vlerësohej masa e dënimit të kërkuesit.

E drejta për përfaqësim ligjor dhe ndihmë juridike

E drejta për përfaqësim efikas ligjor është një prej karakteristikave më themelore në një gjykim të drejtë⁶⁰⁰.

Në bazë të nenit 6 § 3 (c) personi i akuzuar ka të drejtë “të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij”. Megjithatë edhe në rast se i akuzuari preferon që të mbrohet nga një avokat i preferuar prej tij, shteti mund të caktojë një avokat tjetër për të, në interes të mbarëvajtjes së drejtësisë⁶⁰¹ dhe mund edhe të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve për ndihmën ligjore në rast se i akuzuari dënohet.

⁵⁹⁸ Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 15.10.2002 në lidhje me çështjen *Cañete de Goñi k. Spanjës*.

⁵⁹⁹ Shih *Cani k. Shqipërisë*, nr. 11006/06, GJEDNJ, 6.03.2012.

⁶⁰⁰ Shih paragrafin 34 të vendimit të Gjykatës të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Poitrimol k. Francës*, Seria A, nr. 277 - A; shih në 18 European Human Rights Reports 130.

⁶⁰¹ Shih vendimin e Gjykatës të 25.09.1992 në lidhje me çështjen *Croissant k. Gjermanisë*, Seria A, nr. 237 - B; shih në 16 European Human Rights Reports 135.

Gjykata, nga ana tjetër, ka vendosur që është shkelje e kësaj dispozite të Konventës në qoftë se një shtet refuzon të lejojë një avokat të përfaqësojë të akuzuarin dhe kur ky nuk merr pjesë në seancat gjyqësore⁶⁰².

E drejta për të pasur ndihmë ligjore në bazë të nenit 6 § 3 (c) nuk ka karakter absolut. Duhet për këtë që personi të mos i ketë ai vetë mjetet e nevojshme për të paguar ndihmën ligjore dhe gjithashtu duhet që interesat e drejtësisë të kërkojnë që të akordohet ndihma ligjore⁶⁰³.

Në vlerësimin e “interesave të drejtësisë” Gjykata ka mbajtur parasysh faktorët vijues.

1. Karakterin kompleks të çështjes konkrete. Në rast se çështja është e komplikuar, është shumë më e mundshme që personi i akuzuar të kërkojë ndihmë ligjore⁶⁰⁴.
2. Rolin që do të mund të luante i akuzuari në qoftë se do t'i duhej të mbrohej vetë.
3. Rëndësinë që ka çështja për të akuzuarin; seriozitetin e veprës që ai ka kryer dhe dënimin që ai rrezikon të marrë në bazë të ligjit për këtë vepër në qoftë se ai deklarohet fajtor.

Gjykata e Strasburgut konstatoi një shkelje të nenit 6 § 3 (c) në çështjen *Quaranta kundër Zvicrës*⁶⁰⁵, ku kërkuesi, të cilit i ishte mohuar ndihma ligjore, ishte dënuar me gjashtë muaj burg.

⁶⁰² Shih vendimit të Gjykatës të vitit 1993 në lidhje me çështjen *Poirtrimol k. Francës*, Seria A, nr. 277 - A; shih në 18 European Human Rights Reports 130. Shih gjithashtu vendimin e saj të 22.09.1994 në lidhje me çështjen *Pelladoah k. Hollandës*, Seria A, nr. 297 - B; shih në 19 European Human Rights Reports 81. Shih gjithashtu vendimin e 20.03.2001 në lidhje me çështjen *Goedhart k. Belgjikës* dhe të 13.02.2001 në lidhje me çështjen *Krombach k. Francës*. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁶⁰³ Shih vendimin e 12.10.1999 në lidhje me çështjen *Perks k. Mbretërisë së Bashkuar*.

⁶⁰⁴ Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 25.09.1992 në lidhje me çështjen *Pham Hoang k. Francës*, Seria A, nr. 243; shih në 16 European Human Rights Reports 53.

⁶⁰⁵ Vendim i Gjykatës i 24.05.1991, Seria A, nr. 205. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 28.10.1994 në lidhje me çështjen *Boner k. Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, Nr.300-B, në të cilën kërkuesi kërkoi të përfaqësohej nga një avokat në interes të drejtësisë përderisa ai rrezikonte një dënim me heqje lirie deri në 8 vjet.

Neni 6 § 3 (c) kërkon që ndihma ligjore të jetë “efikase” dhe shteti mund të jetë përgjegjës në rastet kur avokati, qoftë i caktuar nga shteti qoftë i zgjedhur nga vetë i akuzuari, nuk e përfaqëson siç duhet të akuzuarin⁶⁰⁶. Në çështjen *Berlinski kundër Polonisë*⁶⁰⁷ kishte shkelje për shkak të vonesës së emërimit të një avokati kryesisht. Në çështjen *Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁶⁰⁸ kishte shkelje për shkak të refuzimit për të lejuar personat e dënuar me burg që të përfaqësoheshin me avokat gjatë proceseve për masa disiplinore në burg⁶⁰⁹.

E drejta për një mbrojtje efikase ligjore e garantuar nga ana e nenit 6 § 3 të Konventës mund të konsiderohet se është shkelur edhe në rastet kur i akuzuari nuk lejohet t’i drejtohet një avokati ndërkohë që është i ndaluar nga policia⁶¹⁰. Për më tepër një person në gjendje paraburgimi duhet të jetë në gjendje të këshillohet me avokatin e tij jo në prani të një gardiani të burgut⁶¹¹.

Neni 6 § 3 (d) - E drejta për të thirrur dhe për të pyetur dëshmitarët
Konventa nuk i ofron personit të akuzuar një të drejtë të pakufizuar për të thirrur dëshmitarë⁶¹² dhe as një të drejtë që t’i detyrojë gjykatat e brendshme për të dëgjuar një dëshmitar të veçantë. Megjithatë procedura e thirrjes dhe e pyetjes apo dëgjimit të dëshmitarëve duhet të jetë e njëjtë si për palën akuzuese ashtu edhe për palën mbrojtëse, pra duhet të ketë barazi në trajtimin e të dyja palëve⁶¹³.

⁶⁰⁶ Shih vendimin e Gjykatës të vitit 1980 në lidhje me çështjen *Artico k. Italisë*, Seria A, nr. 80, vendimin e saj të 11.04.1998 në lidhje me çështjen *Daud k. Portugalisë*, si dhe vendimin e 10.10.2002 në lidhje me çështjen *Czekalla k. Portugalisë*.

⁶⁰⁷ Vendim i 20.06.2002.

⁶⁰⁸ *Ezeh dhe Connors k. Mbretërisë së Bashkuar*, [D.H.M.], nr. 39665/98 dhe 40086/98, § 91, GJEDNJ, 2003-X.

⁶⁰⁹ Shih gjithashtu vendimin e 16.07.2002 në lidhje me çështjen *P, C dhe S k. Mbretërisë së Bashkuar*.

⁶¹⁰ Shih vendimin e Gjykatës të 8.02.1996 në lidhje me çështjen *John Murray k. Mbretërisë së Bashkuar*, shih në 22 European Human Rights Reports 29.

⁶¹¹ Shih vendimin e Gjykatës të 28 nëntorit 1991 në lidhje me çështjen *S k. Zvicrës*, Seria A, nr. 220; shih në 14 European Human Rights Reports 670.

⁶¹² Shih vendimin e Gjykatës të 7.07.1989 në lidhje me çështjen *Bricmont k. Belgjikës*, Seria A, nr 158; shih 12 European Human Rights Reports.

⁶¹³ Shih vendimin e Gjykatës të 24 nëntorit 1986 në lidhje me çështjen *Unterperntinger k. Austrisë*, Seria A, nr. 110; shih në 13 European Human Rights Reports 175.

Megjithatë kërkuesi duhet të ketë të drejtë të ngrejë në mënyrë të veçantë pretendimin se pamundësia për të dëgjuar një dëshmitar të veçantë kishte cenuar drejtësinë e çështjes së tij ose të saj⁶¹⁴. Në çështjen *PS kundër Gjermanisë*⁶¹⁵ kishte shkelje në lidhje me mungesën e mundësisë për të akuzuarin për të marrë në pyetje viktimën e abuzimit seksual për të cilin ai akuzohej. Megjithatë në çështjen *SN kundër Suedisë*⁶¹⁶ nuk kishte shkelje në lidhje me mungesën e mundësisë për të akuzuarin për të marrë në pyetje viktimën, e mitur, të abuzimit seksual për të cilin kërkuesi akuzohej.

Gjykata ka vendosur që, në parim, provat duhet të merren në prani të të akuzuarit në respektim të sistemit akuzator të gjykimit. Probleme mund të lindin në dritën e nenit 6 § 3 (d) por edhe të nenit 6 § 1 të Konventës në qoftë se pala akuzuese përdor në dosje deklarata të bëra nga një person i cili nuk paraqitet si dëshmitar në seancë gjyqësore. Kjo mund të jetë për shkak se ai ka frikë për shembull nga hakmarrja nga ana e të akuzuarit ose e shokëve apo të afërmve të tij⁶¹⁷. Megjithatë, në çështjen *Doorson kundër Hollandës*⁶¹⁸ Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 § 3 (d) në lidhje me përdorimin e dëshmitarëve anonimë. Dy dëshmitarët civilë në këtë çështje i njihnin personalisht të akuzuarin dhe kjo ishte e mjaftueshme për të besuar se ai mund të ushtronte dhunë kundër tyre. Për më tepër, kishte pasur edhe prova të tjera të cilat identifikonin të akuzuarin si përgjegjës. Në çështjen *Van Mechelen dhe të tjerë kundër Hollandës*⁶¹⁹, Gjykata konstatoi shkelje të Konventës në lidhje me përdorimin e dëshmitarëve të policëve anonimë të cilët nuk u betuan për vërtetësinë e dëshmitarëve të tyre. Gjykata vendosi që policët në fjalë nuk mund të

⁶¹⁴ Shih në Decisions and Reports 28/ 127. shih gjithashtu vendimin e 14 dhjetorit 1999 në lidhje me çështjen *AM k. Italisë*, si dhe *Sadak dhe të tjerë k. Turqisë*.

⁶¹⁵ Vendim i 20 dhjetorit 2001.

⁶¹⁶ Vendim i 2.07.2002.

⁶¹⁷ Shih ndër të tjera vendimin e Gjykatës të 20 nëntorit 1989 në lidhje me *Kostovski k. Hollandës*, Seria A, nr. 166, shih në 12 European Human Rights Reports 434; vendimin e Gjykatës të 24 nëntorit 1986 në lidhje me çështjen *Unterperntinger k. Austrisë*, Seria A, nr. 110; shih në 13 European Human Rights Reports 175. Si dhe vendimin e sj në lidhje me çështjen *van Mechelen k. Hollandës*. Shih gjithashtu L.Bianku, O.Kumbaro, 2017, e lartpërmendur.

⁶¹⁸ Vendim i Gjykatës i 22.02.1996, shih në 22 European Human Rights Reports 330.

⁶¹⁹ Vendim i Gjykatës i 23.04.1997; shih në 25 European Human Rights Reports 647.

kishin një frikë të pranueshme nga hakmarrjet e të akuzuarve dhe përderisa konstatimi fajtor i të akuzuarve ishte bazuar “në një masë vendimtare” në deklaratat anonime të bëra prej tyre kishte në këtë rast shkelje të Konventës. Në çështjen *Birutis dhe të tjerë kundër Lituanisë*⁶²⁰ kishte shkelje në lidhje me përdorimin në proces të deklaratave të bëra nga dëshmitarë anonimë të cilët ishin në pjesën më të madhe të bashkëburgosur të kërkuesit. Gjykata deklaroi se cënimi i së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit nga përdorimi i dëshmitarëve anonimë duhej të barazpeshohej nga procedurat që ndiqeshin nga autoritetet gjyqësore. Në këtë rast, mungesa e marrjes në pyetje të dëshmitarëve anonimë nga ana e gjykatave dhe i mosshqyrtimit të mënyrës dhe rrethanave në të cilat dëshmitë anonime ishin marrë, ishin të papranueshme për Gjykatën.

E drejta për një përkthyes

E drejta për ndihmesën pa pagesë të një përkthyesi varet vetëm nga një kërkesë – që personi të mos mund të kuptojë ose të flasë gjuhën që përdoret në gjykatë. Mundësia e tij për ta paguar përkthyesin në një rast të tillë nuk ka rëndësi⁶²¹.

Kërkesa për të ofruar një lehtësi të tillë shtrihet përtej seancave gjyqësore dhe përfshin edhe përkthimin e deklaratave dhe të dokumentave të rëndësishme me qëllim që pala mbrojtëse të jetë në gjendje të kuptojë dhe të marrë pjesë plotësisht në procesin gjyqësor⁶²². Megjithatë ofrimi i një avokati që i përdor të dyja gjuhët mund të jetë një zgjidhje akoma më e mirë e një situatë të tillë⁶²³.

⁶²⁰ Vendim i 28.03.2002.

⁶²¹ Shih për shembull vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjen *Geerk k. Zvicrës*, në *Decisions and Reports* 16/ 56 dhe *Akdogan k. Republikës Federale të Gjermanisë*, në 46/ 214.

⁶²² Shih vendimin e Gjykatës të 28 nëntorit 1978 në lidhje me çështjen *Luesick Belkacem dhe Koc k. Republikës Federale të Gjermanisë*; Seria A, nr. 29; shih në 2 *European Human Rights Reports* 149.

⁶²³ Shih vendimin e Gjykatës të 19 dhjetorit 1989 në lidhje me çështjen *Kamasinski k. Austrisë*, Seria A, nr. 168; shih në 13 *European Human Rights Reports* 36.

Në çështjen *Brozicek kundër Italisë*⁶²⁴ një shtetas gjerman u akuzua në Itali për vepra të ndryshme penale. Autoritetet italiane kishin vazhduar t'i paraqisnin atij dokumenta me shkrim në italisht duke pretenduar që ai kishte njohuri të mjaftueshme të kësaj gjuhe, gjë të cilën ai e mohonte. Gjykata konstatoi në këtë rast që neni 6 § 3 (e) i Konventës ishte shkelur. Kjo për faktin se dokumentat duhet t'i ishin dhënë të përkthyer kërkuesit "përveçse kur ato [autoritetet italiane] do të ishin në gjendje të vërtetonin se kërkuesi kishte në fakt njohuri të mjaftueshme të gjuhës italiane sa të kuptonte ... kuptimin e letrës që i njoftonte atij akuzat që i bëheshin".

Natyrisht që e drejta për një përkthyes shtrihet edhe ndaj personave me probleme të pjesshme ose të plota dëgjimi në rast se mënyra normale e komunikimit për ta është me anë të shenjave për shembull.

⁶²⁴ Vendim i Gjykatës i 19 dhjetorit 1989, Seria A, nr. 167; shih në 12 European Human Rights Reports 371.

SHTOJCË

Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

- c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

